



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor

“Administrim Biznesi në Marketing”

i

Institucionit të Arsimit të Lartë Universiteti “Fan S. Noli”,
Korçë”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. As Genc Alimehmeti

2. Dr. Ana Buhajjoti

Mars/2022

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit Bachelor “Administrim Biznesi në Marketing” ofrohet nga Fakulteti i Ekonomisë. Ky fakultet përbehet nga:

- Departamenti i Marketing - Turizmit
- Departamenti i Financë - Kontabilitetit
- Departamenti i Menaxhimit

Programi i studimit Bachelor “Administrim Biznesi në Marketing”, pjesë e Departamentit të Marketing-Turizmit, është hapur me VKM Nr. 230 datë 29.05.1992 dhe riorganizuar VKM Nr. 281 datë 04.07.2013 me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës (MASH). Programi i ciklit të parë ofrohet me kohë të plotë, në gjuhën shqipe dhe kohëzgjatja e tij është 3 vite akademike, me 180 ECTS. Në përfundim të programit të studimit lëshohet diplomë Bachelor “Administrim Biznesi në Marketing” e regjistruar me Vendim Nr. 499, datë 03.06.2013 nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.



Programi i studimit është ndërtuar mbi një përvojë të mirë institucionale dhe reflekton vlerat akademike dhe shkencore të saj. Ai ka në bazë zhvillimet social-ekonomike të vendit tonë dhe një analizë të tregut rajonal të punës. Rëndësia e këtij programi lidhet me fushën e Marketingut e cila po zhvillohet me ritme të shpejta brenda ekonomisë dhe biznesit dhe kërkon specialistë të pajisur me njohuri dhe aftësi të administrimit të veprimtarisë së marketingut jo vetëm brenda vendit, por dhe në tregjet në rritje rajonale e globale.

Programi synon të pajisë studentët me njohuri të thelluara në marketing si dhe me kopetencat dhe instrumentet themelore për rritjen e aftësive në marketing në përmbushje të kërkesave dhe pritjeve të tregut të punës.

Programi i studimit Bachelor “Administrim Biznesi në Marketing” plotëson kriteret sa i takon organizimit dhe administrimit të tij, tipologjisë së lëndëve, si dhe ngarkesës së orëve dhe krediteve, e burimeve të nevojshme për realizimin me cilësi të studimit.

Kurikula e programit të studimit është rishikuar dhe vlerësuar në mënyrë periodike në përputhje me aktet ligjore, statutin dhe rregulloren e institucionit. Këto rishikime kanë ardhur si pasojë e bashkëpunimit të ngushtë të institucionit me bizneset dhe universitetet partnere brenda dhe jashtë vendit për të formuar studentë me kompetenca dhe aftësi në përputhje me kërkesat e tregut të punës. Institucioni ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me biznese lokale për të krijuar një lidhje organike me tregun e punës në funksion të programit të studimit.

Pranimi i studentëve në këtë program studimi është realizuar sipas kriterëve që vendos ligji Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, por dhe Statutit të UNIKO dhe Rregullores së Programit.





Në regjistrin e administruar nga sekretaria mësimore e institucionit janë pasqyruar të dhënat e studentëve të regjistruar në këtë program studimi në përputhje me dokumentacionin që gjendet në dosjen e studentit, e cila u verifikua dhe me vizitën e GVJ bazuar në një përzgjedhje të rastësishme.

Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e Fakultetit të Ekonomisë dhe bibliotekën e Universitetit. *GVJ tërheq vëmendjen që të rinovohet literatura e bibliotekës me titujt bashkëkohorë për çdo modul studimi.*

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë mat ecurinë e programit të studimit për qëllime përmirësimi duke përdorur instrumente matëse si pyetësorët për studentët, raporte të njësive kryesore e vlerësime nga pedagogët e Departamentit të Marketingut dhe Turizmit.

Programi i studimit Bachelor “Administrim Biznesi në Marketing” mbështet profilizimin dhe zhvillimin e aftësive të specializuara të studentëve në Marketing. Kjo është një mundësi për lidhjen e studentëve me një funksion apo profesion që në ciklin e parë të studimit. Por nga ana tjetër paraqet një sfidë për realizimin e një formimi sa më profesional me raportin e ulët të praktikës kundrejt teorisë në profilin Marketing. *GVJ rekomandon që njësia përgjegjëse e programit të ndërmarrë një studim të thelluar tregu lidhur me prirjet dhe ndryshimet e shpejta në fushën e Marketingut në mënyrë që të përforcojë avantazhet e këtij programi në raport me programe të tjera Bachelor të ofruar në fushën e biznesit. Kjo kërkon dhe një gjurmim real të alumnit në tregun e punës, çka do të ndihmojë në nxitjen e kërkesës së ardhshme për këtë program. GVJ rekomandon të rishikohet raporti mes ngarkesës teorike dhe praktike të lëndëve duke vlerësuar si domosdoshmëri rritjen e orëve praktike në mënyrë që të aftësojë specialistë në fushën e marketingut.*



Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm

Procesi i vlerësimit të jashtëm të programit të studimit Bachelor “Administrim Biznesi në Marketing”, ka ndjekur hapat rigorozë të cilat janë në zbatim të Ligjit për Arsimin e Lartë dhe bazës ligjore për veprimin e Agjencisë për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL).


Procesi nisi me kontaktin e ekspertëve, të cilët u trainuan për standartet e cilësisë dhe kriteret, si edhe mbi përdorimin e sistemit elektronik, në seksionin paneli i ekspertit. Në këtë fazë të parë u vendos një komunikim i mirë i grupit të punës, i përbërë nga ekspertët dhe koordinatori Teknik i ASCAL. Pas njohjes dhe vlerësimit të dosjes së vetëvlerësimit të brendshëm dorëzuar nga institucioni, u hartua axhenda e vizitës në institucion.


Në fazën e dytë u zbatua me rigorozitet axhenda 2 ditore e vizitës në institucion datë 8-9 Nëntor 2021. GVJ mbledhi informacion të nevojshme për një vlerësim rigoroz bazuar në takime me Dekanin e Fakultetit të Ekonomisë, Përgjegjësen e Departamentit të Marketing Turizëm, grupin e vlerësimit të brendshëm, stafin akademik të programit të studimit, Drejtorinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, sekretarinë mësimore, Drejtorinë Burimeve Njerëzore, Zyrën Alumni dhe të Projekteve, dhe Studentët e të tre viteteve të programit të studimit. Të gjitha informacionet e mbledhura nga takimet, u përdorën nga grupi i vlerësimit të jashtëm, i përbërë nga Prof As. Genc Alimehmeti dhe Dr. Ana Buhaljoti për hartimin e Raportit të Vlerësimit të Jashtëm. Gjatë të gjithë procesit ky grup pune u asistua dhe nga koordinatori teknik i ASCAL, Z. Erjon Xhako.

Raporti i vlerësimit të jashtëm është përgatitur pas shqyrtimit të hollësishëm të dokumentave të vëna në dispozicion në sistemin e ASCAL, si edhe vizitës dy ditore pranë Departamentit Marketing Turizëm, Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti Fan S. Noli, Korçë.

Grupi është bazuar në kërkesat e Ligjit mbi Arsimin e Lartë, si dhe aktet ligjore dhe nën ligjore që lidhen me sigurimin e cilësisë dhe vlerësimin e jashtëm. Në hartimin e raportit, grupi ka vepruar me detyra dhe përgjegjësi të qarta duke vënë theksin në përmbajtjen akademike të programit, nivelin dhe performancës së personelit akademik, vlerësimin e infrastrukturës dhe mjedisit në dispozicion. Raporti i vlerësimit të jashtëm ju dorëzua koordinatorit teknik të ASCAL.

Më datë 02.03.2022, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 04/22 Prot., datë 02.03.2022, dërgohet në institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. IAL, përmes AMS, më datë 07.03.2022, dhe me shkresë zyrtare Nr. 423/1 Prot., datë 07.03.2022, shprehet se nuk ka komente mbi Draft-Raportin, si rrjedhojë ky i fundit konsiderohet si Raport i Vlerësimit të Jashtëm





4


Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor “Administrim Biznesi në Marketing”


I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR


Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	<p>Programi i studimit Bachelor “Administrim Biznesi në Marketing”, pjesë e Departamentit të Marketing-Turizmit, është hapur me VKM Nr. 230 datë 29.05.1992 dhe riorganizuar VKM Nr. 281 datë 04.07.2013 me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës (MASH). Programi i ciklit të parë ofrohet me kohë të plotë, në gjuhën shqipe dhe kohëzgjatja e tij është 3 vite akademike, me 180 ECTS. Në përfundim të programit të studimit lëshohet diplomë Bachelor “Administrim Biznesi në Marketing” e regjistruar me Vendim Nr. 499, datë 03.06.2013 nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.</p> <p>Programi i studimit është ndërtuar mbi një përvojë të mirë institucionale dhe reflekton vlerat akademike dhe shkencore të saj. Ai ka në bazë zhvillimet social-ekonomike të vendit tonë dhe një analizë të tregut rajonal të punës.</p> <p>Ai i paraprin sfidave të zhvillimit të politikave të Marketingut në vendin tonë në mbështetje të interesave të industrisë dhe shoqërisë në tërësi. Bizneset dhe institucionet në vend kanë kërkesë në rritje për specialistë në fushën e marketingut, për të mbështetur dhe realizuar aktivitetin e tyre në treg. Kësaj prirje i përgjigjet UNIKO me programin e studimit Bachelor “Administrim Biznesi në Marketing” i cili mbështet profilizimin dhe zhvillimin e aftësive të specializuara të studentëve në disiplinën e Marketingut që në ciklin e parë të studimit.</p> <p>Duke vlerësuar se njohuritë në marketing sot janë kthyer në domosdoshmëri për institucionet private dhe ato shtetërore, ky program përputhet me interesat kombëtare për ekspertë dhe specialistë të formuar në nivel cilësor në marketing.</p> <p>Nga shqyrtimi i programit dhe diskutimet e zhvilluara me përfaqësues të UNIKO-së GVJ konstaton se programi Bachelor në Marketing përbën risi në ofertën akademike dhe është në</p>

	<p>përputhje me kërkesat e tregut kombëtar të punës. <i>Evidenca I.01 - Statuti i UNIKO</i> <i>Evidenca I.02 - Rregullore e Organizimit dhe Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore të UNIKO</i> <i>Evidenca I.03 - Plani strategjik i zhvillimit të UNIKO</i> <i>Evidenca I.32 - Rregullore e brendshme e FE</i></p>
<p>Kriteri 2. Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor Administrim Biznesi në Marketing është në përputhje me statutin dhe rregulloren e institucionit në fuqi. Në statutin dhe rregulloren e brendshme të UNIKO gjejmë të përcaktuar mënyrën e organizimit të institucionit, kompetencat e organeve drejtuese akademike, kolegjiale dhe administrative si dhe të autoriteteve drejtuese të institucionit, të njësive kryesore dhe të njësive bazë. Synimi i UNIKO ka qenë hartimi i programit të studimit në koherencë me mënyrën e organizimit të institucionit, të njësive kryesore dhe integrimin ndërdisiplonor brenda një programi për të rritur efikasitetin institucionale. Statuti është dokumenti kryesor, prej të cilit hartohen rregulloret dhe procedurat e Fakulteteve dhe Departamenteve dhe organeve të tjera mbi bazën e të cilave zhvillohet e gjithë veprimtaria mësimore, shkencore dhe edukative në UNIKO.</p> <p>Statuti dhe rregullorja janë ngushtësisht të lidhura dhe të ndërrvarura me njëra – tjetrën në kërkim të standardeve akademike e kërkimore, mësimdhënies, vëmendjes ndaj studentëve, dhe mbështetjen për biznesin e nevojat e zhvillimit perspektiv të shoqërisë.</p> <p>Veprimtaria kërkimore-shkencore e UNIKO zhvillohet në përputhje me nevojat ekonomike e sociale të vendit dhe synon tu paraprijë sfidave të zhvillimit dhe integritetit të vendit në strukturat europiane, si zhvillimit të qëndrueshëm, zhvillimit të ofertës dhe prodhimit vendas, dhe rritjes së konkurrencës.</p> <p>GVJ konstaton se programi i studimit është hartuar në përputhje me Ligjin e Arsimit të lartë në Shqipëri dhe me vlerat kulturore e kombëtare.</p> <p><i>Evidenca I.01 - Statuti i UNIKO</i> <i>Evidenca I.03 - Plani strategjik i zhvillimit të UNIKO</i> <i>Evidenca I.34/2 - VKM për riorganizimin e programit të studimit</i></p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Administrim Biznesi në Marketing është në përputhje me misionin UNIKO për tu transmetuar studentëve një edukim cilësor dhe dije të qëndrueshme për ndërtimin e shoqërisë së të ardhmes bazuar në dije.</p>

veprimtarisë.	<p>Programi i studimit reflekton dijet, aftësitë dhe kopetencat e kërkuara nga tregu i punës dhe është në përputhje me objektivat dhe strategjinë e zhvillimit të UNIKO. Tek misioni i UNIKO vihet theksi tek përgatitja e specialistëve të kualifikuar për punësim duke siguruar një arsimim të nivelit të lartë, me dije bashkëkohore në zhvillimin e kapaciteteve dhe burimeve për zgjidhje të problemeve të rëndësishme të rajonit të Korçës e më gjerë.</p> <p>Vetë institucioni mbështet programin e studimit Bachelor Administrim Biznesi në Marketing me procese cilësore të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor me qëllim sigurimin e dijeve të qëndrueshme e bashkëkohore teorike e praktike, të cilat janë evidentuar edhe tek qëllimi i programit të studimit dhe bazuar në dokumenta strategjike të insitucionit.</p> <p>UNIKO me programin Bachelor Administrim Biznesi në Marketing kërkon të përforcojë njohuritë dhe ekspertizën në fushën e marketingut duke u mbështetur në bashkëpunimet me institucionet publike, organizatat si dhe me aktorët lokalë e rajonal për të zhvilluar njohuri të qëndrueshme në fushën e marketingut dhe ndikuar në zhvillimin e kapaciteteve të marketingut. Qëllimi është kualifikim më cilësor, i cili shprehet dhe në strategjinë e institucionit.</p> <p>Nga shqyrtimi i programit dhe diskutimet me përfaqësues të UNIKO, GVJ gjykon se programi Bachelor Administrim Biznesi në Marketing, plotëson ofertën akademike dhe është në përputhje me misionin, objektivat dhe strategjinë e zhvillimit të UNIKO.</p> <p><i>Evidenca I.01 - Statuti i UNIKO</i> <i>Evidenca I.02 - Rregullore e Organizimit dhe Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore të UNIKO</i> <i>Evidenca I.03 - Plani strategjik i zhvillimit të UNIKO</i> <i>Evidenca I.32 - Rregullore e brendshme e FE</i></p>
Kriteri 4. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	<p>GVJ pas konsultimit të dokumentacionit bazë dhe vizitave në insitucion konstatoi se programi është hartuar në përputhje me zhvillimet në tregute punës dhe është me rëndësi strategjike për ekonominë dhe tregun rajonal të Korçës. Pas përfundimit të tij studentët përftojnë njohuri se si menaxhohet një ndërmarrje apo biznes, duke u pajisur me shprehi të veçanta në Marketing. Marketingu është një drejtim mjaft i kërkuar nga tregu i punës vendas, dhe UNIKO i shton vlerë arsimit në këtë sektor përmes njohurive bashkëkohore dhe ndërkombëtare të ndërlihdura me</p>



7




	<p>përvojën rajonale në funksionimin dhe menaxhimin e strukturave të specializuara në marketing në rajonin e Korçës. Kurrikula e programit është në përputhje me prioritet kombëtare të vendit dhe me situatën konkurruese të tregut rajonal të Korçës.</p> <p><i>Evidenca I.01 - Statuti i UNIKO</i> <i>Evidenca I.26 - Rregullore e programit të studimit</i> <i>Evidenca I.29 - Kurrikula e programit të studimit</i> <i>Evidenca I.27 - Studime tregu</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2	
Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.</p>	<p>UNIKO ka hartuar dhe miratuar një Plan Strategjik për zhvillimin e institucionit, për periudhën 2016-2020, si dhe draft Planin Strategjik për vitin 2021-2026.</p> <p>Pas shyrimit të Planit Strategjik, GVJ vlerëson se prioritetet strategjike janë cilësia akademike, kërkimi shkencor, bashkëpunimet brenda dhe jashtë vendit, të cilat krijojnë një mjedis që promovon të mësuarin interaktiv në bashkëpunim me njësitë lokale e vendore, në mënyrë që tu japë zgjidhje problemeve të ndryshme rajonale e kombëtare në përputhje me misionin e IAL-së. Pjesë e prioritetëve është dhe përshtatja e vazhdueshme e kurrikulave dhe programeve me tregun e punës.</p> <p>Vlen të theksohet se programi i studimit Bachelor Administrim Biznesi në Marketing është në përputhje me Planin Strategjik të IAL-së. (Plani Strategjik 2021-2026). Ai është hartuar duke konsideruar sfidat e mëdha të mjedisit gjithmonë e më konkurrues, punëdhënësit si dhe shoqërinë në tërësi.</p> <p>Plani strategjik, statuti, dhe rregullorja e IAL-së janë ngushtësisht të lidhura dhe të ndërvarura me njëra – tjetrën në kërkim të standarteve akademike e kërkimore, të kërkimit shkencor, mësimdhënies, vëmendjes ndaj studentëve, dhe mbështetjen për biznesin e nevojat e zhvillimit perspektiv të shoqërisë.</p> <p><i>Evidenca I.01 - Statuti i UNIKO</i> <i>Evidenca I.03 - Plani strategjik i zhvillimit të UNIKO 2016-</i></p>

Osman Alimiri

[Signature]

	<p>2020</p> <p><i>Evidenca I.03.1 - Plani strategjik i zhvillimit të UNIKO 2021-2026</i></p> <p><i>Evidenca I.02 - Rregullore e Organizimit dhe Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore të UNIKO</i></p>
<p>Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimet prioritare akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p>	<p>Në statutin dhe rregulloren e brendshme të UNIKO gjejmë të përcaktuar mënyrën e organizimit të institucionit, kompetencat e organeve drejtuese akademike, kolegiale dhe administrative si dhe të autoriteteve drejtuese të institucionit, të njësive kryesore dhe të njësive bazë. UNIKO ka hartuar programin e studimit në koherencë me mënyrën e organizimit të institucionit, të njësive kryesore dhe integrimin ndërdisiplonor brenda një programi për të rritur efikasitetin institucionale. Statuti është dokumenti kryesor, prej të cilit hartohen rregulloret dhe procedurat e Fakulteteve dhe Departamenteve dhe organeve të tjera mbi bazën e të cilave zhvillohet e gjithë veprimtaria mësimore, shkencore dhe edukative në UNIKO.</p> <p>Programi Bachelor Administrim Biznesi në Marketing është në përputhje me statutin dhe rregulloren e institucionit.</p> <p><i>Evidenca I.01 - Statuti i UNIKO</i></p> <p><i>Evidenca I.02 - Rregullore e Organizimit dhe Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore të UNIKO</i></p> <p><i>Evidenca I.32 - Rregullore e brendshme e FE</i></p>
<p>Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor Administrim Biznesi në Marketing, pjesë e Departamentit të Marketing-Turizmit, është hapur me VKM Nr. 230 datë 29.05.1992 dhe riorganizuar VKM Nr. 281 datë 04.07.2013 me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës (MASH). Programi i ciklit të parë ofrohet me kohë të plotë, në gjuhën shqipe dhe kohëzgjatja e tij është 3 vite akademike, me 180 ECTS. Në përfundim të programit të studimit lëshohet diplomë Bachelor “Administrim Biznesi në Marketing” e regjistruar me Vendim Nr. 499, datë 03.06.2013 nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.</p> <p>Programi Bachelor Administrim Biznesi në Marketing siguron njohuri në shkencat ekonomike, me focus në funksionin e marketingut të bizneseve për të përmirësuar cilësinë, aftësitë praktike, orientimin me tregun dhe kompetencat akademike e profesionale të studentëve.</p> <p>Programi Bachelor Administrim Biznesi në Marketing në emërtimin organizimin dhe strukturën është në përputhje me</p>

	drejtimin akademik të institucionit në fushën e ekonomisë e biznesit, si pjesë e këtij fakulteti.			
	<i>Evidenca I.02 - Rregullore e Organizimit dhe Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore të UNIKO</i>			
	<i>Evidenca I.32 - Rregullore e brendshme e FE</i>			
	<i>Evidenca I.34/2 - VKM për riorganizimin e programit të studimit</i>			
	<i>Evidenca I.26 - Rregullore e programit të studimit</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3	
Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.	<p>Departamenti i Marketing-Turizmit, si njësi bazë që ofron këtë program studimi, krahas objektivave për të shërbyer tregut dhe biznesit shqiptar, rritjes së cilësisë dhe përmirësimit të standarteve të mësimdhënies, forcimit të marrëdhënieve me studentët, vlerëson formimin e studentëve të programit të studimit, me dije e kompetenca që i shërbejnë tregut dhe qëllimeve të institucionit.</p> <p>Cikli i parë i studimeve në Administrim Biznesi në Marketing synon formimin dhe kualifikim e studentëve në fushën e marketingut duke siguruar njohuritë themelore në shkencën e marketingut që të jetë i krahasueshëm me diplomat që lëshojnë strukturat analoge universitare brenda dhe jashtë vendit.</p> <p>Gjithashtu programi ka përmbajtje të atillë që u ofron studentëve njohuritë bazë të nevojshme për të ndjekur ciklet e tjera të thelluara të studimit.</p> <p>Në planin strategjik të institucionit, janë përcaktuar objektiva të programit të kategorizuara për kërkimin shkencor, rritjen e cilësisë së mësimdhënies, orientimin drejt biznesit, rritjen e kontributit në komunitet dhe infrastruktura e mësimdhënies. <i>Vihet re se objektivat për këtë program studimi janë të përgjithshme dhe nuk dallojnë nga objektivat për programet e tjera bachelor si p.sh bachelor në menaxhim. Ato nuk specifikojnë qartë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që karakterizojnë këtë program studimi.</i></p>

Osman Ahmeti

[Signature]

	<p><i>Evidenca I.03 - Plani strategjik i zhvillimit të UNIKO 2016-2020</i></p> <p><i>Evidenca I.03.1 - Plani strategjik i zhvillimit të UNIKO 2021-2026</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Nga takimi me Drejtuesen e Departamentit të Marketing - Turizëm dhe Dekanen e Fakultetit të Ekonomisë, GVJ u informua se krijimi dhe përmirësimi i programit është bazuar në studime tregu.</p> <p>Qendra Alumni në bashkëpunim me njësinë përgjegjëse për ofrimin e programit, kanë zhvilluar studime dhe takime me Bizneset lokale në lidhje me atë që UNIKO ofron dhe tregjet e punës kërkojnë. Analiza e tregut të punës ka marrë në shqyrtim mundësitë për punësim dhe nevojat e tregut në sektorin e marketingut në harmoni me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar.</p> <p>Departamenti dhe sektori i Alumnit e Këshillimit të Karrierës ka krijuar lidhje me biznese lokale dhe kombëtare duke ndihmuar në përshtatjen e të diplomuarve me tregun e punës. Vlerë e shtuar në këtë drejtim janë dhe eventet e aktivitetet e organizuara nga njësia dhe të pasqyruara në evidencë 1.41.</p> <p><i>GVJ rekomandon se njësia përgjegjëse e programit të studimit, në bashkëpunim me Sektorin e Alumnit dhe Këshillimit të Karrierës të gjurmohet me rigorozitet e përditësojë periodikisht punësimin real të studentëve të diplomuar dhe të ndjekë zhvillimet në sektorin përkatës përmes marrëveshjeve të ngushta me tregun e punës, të cilat të evidentura statistikisht do ti shërbejnë si avantazh konkurrues i programit dhe si promotor i tij për brezat e ardhshëm.</i></p> <p><i>Evidenca I.27 - Studime tregu</i> <i>Dokument Shtesë 1-Studim Tregu në rang Fakulteti</i> <i>Evidenca I.41- Aktivitete DMT</i></p>
<p>Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënësve, garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë</p>	<p>Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor ABM është i organizuar në tre vite akademike me lëndë të detyrueshme dhe me zgjedhje të vlerësuara me një total prej 180 kreditesh (60 kredite çdo vit), konform ligjit Nr. 80/2015 Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë.</p> <p>Nga dokumentacioni i shqyrtuar dhe vizitat në Institucion, konkretisht referuar: Kërkesës për hapjen dhe organizimin e</p>

Gen Alumnit

[Signature]

punësimin e studentëve.

programit të studimit-Bachelor “Administrim Biznesi në Marketing” si dhe Rregullores së programit, GVJ konstatoi se, programi i studimit është strukturuar sipas kriterëve të arsimit të lartë,dhe përshtatur mbi bazën e bashkëpunimeve me universitete të tjera kombëtare e ndërkombëtare, veçanërisht bashkëpunimit me Universitetin e Tiranës. Në këtë program studimi vëmendje i është kushtuar përmbajtjes së kurrikulës dhe cilësisë së informacionit të ofruar për të siguruar formimin dhe kopetencat e kërkuara nga bizneset rajonale dhe kombëtare. Këtë e dëshmon dhe përmbajtja e programit të studimit, e cila përbëhet nga (6) lëndë bazë, (19) lëndë të formimit karakterizues (5) lëndë ndërdisiplinore, (3) lëndë plotësuese dhe Mikroteza.

Lëndët e profilit marketing ose karakterizuese janë shtuar për të garantuar përfitim të dijeve dhe kompetencave aktuale të profilit. Siç u njohëm nga takimi me përgjegjësen e njësisë së programit të studimit dhe stafit, këto ndryshime kanë ardhur si pasojë e nevojës për thellim të njohurive praktike e teorike të studentëve në formim në fushën specifike dhe për lehtësim të punësimit të tyre. Rezultatet e ndryshimeve janë vlerësuar nga feedback i marrë nga bizneset e rajonit të Korçës dhe nga studimi i tregut në nivel fakulteti, ku fokusi kanë qënë gjimnazistët, studentet dhe të tretët kanë qënë institucionet private në rajonin e Korçës.

GVJ konstaton se program i studimit përmbush objektivin kryesor të formimit të specialisteve të aftë për të punuar në marketing dhe realizimin e studimeve të avancuara në këtë fushë.

Studentët aftësohen për të punuar në hartimin dhe zbatimin e strategjive dhe taktikave të komunikimit marketing, të menaxhimit të marrëdhënieve me konsumatorët, të produktit dhe menaxhimit të markës, të kanaleve të shpërndarjes si dhe orientohen drejt tregjeve, bizneseve ndërkombëtare.

GVJ sugjeron që praktika mësimore të kenë një peshë më të madhe në programin e studimit (jo vetëm 2 kredite) me qëllim aftësimin e studentëve në tregun e punës.

Dokument Shtesë 1-Studim Tregu në rang Fakulteti

Evidenca I.27 - Studime tregu



Evidenca I.26 – Rregullore Programit të Studimit

Evidenca I.34/2 - VKM për riorganizimin e programit të studimit

Evidenca II.01 - Planet mësimore: 2021-2024; 2020-2023;

	2019-2020		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	



Standardi I.4	
Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.</p>	<p>UNIKO ka përvojën dhe kapacitetet në fushën akademike për përmbushjen e qëllimit të programit të studimit Bachelor Administrim Biznesi në Marketing. Ky program ofrohet nga Departamenti i Marketing-Turizëm, njësi bazë e Fakultetit të Ekonomisë i cili nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies dhe veprimtaritë kërkimore, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik si edhe shfrytëzuar burimet materiale dhe financiare në dispozicion të tij. Në statutin dhe rregulloren e UNIKO gjejmë mënyrën e organizimit të institucionit, kompetencat e organeve drejtuese akademike, kolegiale dhe administrative të institucionit. Hartimi i programit bachelor vë në efikasitet burimet njerëzore të UNIKO pasi integron stafin e departamenteve të tjera me qëllim marrjen e njohurive dhe kompetencave bazë në administrim biznes dhe plotësimin e profilizimit në marketing.</p> <p>Sipas të dhënave të tre viteve të fundit të personelit akademik të njësisë përgjegjëse Departamenti i Marketing Turizëm përbëhet nga 10 PAE ku 5 kanë titullin “Profesorë të Asociuar”, 4 kanë gradën Dr./PhD, dhe 1 Asistent Lektorë (Msc.) me Dr. në proces; Krahasuar me tre vitet akademike nuk ka ndryshuar numri i personelit PAE çka tregon qëndrueshmëri në burimet e programit. Qëndrueshmëria e stafit ka inkurajuar specializimin e tij në profilin bizneseve në sektorin e marketingut dhe është kualifikuar në vijimësi në bashkëpunim me institucionet kombëtare e ndërkombëtare.</p> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, takimi me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe takimet me stafin u vu re një rekrutim i ulët i stafit të ri, kjo në përputhje dhe me numrin e studentëve.</p> <p><i>Evidenca I.37- Të dhëna për stafin akademik në programin e studimit</i> <i>Dokument shtesë 3 -Struktura e stafit të Departamentit Marketing Turizëm</i></p>


	<p><i>Evidenca I.02 - Rregullore e Organizimit dhe Veprimitarisë Mësimore Kërkimore Shkencore të UNIKO</i></p> <p><i>Evidenca I.32 - Rregullore e brendshme e FE</i></p>			
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>UNIKO vepron brenda kornizave ligjore dhe respekton ligjin e Arsimit të Lartë në fuqi (L.80/2015 Neni 23 pika 1) dhe përcaktimet statutoare. Strukturat janë të formuara që të garantojnë arritjen e misionit të UNIKO në pëmbushje të autonomisë akademike. Stafi akademik i UNIKO ka konsoliduar strukturën e kërkimit shkencor dhe zhvilluar objektivat e kërkimit në përputhje me fushën përkatëse të formimit të specifikuar dhe në Planin Strategjik të institucionit 2021-2026.</p> <p>Në takimin e zhvilluar me stafin akademik u pohua se personeli është nxitur të marrë pjesë në projekte kërkimore, konferenca e aktivitete të tjera shkencore, të publikojë rezultatet e punës kërkimore, duke përfituar edhe mbështetje financiare përmes akordimit të granteve kërkimore.</p> <p><i>Evidenca I.01 - Statuti i UNIKO</i></p> <p><i>Evidenca I.02 - Rregullore e Organizimit dhe Veprimitarisë Mësimore Kërkimore Shkencore të UNIKO</i></p> <p><i>Evidenca I.26 - Rregullore e programit të Studimit</i></p> <p><i>Evidenca I.03.1 - Plani strategjik i zhvillimit të UNIKO 2021-2026</i></p>			
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor Administrim Biznesi në Marketing është i organizuar në tre vite akademike me një total prej 180 kreditesh (60 kredite çdo vit) me kohë të plotë</p> <p>Programi i Studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të vendosur nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.</p> <p>Kodifikimi i tij është në bazë të Udhëzimit nr.45 datë 19.12.2011 të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.</p>			
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi I.5

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Nga vizita në institucion, GVJ konstatoi se për mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit të studimit Bachelor Administrim Biznesi në Marketing, Departamenti i Marketing-Turizëm si njësi bazë përgjegjëse koordinon punën për të përmbushur objektivat e programit dhe angazhuar staf të kualifikuar. Lëndët karakterizuese të programit mbulohen nga stafi i Departamentit, ndërsa angazhohet staf nga departamentet e tjera të Fakultetit të Ekonomisë UNIKO për lëndët e formimit bazë dhe lëndë plotësuese. I gjithë procesi për përmbushjen e disiplinave të formimit dhe mbarëvajtjen e procesit mësimor mbikëqyret nga instancat drejtuese të UNIKO duke filluar nga Rektori, Dekani, Përgjegjësi i Departamentit, NJSBC etj. Çdo vit akademik realizohet dhe një analizë e punës së njësive në përputhje me Rregulloren dhe Statutin e UNIKO-së.</p> <p><i>Evidenca I.01- Statuti i UNIKO</i> <i>Evidenca I.02 - Rregullore e Organizimit dhe Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore, UNIKO</i> <i>Evidenca I.32- Rregulloren e Brendshme e FE</i></p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ ose të huaj.</p>	<p>Për realizimin e objektivave të procesit mësimor, UNIKO ka marrëveshje me palët e treta, institucione e biznese për shkëmbim ekspertize në funksion të procesit mësimor dhe realizimin të objektivave të programit të studimit. Një bashkëpunim të gjerë UNIKO ka me Fakultetin Ekonomik, Universiteti i Tiranës, në bashkëpunim me të cilin është hartuar ky program. Ndërsa numëron një numër të konsiderueshëm bashkëpunimesh me aktorë biznesi lokalë e rajonalë, siç u pohua nga takimi me Dekanen dhe Përgjegjësen e Departamentit. GVJ i janë vënë në dispozicion marrëveshjet e bashkëpunimit të nënshkruara me këto biznese që u japin mundësi studentëve të kryejnë praktika profesionale dhe aktivitete të tjera të përbashkëta. Gjithashtu UNIKO ka krijuar disa marrëveshje bashkëpunimi me institucione homologe edhe jashtë vendit përmes programit Erasmus+ me objekt shkëmbimin e burimeve njerëzore dhe ndërtimin e programeve të reja të studimit.</p> <p><i>Evidenca I.39 - Marrëveshje Institucionale</i> <i>Evidenca I.40 - Marrëveshje Bashkëpunimi të FE</i></p>
<p>Kriteri 3. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të</p>	<p>Në fund të vitit akademik, Departamenti Marketing – Turizëm bën analizën e punës mësimore dhe shkencore, ku përveç aspekteve të tjera të punës për mbarëvajtjen e programit të studimit, shqyrton dhe analizon marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet e tjera.</p>




studimeve.	<p>Departamenti Marketing-Turizëm ka hartuar relacione për përfitimet e realizimit të praktikave profesionale dhe ka përcaktuar përmirësimet që duhet të bëhen në të ardhmen.</p> <p><i>GVJ konstaton se mungojnë analiza për përfitimet konkrete të marrëveshjeve të bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit mësimor.</i></p> <p><i>GVJ sugjeron një angazhim më të madh të Zyrës së Karrierës dhe Njësisë përgjegjëse për të rritur peshën dhe kohëzgjatjen e praktikës mësimore në planin mësimor të programit dhe rritje të trainimeve për sigurimin e aftësive praktike, mënyrës së kërkimit të punësimit për studentët e këtij programi studimi.</i></p> <p><i>Evidenca I.40 - Marrëveshje Bashkëpunimi të FE</i> <i>Evidenca I.42- Relacione praktike</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.</p>	<p>UNIKO ka vendosur në dispozicion të GVJ dokumentin me institucione e kompani në të cilat studentët e programit Bachelor Administrim Biznesi në Marketing kanë mundësi të zhvillojnë praktikat e tyre. Procesi mbikëqyret nga Departamenti në bashkëpunim me pedagogun mbikëqyrës të praktikës.</p> <p>Studenti e zhvillon praktiken në semestrin e 6-të, dy javë mësimore. GVJ u njoh me procedurën e mbikëqyrjes së praktikës në vizitën në institucion, ku pasi analizohen marrëveshjet bëhet dhe një mbledhje në departament si pjesë përgatitore. Përcaktohen vendet e praktikës dhe bëhet ndarja e studentëve në grupe sipas udhëzuesit të praktikës. Ndjekja bëhet sipas nje dokumenti te veçantë ku janë të parashikuar emri i studentit, pedagogut udhëheqes dhe biznesit. Çdo pedagog ka në udhëheqje 3-4 studentë.</p> <p><i>GVJ në përputhje dhe me sugjerimet e stafit, rekomandon që të zgjerohen marrëveshjet e bashkëpunimit jashtë rrethit të Korçës në mënyrë që studentët të zhvillojnë aftësi dhe përvoja në biznese më të mëdha kombëtare e ndërkombëtare.</i></p> <p><i>Evidenca I.39 - Marrëveshje Institucionale</i> <i>Evidenca I.40 - Marrëveshje Bashkëpunimi</i> <i>Evidenca I.42- Relacione praktike</i> <i>Evidenca I.44 - Udhëzues Praktike</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkëpunim me punëdhënësit.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor Administrim Biznesi në Marketing synon arsimim shkencor e profesional të studentëve në fushën e Marketingut, duke pajisur studentët me njohuritë themelore të fushës. Programi synon të zhvillojë shprehitë, kompetencat dhe aftësitë e studentëve në marketingun e bizneseve. Departamenti</p>

Gen Ahmeti

[Signature]

	<p>Makreting-Turizëm është i angazhuar për trajtime të mëtejshme profesionale në funksion të programit të studimit, në bashkëpunim me Qendrën e Karrierës dhe Alumni dhe Qendrën e Inovacionit. GVJ u informua lidhur me aktivitetet dhe trainimet e zhvilluara përmes Evidencës 1.41 dhe vizitës në institucion, ku u veçuan trajnime me fokus promovimin e modeleve të inovacionit, menaxhimit të SME-ve dhe Start-up-ëve, për studentët e diplomuar në bashkëpunim me bizneset e institucionet lokale në kuadër të projektit “Innovation Eco-System in the CBC area”.</p> <p><i>Evidenca I.41-Aktivitete DMT</i> <i>Evidenca I.39 - Marrëveshje Institucionale</i> <i>Evidenca I.40 - Marrëveshje Bashkëpunimi</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumenteve dhe diskutimet e zhvilluara me përfaqësues të UNIKO-së, GVJ konstaton se programi i ciklit të parë të studimit Bachelor në Administrim Biznesi në Marketing, është organizuar në lëndë dhe module të vlerësuara në kredite në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi (Ligjin 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe VKM Nr. 41, datë 24/01/2018 “Për Elementët e Programit të Studimit Ofruar nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, e ndryshuar) dhe në përputhje me Sistemin Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS)</p> <p><i>Evidenca I.26 a,b,c - Rregullore e programit të studimit Bachelor në “Administrim Biznesi në Marketing”</i></p>



Van Aliminte

[Signature]

	<p><i>Evidenca I.29 - Kurrikula e Programit të Studimit Bachelor në "Administrim Biznesi në Marketing"</i></p>
<p>Kriteri 2. Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.</p>	<p>GVJ konstaton se rregullorja e programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në Administrim Biznesi në Marketing synon formimin profesional dhe kualifikimin shkencor të studentëve duke iu siguruar atyre një përgatitje të gjerë dhe mundësi që të përshtaten me nevojat aktuale të tregut të punës duke u krijuar mundësi të gjerë punësimi në profesione e specialitete, si: specialist krijues i reklamave; menaxher i markës, biznesit, ngjarjes, biznesit strategjik ose shitjes; specialist i marrëdhënieve me klientët; analist i kërkimit të tregut; përfaqësues shitjesh; koordinator i shitjeve dhe marketingut; strateg i biznesit të vogël; promovues i sporteve; menaxher eksport/importi; menaxher marketingu në sektorin publik; konsulent biznesi; koordinator i reklamimit; asistent i marketingut krijues.</p> <p><i>Evidenca I.26 a,b,c - Rregullore e programit të studimit Bachelor në "Administrim Biznesi në Marketing"</i></p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuar në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>GVJ konstaton se programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në ABM ka përcaktuar qartë objektivat që lejojnë formimin e studentëve duke zhvilluar njohuri, aftësi dhe kompetenca profesionale dhe analitike në fushën e marketingut, menaxhimit të biznesit, menaxhimit të burimeve njerëzore, etj, të nevojshme për zgjidhjen e problematikave komplekse në këtë fushë dhe është hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës. Fushat e kompetencës profesionale përcaktohen si: specialist krijues i reklamave; menaxher i markës, biznesit, ngjarjes, biznesit strategjik ose shitjes; specialist i marrëdhënieve me klientët; analist i kërkimit të tregut; përfaqësues shitjesh; koordinator i shitjeve dhe marketingut; strateg i biznesit të vogël; promovues i sporteve; menaxher eksport/importi; menaxher marketingu në sektorin publik; konsulent biznesi; koordinator i reklamimit; asistent i marketingut krijues.</p> <p>Gjithashtu, konstatohet se programi ofron edhe mundësinë e zgjedhjes së lëndëve me zgjedhje, ku studenti mund të zgjedhë lëndët të cilat kërkon të zhvillojë më tej njohuritë. Gjithashtu, ky program kujdeset që të pajisë studentët me njohuritë bazë të nevojshme për të ndjekur ciklet e tjera të njëpasnjëshme të studimit.</p> <p>Duke vlerësuar dosjen e këtij programi studimi si dhe duke u bazuar në konstatimet e realizuara gjatë vizitës në UNIKO, mund të konkludojmë se ky program studimi është hartuar që të</p>

	<p>zhvillojë studentët me njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fushën e studimit për të cilën është hapur.</p> <p><i>Evidenca I.26 a,b,c - Rregullore e programit të studimit Bachelor në "Administrim Biznesi në Marketing"</i></p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>GVJ konstaton se program i studimit të ciklit të parë Bachelor në ABM arrin t'u japë studentëve njohuritë e nevojshme dhe bazë për formimin e tyre si specialistë/administratorë biznesi të marketingut dhe për vazhdimin e studimeve të mëtejshme në fushat e administrim biznesit dhe marketingut. Programi studimit jep një sistem bazë njohurish formuese, aftësi dhe kompetenca profesionale dhe analitike në menaxhimin e markës, marketingun dixhital, kërkimin në marketing, marketingun ndërkombëtar, marketingun e shërbimeve, komunikimin në marketing, etj, me qëllim formimin e specialistëve të aftë për të punuar në marketing dhe administrim biznesi, për zgjidhjen e problemeve komplekse të një biznesi apo organizate dhe për realizimin e studimeve të avancuara në këtë fushë.</p> <p><i>Evidenca I.26 a,b,c - Rregullore e programit të studimit Bachelor në "Administrim Biznesi në Marketing"</i></p> <p><i>Evidenca I.29 - Kurrikula e Programit të Studimit Bachelor në "Administrim Biznesi në Marketing"</i></p> <p><i>Evidenca I.30 a,b,c - Programet Lëndore - Programi i Studimit "Administrim Biznesi në Marketing"</i></p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>Duke u bazuar në dosjen e këtij programi studimi dhe konstatimet e realizuara gjatë vizitës në UNIKO, mund të konkludojmë se ky program studimi përmban elementet e nevojshëm të legjislacionit në fuqi (Ligjin 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë") që lejon krijimin e strukturës së tij. Gjithashtu, plani mësimor i këtij programi është i ndarë në module dhe lëndë të vlerësuara me kredite sipas Sistemin Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS), duke respektuar veprimtaritë formuese, bazuar në VKM Nr. 41, datë 24/01/2018 "Për Elementët e Programit të Studimit Ofruar nga Institucionet e Arsimit të Lartë", e ndryshuar. Gjithashtu, struktura e planit mësimor, mënyra e kontrollimit të dijeve dhe instrumentet e vlerësimit, objektivat formuese dhe komponentët mësimorë, kryerja e praktikës profesionale, kuotat dhe kriteret e pranimit, plani mësimor dhe modeli i programeve lëndore janë në përputhje me VKM Nr. 41, datë 24/01/2018, e ndryshuar dhe me rregulloren e Fakultetit të Ekonomisë,</p>

	<p>rregullore e programit të studimit, kurrikulën e programit dhe programet lëndore.</p> <p>GVJ konstatoi që të gjitha elementet janë të pasqyruara në rregulloren e programit të studimit.</p> <p><i>Evidenca I.32 Rregullore e Brendshme e Fakultetit të Ekonomisë.</i></p> <p><i>Evidenca I.26 a,b,c - Rregullore e programit të studimit Bachelor në "Administrim Biznesi në Marketing"</i></p> <p><i>Evidenca I.29 - Kurrikula e Programit të Studimit Bachelor në "Administrim Biznesi në Marketing"</i></p>			
<p>Kriteri 6. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>GVJ konstatoi se ky program studimi ka përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar modulet në përputhje me kategoritë e përcaktuara në VKM nr.41 dt. 24/01/2018, të ndyshuar, dhe ka përcaktuar gjithashtu edhe ngarkesën përkatëse në kredite për secilën kategori të veprimtarive formuese brenda këtij programi studimit duke respektuar peshën e përcaktuar në VKM nr.41 dt. 24/01/2018, të paraqitura si më poshtë:</p> <p>Lëndë bazë – 6 module (19%)</p> <p>Lëndë karakterizuese –19 module (53%)</p> <p>Lëndë ndërdisiplinore/integruese – 5 module (15%)</p> <p>Lëndë plotësuese – 5 module (9%)</p> <p>Detyrime përmbyllëse (përgatitja e tezës së diplomës) – (4%)</p> <p>Programi i studimit Bachelor në "Administrim Biznesi në Marketing" është i organizuar me 180 kredite formimi dhe ka një kohëzgjatje 3 vite akademike.</p> <p><i>Evidenca I.26 a,b,c - Rregullore e programit të studimit Bachelor në "Administrim Biznesi në Marketing"</i></p> <p><i>Evidenca I.29 - Kurrikula e Programit të Studimit Bachelor në "Administrim Biznesi në Marketing"</i></p> <p><i>Evidenca I.30 a,b,c - Programet Lëndore - Programi i Studimit "Administrim Biznesi në Marketing"</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për</p>	<p>GVJ konstaton se njësia kryesore përgjegjëse, Fakulteti i</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

20




<p>programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Ekonomisë (FE), dhe njësi bazë, Departamenti i Marketing-Turizmit, kanë përmbushur detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin e tyre në përputhje me ligjin në fuqi (Ligji 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”). FE funksionon me tre njësi bazë dhe ofron studime të ciklit të parë dhe të dytë.</p> <p><i>Evidenca 1.1 - Statuti i UNIKO</i> <i>Evidenca 1.1.1 Draft Statuti i Ndryshuar i UNIKO</i> <i>Evidenca 1.2 - Rregullore e UNIKO</i> <i>Evidenca 1.32 Rregullore e Brendshme e Fakultetit të Ekonomisë.</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinatori i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.</p>	<p>GVJ konstaton se koordinatori i programit të studimit Bachelor në “Administrim Biznesi në Marketing” është i caktuar dhe është personel akademik i këtij program studimi dhe detyrat e koordinatorit të programit janë të përcaktuara në Rregulloren e Departamentit të Marketing-Turizmit.</p> <p><i>Evidenca II.09 - Vendim i Emërimit të Koordinatorit të Programit të Studimit “Administrim Biznesi në Marketing”</i> <i>Evidenca I.46 - Rregullore e Brendshme e DMT.</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>GVJ konstaton se Fakulteti i Ekonomisë, që është përgjegjëse për programin e studimit, funksionon në përputhje me ligjin në fuqi (Ligjin 80/2015) dhe përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike. FE është i organizuar në 3 njësi bazë për zhvillimin e mësimin dhe punës kërkimore-shkencore. Organizimi dhe funksionimi i këtyre njësive bazë parashikohet në statutin e UNIKO-së, rregulloren e FE dhe rregulloret e njësive bazë. Ky fakultet ofron studime me kohë të plotë në programe profesionale dy-vjeçare, programe studimi të ciklit të parë Bachelor, të ciklit të dytë Master Profesional dhe Master i Shkencave dhe përbëhet nga 34 personel akademik: 14 profesorë të asociuar, 14 doktorë shkencash, 4 studentë doktorature dhe 2 master i shkencave.</p> <p><i>Evidenca I.46 - Rregullore e Brendshme e DMT.</i> <i>Evidenca I.35 - Personeli Akademik dhe Ndihmësakademik i Fakultetit të Ekonomisë</i></p>
<p>Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit</p>	<p>GVJ konstaton se Departamenti i Marketing-Turizmit, që është njësi bazë përgjegjëse për organizimin e programit të studimit Bachelor në “Administrim Biznesi në Marketing”, i përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit</p>

Gen Alimant

[Signature]

akademik.	<p>akademik dhe menaxhimin dhe organizimin e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore/shkencore në zbatim të akteve ligjore dhe nën-ligjore, Statutit të UNIKO, rregullores së UNIKO dhe rregullores së FE. Stafi akademik i DMT përbëhet nga 10 personel akademik efektiv: 5 profesorë të asociuar, 4 doktorë shkencash, 1 student doktrate.</p> <p>Kualifikimi i personelit akademik përkon me fushën e studimit dhe modulet që mbulojnë dhe është i kualifikuar dhe i aftë për të përmbushur detyrimet e këtij programi studimi në përputhje me ligjin në fuqi.</p> <p><i>Evidenca I.35 - Personeli Akademik dhe Ndhmësakademik i Fakultetit të Ekonomisë</i></p>			
<p>Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>GVJ konstaton se stafi ndihmës akademik me karakter mësimor dhe administrative i FE mbështet nevojat e DMT dhe programit të studimit ABM. Nga shqyrtimi i CV-ve të personelit akademik dhe ndihmës akademik u konstatua se kanë përvojën dhe kualifikimin e duhur dhe përmbushin detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p> <p><i>Evidenca I.35 - Personeli Akademik dhe Ndhmësakademik i Fakultetit të Ekonomisë</i></p> <p><i>Evidenca II.10.2 - CV – Stafi Akademik Programi i Studimit Administrim Biznesi në Marketing</i></p> <p><i>Evidenca II.17 - CV Stafi Ndhmës Akademik</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi II.3</p>	
<p>Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita në UNIKO, GVJ konstatoi se njësia bazë përgjegjëse për organizimin e programit të studimit Bachelor në “Administrim Biznesi në Marketing” disponon dokumentacionin e plotë për këtë program studimi ku përfshihen: statuti i UNIKO, rregullorja e UNIKO, rregullorja e FE, rregullorja e DMT, rregullorja e programit të studimit Bachelor në “Administrim Biznesi në Marketing”, Kurrikula e programit të studimit Bachelor në ABM dhe programet lëndore.</p>

Ben Ahmeti

AZ

	<p><i>Evidenca 1.1 - Statuti i UNIKO</i></p> <p><i>Evidenca 1.2 - Rregullore e UNIKO</i></p> <p><i>Evidenca I.32 Rregullore e Brendshme e Fakultetit të Ekonomisë.</i></p> <p><i>Evidenca I.26 a,b,c - Rregullore e programit të studimit Bachelor në "Administrim Biznesi në Marketing"</i></p> <p><i>Evidenca I.29 - Kurrikula e Programit të Studimit Bachelor në "Administrim Biznesi në Marketing"</i></p> <p><i>Evidenca I.30 a,b,c - Programet Lëndore - Programi i Studimit "Administrim Biznesi në Marketing"</i></p>
<p>Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p>	<p>GVJ konstatoi se programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në "Administrim Biznesi në Marketing" është ndërtuar në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi (VKM nr.41 dt. 24/01/2018, e ndryshuar). Në të pasqyrohen objektiva formues dhe kompetenca profesionale përcaktuese dhe specifike që duhet të ofrojë një program studimi Bachelor në "Administrim Biznesi në Marketing".</p> <p><i>Evidenca I.26 a,b,c - Rregullore e programit të studimit Bachelor në "Administrim Biznesi në Marketing"</i></p> <p><i>Evidenca I.29 - Kurrikula e Programit të Studimit Bachelor në "Administrim Biznesi në Marketing"</i></p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>GVJ konstatoi se plani mësimor i programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në "Administrim Biznesi në Marketing" është i organizuar në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në 3 vite me 2 semestra secili vit. Planin mësimor përmban 36 lëndë dhe është i ndarë në vitin e parë 11 lëndë (60 kredite), vitin e dytë 13 lëndë (60 kredite) dhe vitin e tretë 12 lëndë (60 kredite) me një total prej 180 kreditesh.</p> <p><i>Evidenca I.26 a,b,c - Rregullore e programit të studimit Bachelor në "Administrim Biznesi në Marketing"</i></p> <p><i>Evidenca I.29 - Kurrikula e Programit të Studimit Bachelor në "Administrim Biznesi në Marketing"</i></p> <p><i>Evidenca I.30 a,b,c - Programet Lëndore - Programi i Studimit "Administrim Biznesi në Marketing"</i></p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, GVJ konstatoi se në programet e studimit të Bachelor në ABM është paraqitur edhe plani mësimor, ku pasqyrohen informacionet mbi objektivat formues dhe kompetencat profesionale përcaktuese, struktura në javë, vit, semetra, ngarkesa mësimore e çdo lënde dhe kreditet, tipi i veprimtarisë lëndore, lloji i orëve mësimore të ndara në leksione, seminare, ushtrime, praktika, laboratore brenda dhe jashte</p>

Osman Ahmeti

[Signature]

	<p>auditoreve, mënyrën e vlerësimit të dijeve, specifikimi i vitit dhe semestrit ku zhvillohet lënda, frekuentimi (lëndë e detyruar dhe lëndë me zgjedhje) dhe periudha e frekuentimit të çdo moduli.</p> <p>Nga bisedat e kryera në Departament, GVJ u informua se ndryshimet në planin mësimor hartohen nga DMT (Njësia Bazë) çdo fund viti akademik dhe miratohen nga Senati i UNIKO.</p> <p>U konstatua se plani mësimor u informohet studentëve në fillim të studimeve përmes afishimeve në stendat e FE, Zyrës së Informimit të Studentëve, veprimtarisë Ditët e Informimit të Maturantëve dhe faqes web të UNIKO.</p> <p><i>GVJ konstatoi se faqja web e UNIKO është përkohësisht e paaksesueshme për arsye se marrëveshja me RASH ka skaduar..</i></p> <p><i>Evidenca 1.1 - Statuti i UNIKO</i> <i>Evidenca 1.1.1 Draft Statuti i Ndryshuar i UNIKO</i> <i>Evidenca 1.2 - Rregullore e UNIKO</i> <i>Evidenca I.32 Rregullore e Brendshme e Fakultetit të Ekonomisë.</i> <i>Evidenca I.26 a,b,c - Rregullore e programit të studimit Bachelor në "Administrim Biznesi në Marketing"</i> <i>Evidenca I.29 - Kurrikula e Programit të Studimit Bachelor në "Administrim Biznesi në Marketing"</i> <i>Evidenca I.30 a,b,c - Programet Lëndore - Programi i Studimit "Administrim Biznesi në Marketing"</i> <i>Evidenca II.14 Kalendar i Veprimtarisë Ditët e Informimit të Maturantëve</i></p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>GVJ konstatoi se në statutin dhe rregulloren e UNIKO-së, rregulloren e FE, rregulloren e Departamentit dhe rregulloren e programit të studimit pasqyrohen qartë të gjitha informacionet e nevojshme në lidhje me kriteret e pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve në përputhje me ligjin në fuqi (Ligjit 80/2015).</p> <p>GVJ u informua se kriteret e transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve diskutohen çdo vit në DMT dhe më pas miratohen nga senati i UNIKO.</p> <p>Nga dokumentacioni u konstatua se kriteret specifike të vendosura nga departamenti janë cilësia e maturantit, profili e mesatarja e lëndëve specifike.</p> <p>Gjithashtu, u konstatua se çdo vit DMT vlerëson dosjet e transferimeve në këtë program përmes komisionit të vlerësimit dhe ekuivalentimit që ngrihet dhe vlerëson dokumentacionin e aplikuesve sipas kriterëve të Ligjit 80/2015, rregullores së FE dhe</p>

Osman Ahmeti

[Signature]

	<p>rregullores së programit të studimit ABM. Kuotat e pranimit janë të vendosura në rregulloren e programit të studimit ABM.</p> <p><i>Evidenca 1.1 - Statuti i UNIKO</i> <i>Evidenca 1.2 - Rregullore e UNIKO</i> <i>Evidenca I.32 Rregullore e Brendshme e Fakultetit të Ekonomisë.</i> <i>Evidenca I.26 a,b,c - Rregullore e programit të studimit Bachelor në "Administrim Biznesi në Marketing"</i></p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>GVJ konstatoi se në rregulloren e programit të studimit ABM janë të paraqitura lëndët, viti, semestri, format e kontrollit të dijës, mënyrën e organizimit të seminareve, literaturën dhe detyrimet etj, sipas modelit të përcaktuar në VKM nr. 41, 24/01/2018, e ndryshuar.</p> <p>U shqyrtua që programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p> <p>GVJ u informua se programet lëndore vihen në dispozicion edhe nëpërmjet sistemit ESSE3 nga marrëveshja e midis UNIKO dhe RASH për përdorimin e sistemit ESSE3, marrëveshje kjo e cila aktualisht ka skaduar.</p> <p><i>Evidenca 1.1 - Statuti i UNIKO</i> <i>Evidenca 1.2 - Rregullore e UNIKO</i> <i>Evidenca I.32 Rregullore e Brendshme e Fakultetit të Ekonomisë.</i> <i>Evidenca I.26 a,b,c - Rregullore e programit të studimit Bachelor në "Administrim Biznesi në Marketing"</i> <i>Evidenca 1.6 Rregullore e ESSE 3</i> <i>Evidenca 1.6.1 Marrëveshje RASH për ESSE3</i> <i>Evidenca III.05 Marrëveshja midis UNIKO dhe RASH për ESSE3</i></p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Nga dokumentacioni dhe nga vizita në institucion, GVJ vuri re se përmbajtja e programit të studimit Bachelor në AMB është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe se ndryshimet në kurrikulën e programit të studimit bëhen çdo vit, në bazë të studimit të tregut të kryer nga vetë departamenti, tendencat shkencore, diskutimet në tryeza të rrumbullakta me bizneset dhe pyetësorin e studentëve që kryhen nga çdo pedagog çdo vit. Këto ndryshime janë në përputhje me ligjin në fuqi (Ligjit 80/2015) dhe Rregulloren e FE.</p> <p><i>Evidenca I.32 Rregullore e Brendshme e Fakultetit të Ekonomisë.</i> <i>Evidenca I.26 a,b,c - Rregullore e programit të studimit Bachelor</i></p>

Gen Alimant

[Signature]



	në "Administrim Biznesi në Marketing"			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nok përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.4	
Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	<p>GVJ konstatoi se ngarkesa mësimore për programin e studimit Bachelor në ABM është në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi (Ligjin 80/2015 dhe VKM nr. 41, 24/01/2018, e ndryshuar) dhe statutin dhe rregulloren e UNIKO-së dhe rregulloren e FE-së. Programi i studimit realizohet me 180 kredite dhe me kohëzgjatje normale 3 vite akademike, e shtrirë në 6 semestra, ku secili semestër ka 15 javë mësimore me nga 20-25 orë.</p> <p><i>Evidenca 1.1 - Statuti i UNIKO</i> <i>Evidenca 1.2 - Rregullore e UNIKO</i> <i>Evidenca I.32 Rregullore e Brendshme e Fakultetit të Ekonomisë.</i> <i>Evidenca I.26 a,b,c - Rregullore e programit të studimit Bachelor në "Administrim Biznesi në Marketing"</i></p>
Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.	<p>GVJ konstatoi se emërtimi, përmbajtja e veprimtarive formuese, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave të programit të studimit mundësojnë thellimin e njohurive dhe aftësimin e studentëve në fushën e menaxhimit të biznesit dhe marketingut dhe punësim të studentëve duke i dhënë atyre mundësi të mira punësimi në këtë fushë.</p> <p>Në takimin e realizuar me studentët e këtij programi, mësuam se orët e mësimin në auditor (leksione, seminare, ushtrime apo praktika në laboratorë) zhvillohen në formë interaktive ndërmjet pedagogut dhe studentit, ku pedagogët paraqesin shembuj të ndryshëm për të mbështetur pjesën teorike dhe raste studimi të ndryshme për të stimuluar mendimit krijues dhe kritik të studentit.</p> <p>Në planin mësimor të këtij programi studimi, për secilën lëndë, gjëjmë të pasqyruara shpërndarjen e orëve për leksione dhe seminare në auditor. Në disa lëndë të caktuara, gjatë seminarit mund të aplikohen raste studimi, detyra apo projekte kursi për të zhvilluar aftësitë komunikuese të studentëve si dhe për t'i nxitur</p>



Gen Alim

AS

	<p>ata të përvetësojnë procesin e kërkimit.</p> <p>Ndarja e lëndëve me karakter formues ndaj atyre aplikative krijon mundësinë për të fituar njohuritë teorike gjatë dy semestrave të parë dhe mundëson aftësimin gradual praktik në semestrat që vijojnë.</p> <p>Studenti, në 15 javë mësimore në auditor, gjatë leksioneve (2 orë në javë) merr njohuritë e duhura rreth çështjeve apo tematikave të caktuara për secilin modul. Gjatë seminareve studentët analizojë çështjet e leksionit, si dhe punojnë në mënyrë të pavarur apo në grup raste studimore në funksion të temave të lëndëve. Nga takimi i realizuar me studentët kuptuam se rastet e studimit që analizoheshin në klasë janë në përputhje me temat e mësimin dhe prekin çështje që kanë interes të veçantë në ditët e sotme. Ndërsa nga takimi i realizuar me pedagogët mësuam se realizimi i detyrës së kursit i aftëson studentët për të punuar në grup, për të ndarë punën, për të komunikuar në mënyrë elokvente, gjithashtu i mëson sesi duhet të mbledhin dhe të analizojnë informacion për çështje të caktuara. Edhe nga takimi i realizuar me studentët vërtetuam këtë aspekt të rëndësishëm të detyrave të kursit.</p> <p><i>Evidenca I.26 a,b,c - Rregullore e programit të studimit Bachelor në "Administrim Biznesi në Marketing"</i></p>
<p>Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional.</p>	<p>GVJ konstatoi se kurrikula e programit të studimit Bachelor në ABM është hartuar në përputhje me profilin e programit dhe nevojat e specialitetit për aftësi dhe kompetenca që kërkohen nga tregu i punës. Lëndët/modulet reflektojnë emërtimin e programit dhe i shërbejnë formimit të nevojshëm profesional dhe shkencor. Në programin e studimit Bachelor në ABM studenti krijon afësitë e nevojshme rreth ekonomisë, marketingut, statistikave, financës, kontabilitetit dhe komunikimit, të nevojshme për figurën e menaxherit të marketingut.</p> <p><i>Evidenca I.26 a,b,c - Rregullore e programit të studimit Bachelor në "Administrim Biznesi në Marketing"</i></p> <p><i>Evidenca I.29 - Kurrikula e Programit të Studimit Bachelor në "Administrim Biznesi në Marketing"</i></p> <p><i>Evidenca I.30 a,b,c - Programet Lëndore - Programi i Studimit "Administrim Biznesi në Marketing"</i></p>
<p>Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të</p>	<p>GVJ konstatoi se struktura e këtij programi studimi, duke përfshirë natyrën e moduleve të ofruara, ngarkesën e tyre në ECTS, raportin e aspekteve teorike dhe aplikimeve të mundshme praktike, është në përputhje me profilin e këtij programi Bachelor. Shpërndarja e lëndëve mundëson formimin ekonomik dhe të</p>

ngjashme ndërkombëtare.	<p>specialitetit të administrimit të biznesit të marketingut. Natyra e moduleve të ofruara dhe ngarkesa e tyre në ECTS siguron një integrim të aspekteve teorike dhe praktike në përputhje me VKM nr. 41, 24/01/2018, e ndryshuar, dhe Sistemin European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS), të cilat e përafrojnë me programet e ngjashme ndërkombëtare.</p> <p><i>Evidenca I.26 a,b,c - Rregullore e programit të studimit Bachelor në "Administrim Biznesi në Marketing"</i></p>
<p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>GVJ, pasi shqyrtoi programin e studimit Bachelor në ABM, konstatoi që është respektuar ndarja e lëndëve sipas veprimtarive formuese në përputhje me VKM nr. 41, 24/01/2018, e ndryshuar, si më poshtë:</p> <p>Lëndët e formimit bazë (përgatitja metodologjike dhe kultura e përgjithshme) – 6 lëndë (19%) Lëndë karakterizuese, (formim specifik) –19 module (53%) Lëndë ndërdisiplinore (nëndisiplina, profile grup-lëndë me zgjedhje) – 6 module (15%) Lëndë plotësuese (gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale) – 5 module (9%) Detyrime përmbyllëse (përgatitja e tezës së diplomës) – (4%) Punimi i tezës së diplomës përgatit në formën e një projekti apo përmbledhje punimesh të kryera në fushën e marketingut dhe është konform specifikimeve të dhëna në udhëzuesin e diplomës. Raportet midis formimit teorik dhe praktik të këtij programi studimi mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve</p> <p><i>Evidenca I.26 a,b,c - Rregullore e programit të studimit Bachelor në "Administrim Biznesi në Marketing"</i></p>
<p>Kriteri 6. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Nga bisedat e realizuara me grupin e vlerësimit të brendshëm dhe pedagogët që japin mësim në këtë program studimi u konstatua se personeli akademik çdo vit kryen përditësimin e literatures së detyruar dhe ndihmëse. Një pjesë e teksteve gjenden në bibliotekën e FE. Në programet lëndore nën seksionin e literaturës është e vendosur çdo tekst me referencë të plotë. Gjithashtu, është mundësuar aksesin në databaza të huaja, si EBSCO Publishing Databases, për stafin dhe studentët, të cilët mund të shkarkojnë revista, periodikë, libra dhe artikuj nga literatura ndërkombëtare.</p> <p>GVJ konstatoi se në kuadër të përmirësimit të programeve të moduleve, një feedback vjen edhe nga rezultatet e anketës që</p>



	<p>realizohen me studentët, ku ata japin mendimin e tyre si për pedagogët dhe për lëndët përkatëse të tyre.</p> <p>Nëse i referohemi shqyrtimit të syllabuseve të këtij programi studimi, për një pjesë të mirë të tyre rezulton se literatura, qoftë bazë apo ndihmëse, është relativisht e mjaftueshme dhe e përditësuar.</p> <p><i>Evidenca I.26 a,b,c - Rregullore e programit të studimit Bachelor në "Administrim Biznesi në Marketing"</i></p> <p><i>Evidenca III.06 - Biblioteka</i></p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.</p>	<p>GVJ konstatoi se programi i studimit Bachelor në ABM ka përcaktuar qartë objektivat që lejojnë formimin e studentëve duke zhvilluar njohuri, aftësi, si dhe kompetenca profesionale dhe analitike që garantojnë përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara në fushën e menaxhimit të biznesit dhe marketingut, të nevojshme për zgjidhjen e problematikave komplekse në këtë fushë.</p> <p><i>Evidenca I.26 a,b,c - Rregullore e programit të studimit Bachelor në "Administrim Biznesi në Marketing"</i></p>
<p>Kriteri 8. Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>GVJ konstatoi se përmbajtja e programit të studimit Bachelor në ABM është hartuar sipas profilit dhe nevojave të specialitetit për aftësi dhe kompetenca që kërkohen nga tregu i punës. Lëndët/modulet reflektojnë emërtimin e programit dhe i shërbejnë formimit të nevojshëm profesional dhe shkencor. Në programin e studimit Bachelor në ABM studenti krijon afësitë e nevojshme rreth ekonomisë, marketingut, statistikave, financës, kontabilitetit dhe komunikimit, të nevojshme për figurën e menaxherit të marketingut. Në këtë program organizohen gjithashtu module orientuese për studentët në vitin e dytë dhe të tretë me qëllim orientimin drejt procesit të kërkimit dhe hyrjes në tregun e punës. Ky program mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje të plotë me pritshmëritë dhe kërkesat e tregut të punës.</p> <p><i>Evidenca I.26 a,b,c - Rregullore e programit të studimit Bachelor në "Administrim Biznesi në Marketing"</i></p> <p><i>Evidenca I.27 Studime Tregu</i></p> <p><i>Evidenca I.31 - Module Orientuese për Studentët drejt Procesit të Kërkimit dhe Hyrjes në Tregun e Punës</i></p>
<p>Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse</p>	<p>GVJ sugjeron se programi i studimit i ciklit të parë Bachelor në ABM është hartuar në mënyrë që të pajisë studentët me njohuritë bazë të nevojshme për të ndjekur ciklet e tjera të studimit si</p>

Ben Ahmet

[Signature]

<p>konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>Master Profesional apo Master Shkencor.</p> <p>Ky program është hartuar duke patur parasysh zhvillimet e reja në tregjet vendase dhe ndërkombëtare që e kanë bërë të nevojshme përshtatjen e kurrikulës. Për këtë arsye departamenti kryen vazhdimisht studime tregu për të identifikuar nevojat që ka biznesi për ekspertë në fushën e menaxhimit të biznesit në marketing me synim përmirësimin e përmbajtjes së lëndëve të studimit.</p> <p><i>Evidenca I.26 a,b,c - Rregullore e programit të studimit Bachelor në "Administrim Biznesi në Marketing"</i></p> <p><i>Evidenca I.27 Studime Tregu</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi II.5</p>	
<p>Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p>	<p>GVJ konstatoi se programi i studimit Bachelor në ABM për vitin akademik 2021-2022, përbehet nga 32 staf akademik me kohë të plotë dhe 2 staf akademik me kohë të pjesshme. Për vitin akademik 2020-2021, përbehet nga 31 staf akademik me kohë të plotë dhe 2 staf akademik me kohë të pjesshme. Për vitin akademik 2019-2020, përbehet nga 31 staf akademik me kohë të plotë dhe 1 staf akademik me kohë të pjesshme. Ngarkesa e programit të studimit mbulohet në masën 98% (177 ECTS) nga stafi akademik efektiv dhe vetëm 2 % (3 ECTS) nga stafi akademik me kohë të pjesshme. Ngarkesa në orë e stafit akademik të këtij program studimi varion nga 426 ngarkesa maksimale në 112 ngarkesa minimale.</p> <p><i>Evidenca Tabelat për Aneks për Rvb.Pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi përbehet nga 2 Prof., 14 Prof. Asoc, 15 Dr dhe 3 Msc, si rrjedhojë stafi plotëson kriteret e për tu angazhuar në këtë program studimi.</p> <p>U konstatua që dosjet e plota të stafit akademik me kohë të plotë dhe atij të ftuar janë të plota dhe të depozituara pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore të UNIKO.</p>

	<p><i>Evidenca Tabelat për Aneks për Rvb.Pdf</i></p> <p><i>Evidenca II.10.2 CV – Stafit Akademik Programi i Studimit Administrim Biznesi në Marketing</i></p> <p><i>Evidenca II.10.1 Jetëshkrimet e Stafit Akademik në Programin e Studimit Bachelor “Administrim Biznesi Në Marketing”</i></p>
<p>Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>GVJ konstatoi se fushat akademike-kërkimore dhe niveli i kualifikimit të personelit akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme të angazhuar në mësimdhënie në këtë program studimi janë në përputhje me specifikat e programit të studimit.</p> <p>Nga shqyrtimi i CV-ve dhe dokumentacionit të personelit akademik, u vu re se në tërësi fusha e ekspertizës së pedagogut përputhet me syllabusin e lëndës në të cilën është titullar. Stafit akademik është i angazhuar në këshillim për studentët dhe ndihmon e asiston në detyra administrative.</p> <p><i>GVJ konstaton se ka në përbërje të departamentit staf akademik pa gradë shkencore Doktor. Si dhe sugjeron të angazhohen profesionistë me eksperiencë në module për aftësimin praktik të studentëve në fushën specifike të lëndës.</i></p> <p><i>Evidenca II.10.1 - CV e stafit akademik</i></p> <p><i>Evidenca I.26 a,b,c - Rregullore e programit të studimit Bachelor në “Administrim Biznesi në Marketing”</i></p> <p><i>Evidenca II.10.2 CV – Stafit Akademik Programi i Studimit Administrim Biznesi në Marketing</i></p> <p><i>Evidenca II.10.1 Jetëshkrimet e Stafit Akademik në Programin e Studimit Bachelor “Administrim Biznesi Në Marketing”</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi se në programin e studimit Bachelor në ABM rezultoi se studentët e vitit të tretë në semestrin e 2-të zhvillojnë praktikën profesionale dhe paralelisht përgatisin temën e diplomës.</p> <p>Për t'i dhënë mundësi studentëve për të kryer praktikën profesionale, UNIKO ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues të bizneseve dhe kompanive dhe ka vënë në dispozicion personelin e mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen në procesin e praktikës profesionale dhe përgatitjes së temës së diplomës.</p> <p>Pavarësisht vështirësive që mbart procesi i praktikave profesionale, institucioni mundohet të ketë një bashkëpunim sa më të mirë me aktorët e tregut të punës.</p> <p>Udhëzimet specifike të mbikëqyrjes në procesin e praktikës profesionale dhe udhëheqjes gjatë përgatitjes së temës së</p>

Ben Ahmet

[Signature]

	<p>diplomës janë të përcaktuara në rregulloren e programin e studimit Bachelor në ABM.</p> <p><i>GVJ inkurajon për më tepër veprimtari praktike të praktikës profesionale me qëllim forcimin e mjeshtrive teknike e aplikative në përafrim të kërkesave të tregut të punës dhe të sigurojë më tepër marrëveshje me biznese të fushës së programit të studimit.</i></p> <p><i>Evidenca I.39 - Marrëveshje Bashkëpunimi midis Universitetit Uniko dhe Universiteteve dhe Institucioneve të Tjera</i> <i>Evidenca I.40 - Marrëveshjet e Bashkëpunimit midis Fakultetit të Ekonomisë të UNIKO dhe Universiteteve dhe Institucioneve të Tjera</i></p>
--	---

<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Nga vizita e realizuar në ambjentet e FE, GVJ vuri re se janë në funksion të studentëve laboratore dhe mjedise mësimore, të përshtatshme për realizimin e orëve laboratorike dhe praktikave dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore janë strukturat përgjegjëse IT në nivel institucioni dhe njësie kryesore. Nga biseda me studentët u shqyrtua se gjatë këtyre orëve, krahas pedagogut të lëndës asistojnë edhe stafi ndihmës akademik që janë përgjegjës për këto laboratorë duke dhënë ndihmën e tyre në realizimin dhe mbështetjen e orës laboratorike.</p> <p><i>Evidenca 1.1 - Statuti i UNIKO</i> <i>Evidenca 1.1.1 Draft Statuti i Ndryshuar i UNIKO</i> <i>Evidenca 1.2 - Rregullore e UNIKO</i> <i>Evidenca I.32 Rregullore e Brendshme e Fakultetit të Ekonomisë.</i> <i>Evidenca I.26 a,b,c - Rregullore e programit të studimit Bachelor në "Administrim Biznesi në Marketing"</i> <i>Evidenca II.17 - CV stafi ndihmës akademik</i></p>
--	--

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Van Alim

[Signature]

Standardi III.1

Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.

Kriteret

Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.

Vlerësimi i ekspertëve

Nga vizita në institucion GVJ konstatoi se njësi përgjegjëse e programit të studimit në bashkëpunim me NJSBC kujdeset për monitorimin e procesit mësimor dhe garantimin e mësimdhënies cilësore duke marrë veprime konkrete përmirësuese në nivelin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Gjatë periudhës së pandemisë Covid 19 UNIKO ka aplikuar sistemin Microsoft Teams dhe ka asistuar personelin të krijojë metoda më novatore dhe të standartizuara të mësimdhënies.



Monitorimi dhe vlerësimi i aftësive mësimdhënëse të personelit akademik realizohet në mënyrë periodike nga NJSBC në bashkëpunim me njësinë përgjegjëse. Procesi realizohet duke përdorur disa procedura dhe instrumenta si:

- Monitorimi i provimeve në sezonin e provimeve përfundimtare, ku kontrollohet mënyra e vlerësimit dhe procedura e rivlerësimit të studentëve. Rezultatet pasqyrohen në raportet përkatëse;
- Vlerësimi i mësimdhënies nga studentët përmes anketimit semestral të tyre. Pas zbardhjes së tyre hartohet raporti i cili u vendoset në dispozicion departamentit dhe pedagogëve përkatës;
- Dokumentim i performances akademike nga stafi akademik, i cili në mënyrë periodike pasqyron ngarkesën mësimore, veprimtarinë akademike, performancën në kërkim shkencor dhe shërbimet ndaj të tretëve;

UNIKO bën vlerësime periodike të mësimdhënies nga studentët përmes anketimeve. Anketimi hartohet nga NJSBC dhe synon mbledhjen e opinionit të studentëve lidhur me procesin e mësimdhënies dhe çdo dukuri tjetër të lidhur me të. Ky proces ndodh dy here në vit, në përfundim të semestrit dhe përpara sezonit të provimeve për të evituar ndikimin në vlerësim. Rezultatet e anketimit janë pjesë e analizës vjetore të njësisë.

Sa më sipër GVJ konstaton se janë përcaktuar në statutin e UNIKO dhe në rregulloren e brendshme të FE, format e mësimdhënies dhe mësimnxënies, si dhe mënyrat e kontrollit të

	<p>dijeve.</p> <p><i>Evidenca I.01 - Statuti i UNIKO</i></p> <p><i>Evidenca I.02 - Rregullore e Organizimit dhe Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore të UNIKO</i></p> <p><i>Evidenca I.32 - Rregullore e brendshme FE</i></p> <p><i>Evidenca I.05 - Rregullore e NJSBC</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p>	<p>Në funksion të procesit mësimor-kërkimor, UNIKO ka organizuar stuktura të posaçme që promovojnë përmirësimin e cilësisë.</p> <p>Njësia ndihmëse në funksion të procesit mësimor- kërkimor, Njësia e Standardeve dhe Cilësisë, kujdeset për hartimin, përditësimin dhe rishikimin e kuadrit rregullator të institucionit dhe procedurave, në përputhje me legjislacionin në fuqi, standardet e cilësisë dhe praktikat e mira kombëtare dhe ndërkombëtare, si edhe monitoron zbatueshmërinë e tyre nga strukturat dhe personeli i institucionit;</p> <p>Veprimtaria e NJSBC përfshin monitorimin e vazhdueshëm të institucionit në;</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ndjekjen e vazhdueshme të programeve të lëndëve, zbatimit, rishikimit, përditësimit të tyre, nëpërmjet krijimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të performances; • Ndjekjen e vazhdueshme të nivelit të cilësisë së stafit akademik dhe ndihmës, si edhe kualifikimit të tij; • Monitorimi i vazhdueshëm i procesit të mësimdhënies dhe i vlerësimit të studentëve dhe ruajtja e cilësisë së tij; • Ndjekja e vazhdueshme e ecurisë së kërkimit shkencor në institucion. <p>Kjo njësi ndjek me përgjegjshmëri problemet që lidhen me mësimdhënien, vlerësimin institucional dhe zhvillimet mësimore në rritjen e cilësisë së formimit të studentëve. Veprimtaria e saj miratohet dhe rregullohet nga Senati i Universitetit.</p> <p>Në programin Bachelor Administrim Biznesi në Marketing format kryesore të mësimdhënies janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Leksione • Seminare • Projekte/Detyra, (pjesë e vlerësimit të lëndës) • Praktikë profesionale <p>Pedagogët janë angazhuar për një përfshirje aktive të studentëve gjatë orës së mësim, në diskutimin e rasteve studimore dhe detyrave në grup e individuale. Kjo e fundit u pohua dhe gjatë</p>

	<p>takimit që GVJ zhvilloi me studentët, të cilët vlerësonin interaktivitetin në klasë, diskutimet gjatë orës së mësimit të rasteve praktike dhe marrëdhënien e gatishmërinë e pedagogëve për tu përgjigjur çdo pyetje e paqartësie të studentit.</p> <p><i>Evidenca III.01 - Model pyetësori studentor</i> <i>Evidenca I.01 - Statuti i UNIKO</i> <i>Evidenca I.02 - Rregullore e Organizimit dhe Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore të UNIKO</i> <i>Evidenca I.32 - Regullore e brendshme FE</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Studentët marrin pjesë aktive në vlerësimin e metodave të mësimdhënies sipas procedurës të paraqitur në Regulloren e brendshme FE. Ky proces zhvillohet dy here në vit, në përfundim të semestrit dhe rezultatet janë pjesë e analizës vjetore të njësisë kryesore së bashku me formularin e performancës së stafit.</p> <p>Përveç anketimit të NJSBC, Departamenti Marketing Turizëm ka hartuar një pyetësor të strukturuar me qëllim monitorimin e aktiviteteve të mësimdhënies, të cilët shpërndahen tek studentët në klasë, ose nëpërmjet formave online.</p> <p><i>Evidenca III.01 - Model pyetësori studentor</i> <i>Evidenca I.32 - Regullore e brendshme FE</i></p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Monitorimi dhe vlerësimi i aftësive mësimdhënëse të personelit akademik realizohet në mënyrë periodike nga NJSBC në bashkëpunim me njësinë përgjegjëse.</p> <p>GVJ u njoh me procedurën dhe përmbajtjen e pyetësorit gjatë vizitës në institucion, ku veç të tjerash u njohëm nga NJSBC dhe Përgjegjësja e Departamentit se mekanizëm monitorimi shërben dhe dokumentimperiodik i performancës akademike të pedagogëve, i cili pasqyron ngarkesën mësimore, veprimtarinë akademike, performancën në kërkim shkencor dhe shërbimet ndaj të tretëve. Kjo e fundit raportohet në raportin vjetor të Departamentit të Marketing Turizëm.</p> <p><i>Evidenca I.01 - Statuti i UNIKO</i> <i>Evidenca I.32 - Regullore e brendshme FE</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) u vë në dispozicion vlerësimet drejtuesve të institucionit dhe drejtuesve të njësisë. Nga takimet e zhvilluar me NJSBC dhe përgjegjësen e departamentit u pohua se rezultatet e gjeneruara nga vlerësimet bëhen publike në mbledhjet e departamentit dhe promovohen shembujt e praktikave më të mira, ndërsa merren masa për përmirësimin e mëtejshëm. Institucioni është angazhuar në rritjen e angazhimit kërkimor të stafit, përmes rimbursimit të</p>

Ben Ahmeti

[Signature]

	<p>pjesëmarrjes në konferenca dhe publikimeve në revista shkencore; si dhe rritjen e cilësisë së mësimdhënies përmes ofrimit të mundësive të mobilitetit për mësimdhënie përmes programeve Erasmus + në Universitete partnere.</p> <p><i>Evidenca III.02 - Raportet vjetore të DMT</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi III.2	
Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Format kryesore të mësimdhënies janë leksionet, seminarët, detyrat dhe projektet e kursit, rastet e studimit, testimet e programuara, praktika profesionale dhe në fund finalizohen me punimin e diplomës, siç dokumentohen në programet lëndore: 2019-2020; 2020-2021; 2021-2022.</p> <p>Përmirësimi i metodave të mësimdhënies përbën prioritet për njësinë (departamentin marketing turizëm), dhe është reflektuar jo vetëm në dokumentat zyrtarë si <i>Plani Strategjik i Programit të Studimit 2021-2026</i>, por dhe në takimet e GVJ me përgjegjësen e departamentit dhe stafin akademik të programit të studimit. GVJ konstatoi një përpjekje serioze nga ana e stafit në dobi të rritjes së nivelit të mësimdhënies dhe për një përfshirje aktive të studentëve gjatë orës së mësimi, në diskutimin e rasteve studimore dhe detyrave në grup e individuale. Kjo e fundit u pohua dhe gjatë takimit që GVJ zhvilloi me studentët, të cilët vlerësonin interaktivitetin në klasë, diskutimet gjatë orës së mësimi të rasteve praktike dhe marrëdhënien e gadishmërinë e pedagogëve. Mjedisi dhe pajisjet audio-vizuale të UNIKO janë në avantazh të mësimdhënies bashkëkohore.</p> <p><i>Evidenca I.30 - Programet lëndore: 2021-2022; 2020-2021; 2019-2020</i></p> <p><i>Evidenca I.02 - Rregullore e Organizimit dhe Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore të UNIKO</i></p> <p><i>Evidenca III.02 - Raportet vjetore të DMT</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative</p>	<p>Në përputhje me rregulloren mësimore, format e mësimdhënies dhe mësimnxënies dhe kontrollit të dijeve parashikohen në planet mësimore, programet dhe syllabuset e lëndëve</p> <p>Programi Bachelor Administrim Biznesi në Marketing përfshin</p>

<p>të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.</p>	<p>format e mësimi teorik e praktik si leksionet, seminarët, ushtrimet, detyrat e kursit. Mënyra kryesore e vlerësimit të dijeve është provimi final i modulit, ndërsa të tjera përfshijnë aktivizimin gjatë orëve mësimore, provimet ndërmjetëse, mbrojtja e detyrave dhe projekteve të kursit, dhe provimi i formimit.</p> <p>Nga takimi që GVJ zhvilloi me studentë të programit u theksua se puna në grupe, krijimi i skenarëve të diskutimit nxisin të menduarit kritik. Për shkak të karakterit praktik të moduleve, përdorimi i rasteve reale të bizneseve për studim e bën më tërheqëse dhe aplikativ programin për studentët. Siç u pohua prej tyre, pedagogët janë të gatshëm të përgjigjen dhe asistojnë studentët për çdo paqartësi.</p> <p><i>Evidenca I.26 - Regullore e programit të Studimit</i> <i>Evidenca I.30 - Programet lëndore: 2021-2022; 2020-2021; 2019-2020</i> <i>Evidenca II.01 - Planet mësimore: 2021-2024; 2020-2023; 2019-2020</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>Në kuadër të respektimit dhe vlerësimit të lirisë akademike, stafi motivohet të sjellë risi në mësimdhënie me module interaktive dhe forma që nxisin debatin dhe zhvillojnë aftësitë praktike të studentëve. Përkatësisht nga takimi me studentët u pohua se studentët kanë patur mundësinë të diskutonin me menaxherë të bizneseve të ftuar si metodë e re pedagogjike, në përputhje me objektivat formuese të lëndëve dhe rritjen e kopetencave sipas kërkesave të punëdhënësve.</p> <p>Nga vizita në institucion GVJ konstatoi se në funksion të moduleve aplikative, UNIKO ka në dispozicion infrastrukturën dhe laboratorët kompjuterike ku studentët mund të mësojnë duke zgjidhur vetë raste e detyra praktike.</p> <p><i>Evidenca Vizita ne Institucion: Minutat, Bsc Administrim Biznesi ne Marketing.</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Personeli akademik i përfshirë në programin Bachelor Administrim Biznesi në Marketing përmbush kërkesat ligjore në fuqi. Stafi akademik në tërësi mban gradën profesor dhe doktor në përputhje me ciklin e studimit ku japin mësim. Fusha kërkimore shkencore e personelit akademik është në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikat e moduleve të tyre të mësimdhënies.</p> <p>Nga shqyrtimi i CV-ve dhe dokumentacionit të personelit akademik, u vu re se në tërësi fusha e ekspertizës së pedagogut përputhet me syllabusin e lëndës në të cilën është titullar. Stafi akademik është i angazhuar në këshillim për studentët dhe</p>

Van Alimata

[Signature]

	<p>ndihmon e asiston ne detyra administrative.</p> <p><i>Evidenca II.10.1 - CV e stafit akademik</i></p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Nga vizita në institucion, GVJ konstatoi se departamenti i jep rëndësi zhvillimit me korrektësi të procesit mësimor nga ana e pedagogëve. Departamenti mblidhet periodikisht për të evidentuar arritjet dhe problematika që duhen përmirësuar. Në funksion të përmirësimit të metodave të mësimdhënies përdoren dhe anketimet nga NJSBC dhe vetë Departamenti.</p> <p>Institucioni ka realizuar zhvillimin e aktiviteteve me natyrë shkencore të tilla si konferenca, seminare, leksione te hapura, ku është nxitur pjesëmarrja e personelit akademik. Metodrat e reja janë diskutuar nga stafi akademik dhe Përgjegjësi i Departamentit, i cili rishikon metodat e mësimdhënies me stafin. Gjithashtu bashkëpunimet me universitetet partnere ndihmojnë në trainimin e shkëmbinim e stafit për mësimdhënie.</p> <p><i>GVJ inkurajon më tepër mbëshjetje me veprimtari praktike të procesit mësimor të programit me qëllim forcimin e mjeshtërive teknike e aplikative në përafrim të kërkesave të tregut të punës.</i></p> <p><i>Evidenca I.41- Aktivitete DMT</i></p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.</p>	<p>GVJ realizoi takim me stafin akademik dhe studentët dhe evidentoi se mësimdhënia është interaktive duke inkurajuar pjesëmarrjen e të gjithë studentëve në diskutim. Përdorimi i rasteve të studimit me tematika aktuale dhe integrimi i literaturës ndërkombëtare krijon interes dhe përfshirje të studentëve në zgjidhje analitike të rasteve të huaja dhe vendase. Materialet didaktike të përdorura përbëhen dhe nga materiale audivizuale të cilat krijojnë situata diskutimesh interaktive dhe nxisin punën në grupe të studentëve.</p> <p><i>Evidenca Vizita ne Institucion: Minutat, Bsc Administrim Biznesi ne Marketing.</i></p>
<p>Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbëshjetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënies të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Personeli akademik i programit të studimit nxit studentët të ndërmarrin iniciativa të lira dhe të pavarura në ngritjen e grupeve të punës, zgjedhjen e temave, përgatitjen e detyrave të kursit në të cilat vlerësohen dhe mbi bazën e iniciativës dhe krijimtarisë së tyre, bashkëpunim në zgjidhjen e problemave në seminare. Gjithashtu, në RVB deklarohet se për shkak të kushteve të pazakonta të Pandemisë Covid-19 u mundësua mësimi online përmes platformave Moodle, eduMEET, Google Meet, Google Classroom dhe Microsoft Office 365 Teams dhe është bërë</p>

Van Alimata

[Signature]



	<p>trajnimi për stafin dhe për studentët. Platforma ka dhënë mundësinë e komunikimit të përbashkët mes pedagogëve dhe studentëve për materiale, të dhëna, teste, etj. Bashkëpunimi i ndësjellë pedagog-studentë vihet re në auditor, në detyrat e ndryshme të kursit, në projekte e hartimin e diplomës dhe lehtësohet përmes sistemit të komunikimit me studentët. Kjo evidentohet nga takimi me studentët i kryer gjatë vizitës në institucion. Këto janë forma dhe metoda të mësimdhënies që inkurajojnë sensin e autonomisë së studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p> <p><i>Evidenca III.02 - Raportet vjetore të DMT</i> <i>Evidenca IV.15 Trajnimi i Stafit per Microsoft Teams</i> <i>Evidenca Vizita ne Institucion: Minutat, Bsc Administrim Biznesi ne Marketing.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Plotësisht përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3	
Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	<p>Procesi mësimor realizohet në godinën e FE. Gjatë vizitës së GVJ godina e FE ishte në rikontruksion të plotë me qëllim përmirësimin e standardeve në kushte më bashkëkohore. Kjo godinë është e pajisur me salla leksionesh, seminaresh dhe laboratorë (Laboratori i turizmit dhe informatikës) me hapësira totale në dispozicion të procesit mësimor prej 2541 m2. GVJ vlerësoi hapësirat e tjera të Universitetit dhe kapacitetet e bollshme me zyra, mjedise shërbimi, hapësira recreative dhe mjedise për aktivitete të ndryshme.</p> <p><i>Evidenca III.04 - Të dhëna infrastruktura</i></p>
Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.	<p>Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e programit të studimit. Nga vizita e realizuar në ambientet e Fakultetit të Ekonomisë, konstatuam se mjediset ku zhvillohet mësimi plotësojnë kriteret e nevojshme për zhvillim e mësimdhënies cilësore. Në këto mjedise vëzhguam salla leksione e seminare, laboratorë, salla mbledhjesh, zyra e studio të përshtatshme për zhvillimin e këtij programi studimi. Ambientet</p>



Ben Ahmet

AZ

	<p>ku zhvillohet mësimi plotësojnë kriteret teknike dhe normativën e sipërfaqes së shfrytëzueshme sipas VKM nr 418, date 10.05.2017, është 2.5 m² për student. Laboratorët mësimorë janë të pajisur me mjetet didaktike të nevojshme për zhvillimin e praktikës mësimore. Staf i IT-së ishte i angazhuar për mirëmbajtjen e laboratorëve dhe pajisjeve ndihmëse në auditore, në dispozicion të studentëve dhe pedagogëve përgjatë gjithë kohëzgjatjes së zhvillimit të mësimi.</p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.</p>	<p>UNIKO ka vendosur në dispozicion të studentëve laboratorë të pajisur me kompjutera ku janë instaluar programet (software) për realizimin e punës së pavarur nga studenti. Gjatë vizitës GVJ u njoh me infrastrukturën dhe sistemet informatike në funksion të procesit mësimor. UNIKO ka nënshkruar marrëveshjen me Rrjetin Akademik Shqiptar (RASH) për aplikimin dhe mirëmbajtjen e sistemit.</p> <p>Gjithashtu studentët, stafi akademik dhe ndihmës akademik mbështeten tek Sistemi ESSE3, bazuar në Manuali i Sistemit Elektronik ESSE3. Në përbërëse të këtij sistemi janë të integruara edhe disa platforma të cilat shërbejnë për përmirësimin e cilësisë së mësimnxënies dhe sigurimin e komunikimit midis personelit akademik, ndihmësakademik dhe studentëve.</p> <p>Gjatë periudhës së pandemisë Covid 19 Sistemi Microsoft Teams u përdor me sukses nga pedadogët dhe studentët për zhvillimin e mësimi online, testimeve dhe provimeve.</p> <p><i>Gjatë vizitës në institucion GVJ konstatoi se marrëveshja me RASH, Sistemi ESSE3 dhe faqja web e UNIKO ishin jashtë shërbimi për shkak të kushteve të kontratës, rinovimit e mirëmbajtjes së tyre. Nga përgjegjësit e institucionit u garantua se do të rivendosen në funksionim shumë shpejt.</i></p> <p><i>Evidenca III.05 - Marrëveshja UNIKO-RASH</i> <i>Evidenca I.06 - Manuali i sistemit elektronik ESSE3</i></p>
<p>Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Literatura bazë në modulet e këtij program studimi ofrohet në gjuhën shqipe. Baza mësimore që u ofrohet studentëve përfshin tekste mësimore, cikle leksione, leksione në ppt, materiale plotësuese.</p> <p>Nga shqyrtimit i Syllabuseve të lëndëve të programit Bachelor Administrim Biznesi në Marketing rezultoi se si literaturë bazë studentëve u ofrohen tekste të përkthyer nga titullarët e lëndëve në trajtën e cikleve të leksioneve.</p> <p>Nga vizita në bibliotekë rezultoi se një pjesë e titujve dhe teksteve mësimore nuk gjendeshin fizikisht, ndërsa titujt kryesorë në</p>

	<p>bibliotekë ishin të mbi 10 viteve të shkuara.</p> <p><i>GVJ konstatoi se kishte mangësi në titujt bashkëkohor të literaturës të huaj e vendase. GVJ vë re se mungon literatura bashkëkohore në gjuhën shqipe për programin dhe sugjeron të pasurohet fondi i bibliotekës me titujt e përfshirë në kurrikulat mësimore të lëndëve. Të përzgjidhet me kujdes literatura bashkëkohore dhe të bëhet një përkthim profesional i titujve kryesorë në gjuhën shqipe.</i></p>
<p>Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Gjatë vizitës së GVJ në institucion, Biblioteka e Fakultetit të Ekonomisë ishte mbyllur për shkak të rikonstruksionit të godinës. Sipas raportit të GVB , Biblioteka e FE ka kapacitet prej 43 vende, frekuentim ditor 130 studentë dhe 620 studentë dhe 40 pedagogë të regjistruar.</p> <p><i>Fondi i bibliotekës në gjuhën shqipe dhe të huaj për modulet e programit Bachelor Administrim Biznesi në Marketing është i vogël dhe një pjesë e teksteve mësimore të paraqitura në syllabuse nuk gjenden fizikisht në bibliotekë. Institucioni ende nuk ka kryer dixhitalizimin e bibliotekës, çka vështirëson kërkimin e librave të programit të studimit.</i></p> <p><i>Evidenca III.06 - Biblioteka</i></p>
<p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë online në të cilat UNIKO është abonuar U-LIBRARY, e cila mundëson akses në EBSCO Publishing Databases, ku stafi akademik dhe studentët mund të regjistrohen (përmes një llogarie unike dhe fjalëkalimi), të përdorin dhe shkarkojnë revista/periodikë/libra/artikuj të dedikuar për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor.</p> <p>Gjithashtu, sipas GVB stafi akademik dhe studentët e FE mund të përdorimin e IoH e- library të Institute of Hospitality.</p>
<p>Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Bazuar në RVB dhe vizitën në institucion, UNIKO ka në dispozicion të studentëve 2 laboratorë mësimorë informatike të pajisur me programe profesionale në fushën e teknologjisë së informacionit.</p> <p>1.Laboratori i kompjuterizimit financiar është i pajisur me 30 kompjutera, dhe me disa programe profesionale, si: Excel për menaxherët, Kontabiliteti Alfa, SQL Server, Oracle, Visual Studio.</p> <p>2.Laboratori i Hoteleri-Turizmit i vjen në ndihmë programit të studimit, i krijuar si pjesë e projektit të përbashkët midis “La Fondation pour la formation hotelier” dhe UNIKO dhe shfrytëzohet nga studentet për zhvillimin e lëndëve si marketingu</p>



	<p>digjital. Ky laborator përmban 14 kompjutera, 12 tavolina, një smartboard. Krahas procesit mësimor, laboratorët ju shërbejnë studentëve edhe për përgatitjen e detyrave dhe projekteve të kursit, punimeve të mikrotezës apo studime të tjera gjatë pjesëmarrjes në koferenca shkencore.</p> <p><i>Evidenca III.04 - Të dhëna infrastruktura</i></p>
<p>Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>UNIKO ka në përdorim Sistemi ESSE3 (në kuadër të marrëveshjes me RASH, e cila ka skaduar dhe është në pritje të rinovimit), për administrim, dokumentim, ndjekje, raportim dhe shpërndarje të evidencave nga pedagogët, sekretaria mësimore për studentët. Në kushtet e pandemisë Covid 19 dhe zhvillimit të mësimdhënies online UNIKO adoptoi platformën Microsoft TEAMS të cilën nga takimet me stafin dhe studentët rezultoi se përdorej me lehtësi dhe garantonte menaxhimin e procesit mësimor, për shkëmbimin e njohurive dhe materialeve të nevojshme për programin e studimit.</p> <p>GVJ konstatoi se UNIKO ka një sistem informatik bashkëkohor në aspektin të zhvillimit të procesit mësimor.</p> <p><i>Evidenca I.06 - Manuali i sistemit elektronik ESSE3</i></p>
<p>Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.</p>	<p>Nga informacioni i paraqitur në RVB dhe konstatimet tona nga vizita në institucion, vlerësojmë se UNIKO ka infrastrukture të konsoliduar për realizimin e programit mësimor.</p> <p>Sistemi ESSE3 përdoret nga studentët, stafi akademik dhe ndihmëakademik duke u mbështetur tek Manuali i Sistemit Elektronik ESSE3. Në përbërëse të këtij sistemi është integruar edhe Sistemi i komunikimit të brendshëm Moodle është i aksesueshëm nga pedagogë dhe studentë dhe ka për qëllim të informojë dhe lehtësojë lidhjen mes tyre. Nëpërmjet tij ofrohen informacione, leksione, materiale mbështetëse etj. Çdo pedagog dhe student përdor kredencialet e programit dixhital ESSE3 për të patur akses në aplikacionin Moodle. Mirëpo siç është përmendur dhe më sipër në këtë raport, sistemi ESSE3, gjatë vizitës në institucion ishte jashtë shërbimit për shkak të përfundimit të marrëveshjes me RASH.</p> <p><i>Evidenca I.09 - Rregullore për mbrojtjen, ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave personale</i></p> <p><i>Evidenca I.06 - Manuali i sistemit elektronik ESSE3</i></p>
<p>Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët</p>	<p>Personeli akademik orienton studentët në zgjedhjen e temës sipas</p>

Osca Ahmeti



[Signature]

<p>në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.</p>	<p>fushave të kërkimit që mbulon programi i studimit, departamenti dhe pedagogu udhëheqës. Udhëheqësi i diplomës përgatit programin e punës së studentit duke vendosur afatet për konsultime dhe realizimin e tij. Udhëheqësi zhvillon seanca metodologjike me studentët që udhëheq, për të garantuar shkrimin e punimit në përputhje me standartet e punimit shkencor. Udhëheqësi rishikon dhe miraton punimin e paraqitur nga studentit përpara mbrojtjes.</p> <p>GVJ konstaton se procesi i realizimit të temave të diplomës paraqitet në Udhëzuesin e Diplomës.</p> <p><i>Evidenca II.04 - Udhëzues Diplome</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Niveli i përmbushjes</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

<p>Standardi III.4 Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Në funksion të procesit mësimor-kërkimor, UNIKO ka organizuar struktura të posaçme që promovojnë përmirësimin e cilësisë.</p> <p>Njësitë ndihmëse në funksion të procesit mësimor- kërkimor janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Zyra e Standardeve dhe Cilësisë, e cila kujdeset për hartimin, përditësimin dhe rishikimin e kuadrit rregullator të institucionit dhe procedurave, në përputhje me legjislacionin në fuqi, standartet e cilësisë dhe praktikat e mira kombëtare dhe ndërkombëtare, si edhe monitoron zbatueshmërinë e tyre nga strukturat dhe personeli i institucionit; • Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, nëpërmjet vlerësimit të efikasitetit të veprimtarive që ushtrohen në UNIKO, me synim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë; <p>Veprimtaria e NJSBC përfshin monitorimin e vazhdueshëm të institucionit në:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ndjekjen e vazhdueshme të programeve të lëndëve, zbatimit, rishikimit, përditësimit të tyre, nëpërmjet krijimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të performances; • Ndjekjen e vazhdueshme të nivelit të cilësisë së stafit akademik dhe ndihmës, si edhe kualifikimit të tij; • Monitorimi i vazhdueshëm i procesit të mësimdhënies dhe

	<p>i vlerësimit të studentëve dhe ruajtja e cilësisë së tij;</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ndjekja e vazhdueshme e ecurisë së kërkimit shkencor në institucion. <p>Këto njësi ndjekin me përgjegjshmëri problemet që lidhen me mësimdhënien, vlerësimin institucional dhe zhvillimet mësimore në rritjen e cilësisë së formimit të studentëve. Veprimtaria e tyre miratohet dhe rregullohet nga Senati i Universitetit.</p> <p><i>Evidenca I.05 - Rregullore e DKSCK</i> <i>Evidenca VI.02 - Raporti i vlerësimit të brendshëm</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>Cilësia e procesit të mësimdhënies është në fokus të Departamentit të Marketingut dhe Turizmit si dhe Fakultetit të Ekonomisë. Në kuadër të rritjes dhe përmirësimit të performancës akademike- mësimore, këto dy njësi bashkëpunojnë ngushtësisht me NJSBC-në për garantimin e cilësisë gjatë ushtrimit të veprimtarive akademike, kërkimore, të personelit akademik dhe të studentëve. Institucioni ofron mundësinë e trajnimeve dhe workshopeve të ndryshme të cilat orientojnë personelin akademik dhe personelin mësimor-shencor në përditësimin dhe kualifikimin e mëtjshëm profesional. Gjithashtu për zhvillimin e metodave të reja të mësimdhënies, ndiqen si praktikë leksionet e dhëna nga lektorë të ftuar vendas të cilët janë personalitete në fushën e tyre, por dhe të huaj, pjesë e të cilëve janë dhe nga programi ERASMUS+. Të gjitha këto shkëmbime i shërbejnë rritjes së vetëdijes të personelit akademik dhe studentëve për cilësinë e mësimdhënies dhe programit të studimit.</p> <p><i>Evidenca III.02- Raportet vjetore të DMT</i></p>
<p>Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>Pedagogët në programin e studimit Bachelor Administrim Biznesi në Marketing, inkurajohen të zhvillojnë leksione me debate, diskutime, punime individuale dhe në grupe. Personeli akademik bën të gjitha përpjekjet që studentët të kuptojnë konceptet dhe stimulon aplikimin e tyre në praktikë. Kjo e fundit u pohua dhe nga takimi që GVJ zhvilloi me studentët.</p> <p>Nga vizita në institucion GVJ konstatoi se infrastruktura ndihmon për integrimin e metodave inovative në mësimdhënie. Duke ju referuar platformave Moodle, eduMEET, Google Meet, Google Classroom, ESSE3, Office 365 for Education kanë ndihmuar rritjen e cilësisë të mësimdhënies, komunikim interaktiv dhe shkëmbim informacioni, ndërmjet personelit akademik dhe studentëve veçanërisht gjatë pandemisë.</p> <p><i>Evidenca III.08 - Mësimi online dhe format e vlerësimit</i></p>

<p>Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Në planin strategjik të UNIKO, prioritet është kërkimi shkencor. Kërkimi shihet si faktor kyç në promovimin e institucionit dhe programeve të studimit. UNIKO u ofron personelit akademik mundësinë e kualifikimeve të mëtejshme përmes pjesëmarrjes në konferencat shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, botimet në revistat shkencore, pjesëmarrjen në projekte të ndryshme, botimin e teksteve dhe dispencave sipas profileve të studimit, publikime në revistën e FE, “Studime ekonomike”.</p> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe dosjeve personale të pedagogëve vihet re se personeli i angazhuar në këtë program është aktiv në publikimin e artikujve dhe materialeve shkencore në fushat që përfshihen në programin e studimit. Veprimtaria kërkimore-shkencore e stafit analizohet në raportet vjetore të veprimtarisë së departamentit.</p> <p><i>Evidenca I.03 - Plani strategjik i zhvillimit të UNIKO</i> <i>Evidenca II.10.2 - CV e stafit akademik, programi i studimit ABM</i> <i>Evidenca III.02 - Raportet vjetore të DMT</i></p>
<p>Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>Departamenti Marketing-Turizëm realizon leksione me pjesëmarrje pedagogë dhe specialist të fushës së marketingut, me synim marrjen e përvojës metodologjike dhe pedagogjike nga personeli akademik. Në kuadër të rritjes së performancës mësimore dhe zhvillimit të metodave inovative kanë ndihmuar dhe shkëmbimet e trainimit Erasmus+.</p> <p><i>GVJ rekomandon se njësia bazë duhet të angazhohet në ofrim të qëndrueshëm të trainimeve dhe workshopeve për personelin akademik si mjet motivues për stafin akademik për zhvillimin e metodave e praktikave të reja të mësimdhënies, dixhitalizimin dhe përmirësimin e aftësive kërkimore.</i></p> <p>Gjithashtu, FE dhe DMT trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja, sic janë Microsoft Teams, ESSE3, Trajnimi online EBSKO etj. Leksionet e hapura kanë shërbyer për të shkëmbyer eksperiencën mes stafit me përvojë dhe atij të ri akademik.</p> <p><i>Evidenca I.33 - Leksione te Hapura</i> <i>Evidenca III.02 - Raportet vjetore të DMT</i> <i>Evidenca IV.15 Trajnimi i Stafit per Microsoft Teams</i></p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion u konstatua se Përgjegjësi i Departamentit në bashkëpunim me Sekretarinë Mësimore monitorojnë zhvillimin e procesit mësimor. Nga biseda me</p>

Ben Ahmet

[Signature]

<p>studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>pedagogët, u evidentua se personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p> <p><i>Evidenca 1.2 Rregullorja e UK.</i> <i>Evidenca Vizita ne Institucion: Minutat, Bsc Administrim Biznesi ne Marketing.</i></p>		
<p>Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>GVJ në takimet me drejtuesin e Departamentit, stafin akademik, NJSBC, u njoh me faktin që konceptimi i procesit mësimor është bërë duke synuar vënien e studentit në qender. Kjo ka sjelle ndryshim nga metoda tradicionale, duke i dhënë më shumë mundësi pjesëmarrjes në diskutime dhe pyetje studentit. Zhvillimi i orëve interaktive, duke u përqendruar në bashkëveprime të vazhdueshme midis profesorit dhe studentit, nxitja e debateve, mendimit kritik, rastet studimore, puna në grupe dhe prezantimet e punimeve janë disa prej mjeteve kryesore që garantojnë ndërveprimin dhe pjesëmarrjen e studentëve në mënyrë aktive në procesin mësimor.</p> <p>Metodat e reja të mësimdhënies, nëpërmjet seminareve të dedikuara, leksioneve të hapura workshope etj, me qëllim përmirësimin e këtij procesi në vijimësi.</p> <p>Përfshirja e studenteve dhe vjelja e mendimit të tyre në kuadër të përmirësimit të cilësisë së personelit akademik dhe metodave të mësimdhënies është periodike për të gjitha aspektet akademike dhe administrative të UNIKO.</p> <p><i>Evidenca III.02- Raportet vjetore të DMT</i> <i>Evidenca Vizita ne Institucion: Minutat, Bsc Administrim Biznesi ne Marketing.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi III.5 Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Bazuar në rregulloren e FE, rregulloren e programit Bachelor në Administrim Biznesi në Marketing kontrolli i dijeve realizohet nëpërmjet dy rubrikave: vlerësimi i vazhduar (përfshin aktivizimin në seminare, testimin e ndërmjetëm, detyrat e projektet e kursit) dhe vlerësimi në provim përfundimtar. Raporti</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423


E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

46



	<p>i vlerësimit të vazhduar gjatë vitit me raportin përfundimtar përcaktohet nga pedagogu i lëndës dhe miratohet nga Përgjegjësi i Departamentit në fillim të çdo semestri.</p> <p>Në syllabusin e secilës lëndë të këtij programi studimi përshkruhet një seksion i veçantë lidhur me formën e kontrollit dhe vlerësimit të njohurive. Syllabusi ngarkohet në sistemin Moodle dhe Microsoft Teams nga ku mund të aksesohet lehtësisht nga studentët. Gjithashtu, në webfaqen e UNIKO-së gjenden të publikuara rregulloret e institucionit dhe programit të studimit.</p> <p><i>Evidenca I.26 - Rregullore e programit të studimit ABM</i> <i>Evidenca I.30 - Programet lëndore: 2019-2020; 2020-2021; 2021-2022</i></p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Syllabuset e çdo lëndë përmbajnë kontrollet që do të kryhen gjatë zhvillimit të saj. Vlerësimi i kontrolleve bëhet me pikë që i bashkohen vlerësimit përfundimtar. Në vlerësimin përfundimtar kontribuojnë edhe frekuentimi, detyrat e kursit, aktivizimi gjatë zhvillimit të ushtrimeve dhe mësimëve praktike. Pedagogu informon studentet për rezultatet e çdo kontrolli. Studentët njihen me kriteret dhe mënyrat e vlerësimit që në fillim të procesit mësimor nëpërmjet sqarimit nga ana e pedagogut të lëndës të syllabusit përkatës, i cili përmban të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe metodologjinë e testimit dhe vlerësimit të njohurive dhe aftësive.</p> <p>Studentët e programit të studimit mund të informohen edhe në distance përmes sistemit ESSE 3 në lidhje me lëndët, përmbajtjen e tyre dhe metodologjinë e vlerësimit të njohurive.</p> <p><i>Evidenca I.30 - Programet lëndore: 2019-2020; 2020-2021; 2021-2022</i> <i>Evidenca I.26 - Rregullore e programit të studimit ABM</i> <i>Evidenca Vizita ne Institucion: Minutat, Bsc Administrim Biznesi ne Marketing.</i> <i>Evidenca III.08 - Mësimi online dhe format e vlerësimit</i> <i>Evidenca I.06 - Manuali i sistemit elektronik ESSE3</i></p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>UNIKO i kushton shumë rëndësi transparencës së vlerësimit. Vendosja e rezultateve në sistemin elektronik ESSE 3 lejon secilin student të shikojë vetëm vlerësimin e tij dhe askush tjetër nuk ka akses për të parë vlerësimet e tjetrit.</p> <p>Në kushtet e pandemisë Covid 19, studentët kanë përdorur sistemin elektronik për testimin e njohurive Microsoft TEAMS, i cili garanton anonimat në përputhje me rregulloren në fuqi.</p> <p>Testimi e vlerësimi i njohurive dhe aftësive profesionale</p>





	realizohet në forma të ndryshme si: pjesmarrja aktive; plotësimi i detyrimeve (detyrave të kursit); testimet gjatë vitit; provimi përfundimtar.			
	<i>Evidenca I.26 - Rregullore e programit të studimit ABM</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Në përmbushje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6	
Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.	<p>Vlerësimi gjatë vitit inkurajon angazhim dhe ndërveprim të studentit dhe e përgatit atë për sezonin e provimeve. Siç u përmend dhe në standartin III.5 raporti i vlerësimit të vazhduar gjatë vitit me raportin përfundimtar përcaktohet nga pedagogu i lëndës dhe miratohet nga Përgjegjësi i Departamentit në fillim të çdo semestri.</p> <p>Duke shqyrtuar programet e lëndëve rezultoi se raporti është në masën 70% (provimi përfundimtar) dhe 30% vlerësimi i vazhduar gjatë vitit (aktivizimi, detyra kursi, testime). Kjo formë inkurajon angazhimin e studentëve gjatë kursit.</p> <p>Vlerësimi gjatë vitit dhe vlerësimi përfundimtar gjenden në formë elektronike. Gjithashtu rezultatet e studentit dokumentohen në dokumenta si regjistri dhe pasqyra e vlerësimit dhe depozitohen në Sekretarinë Mësimore.</p> <p><i>Evidenca I.26 - Rregullore e programit të studimit ABM</i> <i>Evidenca I.30 - Programet lëndore: 2019-2020; 2020-2021; 2021-2022</i></p>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	<p>UNIKO i kushton rëndësi transparencës dhe privatësisë së vlerësimit. Vendosja e rezultateve në sistemin elektronik ESSE 3, lejon secilin student të shikojë vetëm vlerësimin e tij dhe askush tjetër nuk ka akses për të parë vlerësimet e tjetrit. Gjithashtu vlerësimi bëhet në kohë.</p> <p>Nga vizita në institucion GVJ konstatoi se UNIKO nuk përdor format e vlerësimit në mënyrë elektronike (si p.sh nëpërmjet Clean Score, një nga format bashkëkohore të kontrollit të njohurive dhe vlerësimi i studentëve). Kjo do të reduktonte abuzimin dhe subjektivitetin e vlerësimit të studentëve.</p>
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe	Referuar rregullores së ciklit të parë të studimit Bachelor në

Van Alimata

Dr

<p>aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Administrim Biznesi Marketing dhe RVB, komisioni i provimit përcaktohet nga Përgjegjësi i Departamentit dhe përbëhet nga jo më pak se dy anëtarë, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës. Në rastin e mbrojtjes së praktikës dhe diplomës realizohet me komision me jo më pak se tre anëtarë. Anëtarët e komisionit propozohen nga departamenti dhe miratohen nga Dekani.</p> <p>Vlerësimi i diplomës është kusht për përmbushjen e detyrimeve lidhur me kreditet e programit dhe me diplomimin.</p> <p>Komisionet përcaktohen nga Përgjegjësi i Departamenti në përputhje me Rregulloren në fuqi.</p> <p><i>Evidenca I.32 - Rregullore e Brendshme FE</i> <i>Evidenca I.26 - Rregullore e programit të studimit ABM</i></p>
<p>Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.</p>	<p>Nga shqyrtimi i rregullores së programit të studimit dhe vizita në institucion u vu re se format e testimit me shkrim si të vazhduar ashtu dhe përfundimtare zhvillohen duke mbajtur anonim emrin e studentit, nëpërmjet procesit të sekretimit. Rregullat e zhvillimit të provimeve dhe vlerësimi, kontrolli i dijes përcaktohet nga titullari i lëndës, i cili është përgjegjës për hartimin e tezës së provimit dhe është plotësisht përgjegjës për ruajtjen e sigurisë së vlerësimit.</p> <p>GVJ gjatë vizitës në sekretarinë mësimore të UNIKO-së, u njoh me dokumentacionin dhe procedurën e vlerësimit të dijeve. Në fund të çdo provimi, fletoren me logon e UNIKO dorëzohen në sekretari të mbyllura në zarf e të firmosura nga lektori dhe ruhen deri në fund të semestrit pasardhës.</p> <p><i>Evidenca I.32 - Rregullore e Brendshme FE</i> <i>Evidenca I.26 - Rregullore e programit të studimit</i></p>
<p>Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënimit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Studentët e programit Bachelor Administrim Biznesi në Marketing zhvillojnë projekte, detyra kursi dhe raste studimore në çdo lëndë. Nga takimi me studentët, GVJ u informua se pedagogu i lëndës i orienton studentët mbi të gjithë elementët e vlerësimit të dijeve. Në vazhdimësi ata udhëzohen mbi zhvillimin e detyrave të kursit dhe rasteve studimore. Gjatë zhvillimit të tyre dhe në mbrojtjen e tyre studentët marrin këshilla dhe vlerësim nga pedagogu lidhur me aspektet pozitive dhe negative dhe çfarë duhet të përmirësojnë. Numri i vogël i studentëve në këtë program studimi lehtëson ndjekjen individuale të tyre dhe ndihmon studentët të përmirësohen në aspekte të mësimnxënies.</p> <p>Gjithashtu, vlerësimi i dijeve në provim shoqërohet me komente sa herë pedagogu e gjykon të nevojshme. Pas provimit, pedagogët zhvillojnë seanca sqaruese me studentët, për të sqaruar çdo paqartësi të mundshme në lidhje me vlerësimin e kryer. Rezultatet</p>




	<p>e provimit, përpilohen në sistemin ESSE dhe studentëve ju lihet 48 orë në dispozicion për të paraqitur ankesat e tyre. Pedagogu dorëzon procesverbalin me rezultatet e studentëve në sekretarinë mësimore siç udhëzon rregullorja e FE-së.</p> <p><i>Evidenca I.32 - Rregullore e Brendshme FE</i> <i>Evidenca I.26 - Rregullore e programit të studimit</i></p>
<p>Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.</p>	<p>Rregullat e zhvillimit të kontrolleve të dijes përcaktohen në rregulloren e FE-së dhe Kodin e Etikës ku janë të specifikuar qartë dhe penalitetet për rastet e konstatimit të kopjimit ose plagjiaturës.</p> <p>Gjatë zhvillimit të provimit ndalohet hyrja e personave të jashtëm me përjashtim të pedagogëve të autorizuar për mbikqyrje. Studenti lejohet të paraqitet në provim vetëm pasi ka një mjet identifikimi si karta e studentit ose kartë identiteti. Gjatë provimit ndalohet celulari dhe personi që përdor mjete të tilla të palejueshme përjashtohet nga provimi.</p> <p><i>Lidhur me plagjiaturën në detyra kursi, apo tema diplome, ajo nuk mund të evidentohet pasi në institucion mungon një program specifik për këtë qëllim.</i></p> <p><i>Evidenca I.32 - Rregullore e Brendshme FE</i> <i>Evidenca I.26 - Rregullore e programit të studimit</i></p>
<p>Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Bazuar në rregulloren e programit, vlerësimi i kontrollit të dijeve bëhet me pikë, të cilat më pas konvetohen në notë. Për të vlerësuar njohuritë e studentit përdoret sistemi shqiptar i vlerësimit me nota nga 1-10, ku 10 është vlerësimi maksimal ndërsa nota kaluese është 5. Bazuar në rregulloren e FE-së tezat e korigjuara dorëzohen brenda një jave nga data e zhvillimit të provimit, ndërsa seancat sqaruese dhe rishikuese bëhen brenda 2 javëve nga data e zhvillimit të provimit. Stafu akademik dorëzon rezultatet e vlerësimit të seminareve dhe detyrave të kursit, gjatë javës së 14-të të semestrit, duke ju përmbajtur afatit përkatës. Studentët njihen me rezultatet e akumuluar përpas datës së zhvillimit të provimit përfundimtar. Përmes sistemit online ESSE 3, studenti informohet brenda afateve të përcaktuara nga neni 82 i rregullores së FE-së për rezultatet e provimit. Studentët njihen me notën përfundimtare pas zhvillimit të provimit sipas rregullores së institucionit dhe programit të studimit.</p> <p><i>Evidenca I.32 - Rregullore e Brendshme FE</i> <i>Evidenca I.26 - Rregullore e programit të studimit</i></p>
<p>Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e</p>	<p>GVJ konstatoi se institucioni ka dokumentacion të plotë që</p>

<p>studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>siguron garantimin e të drejtave të studentëve për tu njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloren dhe procedurat e vlerësimit.</p>			
<p>Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Studenti ka të drejtë të ankimojë për pikët që ka marrë në një nga komponentët e vlerësimit (provim i ndërmjetëm, detyrë kursi, provim përfundimtar), pasi ka konsumuar procedurën e sqarimit me pedagogun e lëndës. Ai mund t'i drejtojë një kërkesë me shkrim përgjegjësit të Departamentit dhe Dekanit ku të parashtrijë arsyet mbi të cilat ai bazon ankesën. Me marrjen e ankesës, Dekanati në bashkëpunim me Përgjegjësin e Departamentit ngre një komision me 3 anëtarë, i cili bën shqyrtimin e kërkesës dhe merr vendim me shumicë të thjeshtë. Vlerësimi i komisionit është përfundimtar dhe mund të jetë i njëjtë, më i lartë ose më i ulët se vlerësimi i kontestuar. Procedura e ndjekur për zgjidhjen e ankesës si dhe vendimi i marrë dokumentohet dhe arkivohet. Vlerësimi përfundimtar pasqyrohet në një procesverbal të ri të firmosur nga komisioni i cili i bashkëlidhet atij të mëparshmit si dhe pasqyrohet në sistemin elektronik ESSE 3.</p> <p><i>Evidenca I.32 - Rregullore e Brendshme FE</i> <i>Evidenca I.26 - Rregullore e programit të studimit</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Në përmbushje</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi III.7 Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese të studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor “Administrim Biznesi në Marketing”, synon:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përgatitjen e studentëve në formimin e tyre si specialistë në fushën e marketingut. • Dhënien e njohurive në formimin e përgjithshëm teorik në fushën e ekonomisë, manaxhimit dhe marketingut me objektiv kryesor formimin e specialisteve të aftë për të punuar në marketing dhe realizimin e studimeve të avancuara në këtë fushë. • Përdorimin e teknologjive të informacionit në funksion të marketingut
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	

Van Alim

[Signature]

- Stimulimin e punës në grup dhe komunikimin verbal dhe joverbal
- Komunikimin ndërpersonal, marketingun online, menaxhimin e operacioneve dhe shitjet.

Në planin mësimor të programit të studimit është respektuar ndarja e lëndëve sipas veprimtarive formuese.

Në disiplinat e formimit bazë studentët zhvillojnë njohuritë dhe të kuptuarit në lidhje me ekonominë në nivel mikro dhe makro, matematikën dhe statistikën të cilat i ndihmojnë në zgjedhjen e problemeve.

Në disiplinat karakterizuese në fushën e marketingut studentët aftësohen të drejtojnë proceset marketing; segmentojnë tregun e synuar; pozicionojnë dhe diferencojnë ofertën në treg; të realizojnë një kërkim tregu, të menaxhojnë produktin, markën, menaxhojnë marrëdhëniet me konsumatorët.

Në grupin e lëndëve ndërdisiplinore dhe integruese studentët marrin njohuri dhe aftësohen për të komunikuar në fushën e biznesit, organizimit dhe menaxhimit të ngjarjeve dhe zhvillimit të dhe implementimit të strategjive marketing në internet.

Në disiplinat plotësuese studentët aftësohen në përdorimin e programeve të ndryshme kompjuterike dhe përmirësojnë komunikimin në gjuhën e huaj e njohin përdorimin e terminologjisë në fushën e ekonomisë dhe marketingut.

Detyrimet përmbyllëse lidhen me përgatitjen e tezës së diplomës në formën e një projekti apo përmbledhjeje punimesh të kryera në fushën e marketingut sipas Udhëzuesit të Diplomës.

GVJ vlerëson se programi i studimit Bachelor Administrim Biznesi në Marketing garanton formimin dhe kualifikim e studentëve në fushën e marketingut dhe siguron njohuritë themelore në shkencën e marketingut të krahasueshme me diplomat që lëshojnë strukturat analoge universitare brenda dhe jashtë vendit.

Programi ka përmbajtje të atillë që u ofron studentëve njohuritë bazë të nevojshme për të ndjekur ciklet e tjera të thelluara të studimit.

Evidenca I.26 - Rregullore e programit të studimit

Evidenca I.30 - Programet lëndore: 2019-2020; 2020-2021; 2021-2022

Kriteri 3. Kompetencat dhe



Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti në programin e

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423


E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al


52

<p>aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.</p>	<p>studimit Bachelor Administrim Biznesi në Marketing paraqiten në programin e çdo lëndë. Vlerësimi dhe analizimi i tyre bëhet në bazë të statistikave e rezultateve përfundimtare të lëndës të cilat analizohen nga pedagogu përkatës i lëndës dhe diskutohen në mbledhje të departamentit për reflektime të mëtejshme lidhur me qëllimet e programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.</p>	<p>Në javën e fundit të semestrit pedagogët realizojnë seanca konsultuese ku orientojnë studentët në lidhje me çështjet ku do të përqëndrohet përgatitja e tyre për provimin përfundimtar. Gjatë seancës trajtohen konceptet kryesore, struktura e përgjithshme e tezës dhe udhëzime të tjera lidhur me natyrën e pyetjeve që do të përfshihen në provimin përfundimtar.</p> <p>UNIKO tregon vemendje lidhur me interaktivitetin dhe bashkëveprimin me studentët, si një proces periodik e i përhershëm që zhvillohet në të gjitha lëndët. Nga takimi me studentët, GVJ kuptoi se ata ndihen të lirë dhe të motivuar për të pyetur për çdo paqartësi lidhur me orët e leksionit/seminarit apo të kërkojnë këshillime për çdo ide të tyre për inovacion apo zhvillim të zgjidhjes së problemit.</p> <p><i>Evidenca I.30 - Programet lëndore: 2019-2020; 2020-2021; 2021-2022</i></p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Në përcjelljen e informacionit mbi zhvillimet e reja të shkencës kanë shërbyer aktivitetet kombëtare e rajonale të zhvilluara nga Fakulteti i Ekonomisë, përfshi dhe leksionet e hapura me të ftuar nga industria. Nga njësia përgjegjëse e programit të studimit planifikohen orët e hapura dhe diskutimet mbi zhvillimet aktuale të ekonomisë e biznesit. Gjithashtu, nga takimet në institucion GVJ u njoh me aktivitetet e mbajtura si konferenca studentore dhe workshope për zhvillimin e turizmit të Korçës, pozicionimit të markës së produkteve lokale “Made in Korça” dhe aplikacionit “Discover Korça” pjesë e marketingut dixhital të ndërtuar nga studentë të UNIKO.</p> <p><i>GVJ inkurajon zhvillimin e bashkëpunimeve të mëtejshme të UNIKO me Universitete partnere kombëtare dhe ndërkombëtare për adoptimin e zhvillimeve të reja të shkencës dhe ndërkombëtarizimin e programit të studimit.</i></p> <p><i>Evidenca I.41 - Aktivitete DMT, Konferenca Studentore</i></p>
<p>Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat</p>	<p>Pas dhënies së informacionit teorik, studentët testohen ti aplikojnë ato në praktikë duke punuar në grupe pune, dy ose tre studentë, puna e të cilëve materializohet në detyrë kursi, rast studimi, stimulim i zgjidhjes së një problem biznesi.</p>




<p>profesionale.</p>	<p><i>GVJ thekson dosdoshmërinë e konkretizimit të teorisë në praktikë për të gjitha modulet e programit të studimit dhe se zgjatja e praktikës profesionale do tu shërbente studentëve si faze reflektimi mbi kompetencat e fituara dhe qasjen ndaj zgjidhjeve të problemeve praktike.</i></p> <p><i>Evidenca I.30 - Programet lëndore: 2019-2020; 2020-2021; 2021-2022</i></p> <p><i>Evidenca I.26 - Rregullore e programit të studimit</i></p>				
<p>Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.</p>	<p>Personeli akademik në mënyrë të vazhdueshme mbështet dhe orienton studentët sipas grupeve të punës në lidhje me realizimin e detyrës së caktuar dhe stimulon zgjidhjen e një problemi biznesi. Në këtë proces personeli akademik mbështet idetë inovative të studentëve në zgjidhjen e problemeve të biznesit dhe identifikon fushat të cilat kanë nevojë për thellim teorik dhe studim të mëtejshëm. Këto ide bëhen objekt i kërkimeve të mëtejshme duke u materializuar në tema diplome.</p>				
<p>Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.</p>	<p>UNIKO e ka pjesë të strategjisë kërkimore përfshirjen e studentëve në kërkime shkencore. Sipas RVB studentët kanë marrë pjesë dhe kanë prezantuar punimet e tyre në konferenca rajonale studentore (RIINVEST- 2018 - Prishtinë), si dhe kanë paraqitur punimet e tyre në konferencën studentore të DMT në bashkëpunim me Institutin e Edukimit dhe Trashëgimisë.</p>				
<p>Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.</p>	<p>Gjithashtu studentët kanë mundësi të angazhohen në Marketingut të Universitetit, ku inkurajohen për zhvillimin e ideve inovative në promovimin e UNIKO-së në kuadër dhe të bashkëpunimeve Erasmus+.</p> <p><i>GVJ thekson rëndësinë e mbështetjes financiare të studentëve për nxitjen e novacionit dhe kërkimit shkencor.</i></p> <p><i>Evidenca I.41 - Aktivitete DMT, Konferenca Studentore</i></p>				
<p>Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Në kuadër të strategjisë të ndërkombëtarizimit të Universitetit, është forcuar bashkëpunimi me Universitete partnere si pjesë e programit Erasmus+. Për shkak të ngjashmërisë së kurrikulave, mobilitetet në instancat partnere kanë ndikuar në përmirësimin e formave të mësimdhënies dhe rritjen e mobiliteteve të studentëve. Nga takimi me Drejtorinë e Projekteve, GVJ u njoh me trajnimet dhe shkëmbimet e zhvilluara në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit të dokumentuara në Evidencën 1.40.</p> <p><i>Evidenca I.40 - Marrëveshje bashkëpunimi</i></p>				
<p>Shkalla e përmbushjes</p>	<table border="1"> <tr> <td data-bbox="544 1895 751 1964">Niveli i përmbushjes</td> <td data-bbox="751 1895 951 1964">Përmbushet pjesërisht</td> <td data-bbox="951 1895 1150 1964">Përmbushet kryesisht</td> <td data-bbox="1150 1895 1372 1964">Përmbushet plotësisht</td> </tr> </table>	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht		






së standardit

X

Standardi III.8**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	UNIKO ka rregullore dhe procedura të miratuara për diplomimin e studentëve dhe garanton mbështetjen dhe udhëzimin e studentëve në procesin e diplomimit. Diploma lidhet ngushtë me tematikën që mbulon programi i studimit dhe është një punim i pavarur shkencor i studentit. Departamenti përcakton kriteret dhe standartet e hartimit të një punimi diplome dhe informon studentët për procedurat dhe kriteret e punimit të diplomës të reflektuar në Rregullore e Brendshme e FE, Rregullore e programit të studimit, Udhëzues Diplome. <i>Evidenca I.32 - Rregullore e Brendshme e FE</i> <i>Evidenca I.26- Rregullore e programit të studimit</i> <i>Evidenca II.04 - Udhëzues Diplome</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	Personeli akademik orienton studentët në zgjedhjen e temës sipas fushave të kërkimit që mbulon departamenti. Gjithashtu udhëzon studentët me seanca metodologjike dhe sipas një kalendari takimesh duke i ofruar atyre ndihmë lidhur me informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme. Udhëheqësi i punimit të diplomës planifikon një kalendar komunikimi me studentin dhe përgatit programin e punës së studentit duke vendosur afatet kohore të realizimit të tij. <i>Evidenca II.04 - Udhëzues Diplome</i>
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Në vlerësimin e diplomës së studentit përveç vlerësimit të cilësisë të punimit, aplikimit dhe zbatimit në praktikë, përgjigjet e studentit ndaj pyetjeve, dhe njohuria e tij e fushës, komisioni merr në konsideratë edhe njohuritë dhe arrijtet akademike të studentit, gjatë tre viteve akademike të ciklit të studimeve. <i>Evidenca III.07 - Formati dhe vlerësimi i punimit të diplomave</i>
Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave.	Studenti propozon pedagogun udhëheqës pasi ka marrë paraprakisht dhe aprovimin e tij. Departamenti shqyrton propozimet e studentëve dhe temën dhe garanton që udhëheqësi të jetë në përputhje me fushën e programit të studimit. Përgjegjësi i departamentit miraton listen e temave dhe udhëheqësve shkencor. Gjatë seancave orientuese me pedagogun studentet asistohen për përcaktimin e temave të diplomës dhe udhëzime të tjera mbi

	<p>përmbajtjen e saj nga njësia e programit të studimit.</p> <p><i>Evidenca II.04 - Udhëzues Diplome</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Studentët kanë në dispozicion infrastrukturën e UNIKO-së me dy laboratorë mësues si Laboratori i kompjuterizimit financiar i pajisur me 30 kompjutera, Laboratori i Hoteleri-Turizmit si dhe bibliotekën për konkretizimin e punimit të tyre.</p> <p>Studentët kanë akses për shfrytëzimin e bibliotekës online (U-LIBRARY) dhe bibliotekës elektronike të Institutit të Mikpritjes (Institute of Hospitality, IoH e-library). Pedagogu udhëheqës asiston studentët në realizimin e diplomës dhe vendosjen në zbatim të saj për tregun rajonal deri në përfundim të dorëzimit të saj.</p> <p>Nga bisedat me përgjegjësen e departamentit dhe studentët gjatë vizitës në institucion u konstatua se pedagogët udhëheqës të temave të diplomave, asistojnë studentët si në sigurimin e literaturës dhe përpunimin e të dhënave. Para mbrojtjes së punimit të diplomës, udhëheqësi rishikon dhe miraton punimin e kryer dhe lejon mbrojtjen e tij duke e firmosur atë. Studenti dorëzon kopjen e firmosur të punimit të diplomës në Departament.</p> <p><i>Evidenca II.04 - Udhëzues Diplome</i></p>
<p>Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studentin vlerësohet me notë.</p> <p>Sipas Rregullores së FE-së dhe Programit të Studimit, mbrojtja e diplomës bëhet me gojë dhe studentin vlerësohet me notë sipas komisionit të vlerësimit për mbrojtjen e diplomave Komisioni përbëhet nga jo më pak se 3 anëtarë dhe vlerësimi është unanim, por i bazuar dhe në vlerësimin e udhëheqësit. Mesatarja e vlerësimeve të anëtarëve të komisionit të provimit konvertohet në note.</p> <p><i>Evidenca I.32 - Rregullore e Brendshme FE</i> <i>Evidenca I.26 - Rregullore e programit të studimit</i></p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studentin pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuar nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Sipas Rregullores së Programit të FE studentin nuk mund të mbrojtë punimin e diplomës pa përmbushur të gjitha detyrimet e tjera të programit.</p> <p>Në zbatim të Ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015, në përfundim të studimeve, studentin pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës të miratuar nga MAS.</p> <p><i>Evidenca I.32 - Rregullore e Brendshme FE</i> <i>Evidenca I.26 - Rregullore e programit të studimit</i> <i>Evidenca II.07 - Model i diplomës dhe suplementit</i></p>
<p>Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studentin pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuar nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Sipas Rregullores së Programit të FE studentin nuk mund të mbrojtë punimin e diplomës pa përmbushur të gjitha detyrimet e tjera të programit.</p> <p>Në zbatim të Ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015, në përfundim të studimeve, studentin pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës të miratuar nga MAS.</p> <p><i>Evidenca I.32 - Rregullore e Brendshme FE</i> <i>Evidenca I.26 - Rregullore e programit të studimit</i> <i>Evidenca II.07 - Model i diplomës dhe suplementit</i></p>

Van Alimata

Ar

Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Studentët e programit Bachelor Administrim Biznesi në Marketing pajisen me diplomën, suplementin e diplomës, listën e notave dhe sipas kërkesës nga një kopje të syllabuseve për të gjitha lëndët e përfshira në programin e studimit. <i>Evidenca II.07 - Model i diplomës dhe suplementit</i>			
Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.	Dokumentacioni i studentëve ruhet nga UNIKO për një periudhë të pacaktuar që nga koha e regjistrimit në programin e studimit deri në përfundim të studimeve. Çdo dokumentacion është i arkivuar në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi. GVJ vizitoi nga afër arkivin e sekretaries mësimore ku verifikoi dosje të studentit, regjistrin themeltar, regjistrin e arritjeve akademike dhe vlerësoi angazhimin e institucionit në këtë drejtim. <i>Evidenca I.32 - Rregullore e Brendshme FE</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësimor-shkencor dhe administrativ.	Bazuar në RVB dhe takimin me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, Komunikimit dhe Promocionit, GVJ konstaton se UNIKO administron mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në FE dhe UNIKO. GVJ konstaton se DBNJKP disponon dhe përditëson në fillim të vitit akademik çdo të dhënë apo dokumentacion lidhur me personelin akademik dhe atë administrativ. Departamenti organizon pyetësorë mbi analizën mësimore dhe kërkimore dhe vlerësimin e pedagogut. Gjithashtu, në RVB deklarohet se SKSC në bashkëpunim me Njesinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë kryen pyetësorët studentorë për cilësinë e mësimdhënies. GVJ sugjeron që të bëhen të njohura për stafin dhe

Osman Ahmeti

[Signature]

	<p>studentët rezultatet e dala nga realizimi i pyetësorve.</p> <p><i>Evidenca II.10.2 CV – Stafit Akademik Programi i Studimit Administrim Biznesi në Marketing</i></p> <p><i>Evidenca II.10.1 Jetëshkrimet e Stafit Akademik në Programin e Studimit Bachelor “Administrim Biznesi Në Marketing”</i></p> <p><i>Evidenca II.17 - CV Stafit Ndihmës Akademik</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Referuar RVB, UNIKO garanton një politikë të hapur të punësimit dhe rekrutimit të burimeve njerëzore, duke siguruar transparencën ndaj publikut, paanshmërinë, shanse të barabarta të konkurimit dhe zbatim rigoroz të kriterëve ligjore të parashikuara në Ligjin e Arsimit të Lartë 80/2015 dhe Kodit të Punës. Kriteret e përgjithshme janë të përcaktuara në statutin dhe rregulloren e UNIKO-së dhe procedura kryhet përmes Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, Komunikimit dhe Promocionit që bën shpalljen e vendeve vakante dhe kriterëve në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe në faqen web të UNIKO.</p> <p><i>Evidenca I.01 - Statuti i UNIKO</i></p> <p><i>Evidenca I.02 - Rregullore e Organizimit dhe Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore të UNIKO</i></p> <p><i>Evidenca IV.02 Format i Shpalljes së Vendit Vakant</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kriterëve të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>GVJ konstatoi se kriteret e posaçme e specifike për rekrutimin e personelit në UNIKO janë të përcaktuara në statutin dhe rregulloren e UNIKO-së. Procedura kryhet përmes Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, Komunikimit dhe Promocionit që bën shpalljen e vendeve vakante dhe kriterëve në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe në faqen web të UNIKO dhe zhvillimi i konkursit kryhet nga Komisioni Ad Hoc. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve për personel akademik kryhet sipas Udhëzimit për rekrutimin e stafit akademik. Pas përzgjedhjes së kandidatit fitues nënshkruhet kontrata nga Rektori i UNIKO dhe pasi bëhet emërimi, kandidati fillon punën dhe të dhënat e tij të punësimit ruhen në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, Komunikimit dhe Promocionit të UNIKO.</p> <p><i>Evidenca I.01 - Statuti i UNIKO</i></p> <p><i>Evidenca I.02 - Rregullore e Organizimit dhe Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore të UNIKO</i></p> <p><i>Evidenca IV.02 Format i Shpalljes së Vendit Vakant</i></p> <p><i>Evidenca IV.03 Format i Vendimit të Rektorit për Ngritjen e Komisionit Ad Hoc</i></p> <p><i>Evidenca I.13 Udhëzim Rektori për Rekrutimin e Stafit</i></p>

	<i>Evidenca IV.04 Model i Kontrates Individuale te Punes</i> <i>Evidenca IV.05 Format i Urdher Emerimit</i>			
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Referuar RVB, GVJ konstatoi se UNIKO ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme të kritereve ligjore te parashikuara ne Ligjin e Arsimit te Larte 80/2015 dhe Kodit te Punes. Gjithashtu, kriteret specifike të shpallura të punësimit dhe rekrutimit të burimeve njerëzore garantojnë përzgjedhjen e personelit akademik me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit. Kriteret e përgjithshme janë të përcaktuara në Statutin dhe Rregulloren e UNIKO-së. Nga RVB informohet se kriteret specifike propozohen nga njësia bazë dhe miratohen nga Rektori, të cilat bëhen publike. Gjithashtu, kriteret e rekrutimit të personelit akademik me kohë të pjesshme diskutohen dhe propozohen nga njësia bazë duke parashikuar ngarkesën mësimore të programit të studimit. <i>Evidenca I.01 - Statuti i UNIKO</i> <i>Evidenca I.02 - Rregullore e Organizimit dhe Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore të UNIKO</i> <i>Evidenca IV.02 Format i Shpalljes se Vendit Vakant</i> <i>Evidenca IV.06 - Kriteret e Pranimi dhe Perzgjedhjes se PAK</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efikente dhe efektive

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	Bazuar në RVB, vizita në institucion si dhe nga takimi me Dekanin, përgjegjësen e Departamentit dhe stafin akademik të programit të studimit konstatohet se UNIKO ka vënë në dispozicion të stafit akademik dhe atij administrativ ambiente të dedikuara, si dhe instrumentat e nevojshëm (kompjuterat, kancelari etj.) për të mundësuar mbarëvajtjen e aktiviteteve mësimore dhe administrative. Në RVB deklarohet se UNIKO i ka dhënë mundësinë stafit për trajnime dhe kualifikime të ndryshme në përputhje me fushat e studimit, si dhe përfshirjen në projekte, veprimtari të ndryshme dhe mobilitete për stafin akademik në kuadër të marrëveshje me institucione të tjera vendase dhe të huaja.

Ben Alim

[Signature]

	<p><i>Evidenca III.04 Te Dhena per Infrastrukturen</i> <i>Evidenca IV.08 Niveli i Kualifikimit te Stafit Akademik te Fe</i> <i>Evidenca IV.15 Trajnimi i Stafit per Microsoft Teams</i> <i>Evidenca I.40 Marrëveshjet e Bashkëpunimit midis Fakultetit të Ekonomisë të UNIKO dhe Universiteteve dhe Institucioneve të Tjera</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se UNIKO është e angazhuar për të ofruar lehtësira dhe hapësira për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit dhe mbështet punën e tyre kërkimore përmes mbështetjes së “Buletinit Shkencor” të Universitetit dhe “Revistës Ekonomike” të FE.</p> <p><i>Evidenca IV.08 Niveli i Kualifikimit te Stafit Akademik te Fe</i> <i>Evidenca IV.15 Trajnimi i Stafit per Microsoft Teams</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>GVJ evidenton se UNIKO përdor metodat inovative në mësimdhënie duke përdorur programet si Teams, Office 365 etj, si dhe ka hartuar një udhëzues për përdorimin e tyre dhe organizon trajnime për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik dhe të personelit ndihmës-akademik në përdorimin e tyre.</p> <p><i>Evidenca III.08 Mesimi Online dhe Formati i Vleresimit</i> <i>Evidenca IV.15 Trajnimi i Stafit per Microsoft Teams</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>GVJ konstaton se stafi akademik i angazhuar në programin Bachelor në ABM kanë përvojën disa vjeçare në fushën ku janë angazhuar dhe janë në bazë të kriterëve ligjore të përcaktuara në Ligjin Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p> <p><i>GVJ sugjeron se titullar i lëndës plotësuese “Informatikë” të plotësohet me një personel akademik me gradën “Profesor” në zbatim të Ligjin Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Neni 59, Pika 3.</i></p> <p><i>Evidenca I.36 Të Dhëna për Personelin Akademik të Departamentit “Marketing-Turizëm”</i> <i>Evidenca II.10.1 Jetëshkrimet e Stafit Akademik në Programin e Studimit Bachelor “Administrim Biznesi në Marketing”</i></p>

Van Aliminte

Ascal


	<i>Evidenca II.10.2 CV – Stafit Akademik Programi i Studimit Administrim Biznesi në Marketing .</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Referuar dokumentacionit të DVV-së dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se UNIKO, FE dhe DMT disponojnë mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore (salla leksionesh, laboratorë, salla seminaresh) për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse për zhvillimin e mësimin të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në ABM. Si dhe disponojnë mjediset e punës (zyra), bibliotekë, materiale didaktike (smart board, laptope), materiale logjistike (autoveturë, autobuz) të cilat ndihmojnë për të mbarëvajtjen e procesit mësimor.</p> <p><i>Evidenca III.04 Te Dhena per Infrastrukturen</i></p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se UNIKO, FE dhe DMT disponojnë mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore (salla leksionesh, laboratorë, salla seminaresh) për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse për zhvillimin e mësimin të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në ABM. Si dhe disponojnë mjediset e punës (zyra), bibliotekë, materiale didaktike (smart board, laptope), materiale logjistike (autoveturë, autobuz) të cilat ndihmojnë për të mbarëvajtjen e procesit mësimor.</p> <p>Gjithashtu, në RVB deklorohet se me rikonstruksionin e godinës së re do të përmirësohen mjediset mësimore me video-projektor, smart board, kompjutera e materiale interaktive që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p> <p><i>Evidenca III.04 Te Dhena per Infrastrukturen</i> <i>Vizita ne Institucion: Minutat, Bsc Administrim Biznesi ne</i></p>

Ben Ahmet

Az

<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p><i>Marketing.</i></p> <p>GVJ konstatoi se laboratorët janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit. Gjithashtu, në RVB deklarohet se “Laboratori Hoteleri-Turizëm”, pjese e marrëveshjes me La Foundation pour la Formation Hotelier, është i pajisur me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, si laptopa dhe smart board, dhe ka një kapacitet prej 30 postacionesh, që mund të përdoret nga studentët për praktikë dhe lëndën e marketingut dixhital. Laboratori përmban aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p> <p><i>Evidenca III.04 Te Dhena per Infrastrukturen</i> <i>Evidenca IV.16 Program Simulimi HOTS</i> <i>Evidenca I.40 Marrëveshjet e Bashkëpunimit midis Fakultetit të Ekonomisë të UNIKO dhe Universiteteve dhe Institucioneve të Tjera</i></p>				
<p>Kriteri 4. Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.</p>	<p>GVJ konstaton se UNIKO siguron një laborator të teknologjisë së informacionit, “Laboratorin e Hoteleri-Turizëm”, që është pjese e marrëveshjes me La Foundation pour la Formation Hotelier, të pajisur me programe profesionale dhe me një kapacitet prej 30 postacionesh. DMT gjithashtu ka vënë në dispozicion edhe një program me programe profesionale HOTS sipas natyrës së programit të studimit.</p> <p><i>Evidenca IV.16 Program Simulimi Hots</i> <i>Evidenca I.40 Marrëveshjet e Bashkëpunimit midis Fakultetit të Ekonomisë të UNIKO dhe Universiteteve dhe Institucioneve të Tjera</i></p>				
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.</p>	<p>GVJ konstatoi se UNIKO, FE dhe DMT garantojnë në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.</p> <p><i>Evidenca I.39 Marrëveshje Bashkëpunimi midis Universitetit UNIKO dhe Universiteteve dhe Institucioneve të Tjera</i> <i>Evidenca I.40 Marrëveshjet e Bashkëpunimit midis Fakultetit të Ekonomisë të UNIKO dhe Universiteteve dhe Institucioneve të Tjera.</i></p>				
<p>Shkalla e përmbushjes</p>	<table border="1"> <tr> <td data-bbox="544 1879 762 1948">Përbushet pjesërisht</td> <td data-bbox="762 1879 963 1948">Përbushet kryesisht</td> <td data-bbox="963 1879 1163 1948">Përbushet plotësisht</td> <td data-bbox="1163 1879 1372 1948">Përbushet plotësisht</td> </tr> </table>	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht	Përbushet plotësisht
Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht	Përbushet plotësisht		




Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit

Kriteret**Vlerësimi i ekspertëve**

Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.

GVJ konstatoi se UNIKO dhe FE kanë vënë në dispozicion të studentëve bibliotekën shkencore të UNIKO me një fond prej 4071 librash dhe 1265 titujsh dhe me një kapacitet prej 6 postacione kompjuterash dhe 80 vende studimi, dhe bibliotekën mësimore të FE me një fond prej 5316 librash dhe 3610 titujsh dhe me një kapacitet prej 39 vendeve studimeve, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët dhe personelit akademik të programit të studimit, por, ashtu sikurse është theksuar dhe mësipër në këtë raport, *fondi në gjuhën shqipe dhe të huaj për modulet e këtij programi studimi është i vogël dhe një pjesë e teksteve mësimore të paraqitura në syllabuse nuk gjenden fizikisht në bibliotekë.*

Evidenca III.06 Biblioteka

Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.

GVJ konstatoi se bibliotekat janë të pajisura me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, libra apo revista shkencore etj, në gjuhë shqipe dhe të huaja, por për këtë program studimi kjo literaturë rezultoi e limituar, duke qënë se nga vizita e GVJ rezultoi se, një pjesë e teksteve mësimore të paraqitura në syllabuse nuk gjenden fizikisht në bibliotekë.

Evidenca III.06 Biblioteka

Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.

GVJ konstatoi se UNIKO ka krijuar kushtet për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit, si ULIBRARY të mundësuar nga marrëveshja me RASH si pjesë e UNIKO (gjatë kohës kur kjo marrëveshje ishte në fuqi), Institutit të Mikpritjes (IoH e-library) dhe në skemën e Education Membership Scheme (EMS) të mundësuar nga marrëveshja me La Foundation pour la Formation Hotelier si pjesë e FE.

Evidenca III.06 Biblioteka


Evidenca I.43 Lista e Librave të Dhuruar

Ben Ahmet

[Signature]

<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>GVJ konstatoi se biblioteka shkencore është e pajisur me programe kompjuterike dhe bibliotekë dixhitale si J-STORE, që mundëson shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p> <p><i>Evidenca III.06 Biblioteka</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>GVJ konstatoi se UNIKO ka marrë masat për shtimin e zërave të bibliotekës dhe përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit me anë të Urdhrit Nr. 39, dt. 25/01/2019 të Rektorit të UNIKO dhe shkresës nr. 1518, dt. 20/09/2019, së Zv. Rektorit për shkencën dhe projektet drejtuar Administratores së UNIKO për blerje të literaturës.</p> <p><i>Evidenca III.06 Biblioteka</i></p>			
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>GVJ konstatoi se biblioteka është vënë në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p> <p><i>Evidenca III.06 Biblioteka</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Niveli i përmbushjes</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Standardi IV.5 Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi se UNIKO disponon sistemin e menaxhimit ESSE3 të ofruar nga marrëveshja me RASH (ritheksojmë se kjo marrëveshje aktualisht ka skaduar) nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p> <p><i>Evidenca III.05 Marrëveshja midis UNIKO dhe RASH për ESSE3</i> <i>Evidenca 1.6.1 Marrëveshje RASH për ESSE3</i></p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës</p>	<p>GVJ konstatoi se sistemi i menaxhimit ESSE3 monitoron në kohë reale dhe administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin</p>




akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	e programit. <i>Evidenca III.05 Marrëveshja midis UNIKO dhe RASH për ESSE3</i> <i>Evidenca 1.6.1 Marrëveshje RASH për ESSE3</i>								
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	GVJ konstatoi se sistemi i menaxhimit ESSE3 siguron akses me llogari unike të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit. Gjithashtu, UNIKO ka hartuar një udhëzues për përdorimi e sistemi i menaxhimit ESSE3 për të gjithë personelin dhe studentët. <i>Evidenca III.05 Marrëveshja midis UNIKO dhe RASH për ESSE3</i> <i>Evidenca 1.6.1 Marrëveshje RASH për ESSE3</i> <i>Evidenca 1.6 Rregullore e ESSE 3</i>								
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	Në RVB deklarohet se në bazë të Planit Strategjik të UNIKO ka kërkuar që sistemi i komunikimit Microsoft 365 të integrohet me sistemin e menaxhimit. Kjo ka mundësuar mbarëvajtjen e shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve. <i>Evidenca IV.15 Trajnimi i Stafit per Microsoft Teams</i>								
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	GVJ konstatoi se sistemi i menaxhimit ESSE3 garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët. <i>Evidenca III.05 Marrëveshja midis UNIKO dhe RASH për ESSE3</i> <i>Evidenca 1.6.1 Marrëveshje RASH për ESSE3</i>								
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Në RVB informohet se informacionet që lidhen me programin e studimit Bachelor në ABM, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, janë të publikuara në faqen e internetit të UNIKO në dy gjuhë, shqip dhe anglisht. Mirëpo GVJ nuk arriti ta konfirmojë këtë, për shkak se faqja web e institucionit është aktualisht jashtë funksionit, për shkak të përfundimit të marrëveshjes që insitucioni ka me RASH për mundësimin e faqes web dhe sistemit ESSE3.								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi IV.6

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Van Alimata

[Signature]

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>GVJ konstatoi se UNIKO çdo vit harton një raport financiar të kostove të programit të studimit ku pasqyron koston për student sipas Ligjit të Arsimit të Lartë dhe si dhe sipas Statutit të UNIKO dhe Planit Strategjik të Zhvillimit të UNIKO.</p> <p><i>Evidenca IV.10 Te Dhena Kostot per Student</i> <i>Evidenca 1.1 Statuti i UK</i> <i>Evidenca 1.3 Plani Strategjik UNIKO 2016-2020</i> <i>Evidenca 1.3.1 Draft Plani Strategjik i Zhvillimit të UNIKO</i></p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>GVJ konstaton se UNIKO harton planin e financimit (projekt-buxhetin) të një programit të studimit Bachelor në ABM, që përmban financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.</p> <p><i>Evidenca 1.1 Statuti i UK</i> <i>Evidenca 1.3 Plani Strategjik UNIKO 2016-2020</i> <i>Evidenca 1.3.1 Draft Plani Strategjik i Zhvillimit të UNIKO</i> <i>Evidenca 1.8.1 Rregullorja Financiare</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p> <p><i>Evidenca IV.14 Raporti i Auditimit 2019</i></p>
<p>Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>GVJ konstaton se në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, UNIKO dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p> <p><i>Evidenca IV.11 Fondet e UNIKO</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet</p>	<p>Nga RVB deklorohet se UNIKO dëshmon se garanton</p>

Van Alimata

Ar

të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.	<p>qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen. Qëndrueshmëria financiare garantohej përmes miratimit të projektbuxhetit afatmesëm trevjeçar nga Bordi i Administrimit i UNIKO. Fondet vijnë nga granti i buxhetit i akorduar nga MAS dhe nga taksat e studentëve.</p> <p><i>Evidenca IV.11 Fondet e UNIKO</i> <i>Evidenca 1.1 Statuti i UK</i> <i>Evidenca 1.3 Plani Strategjik UNIKO 2016-2020</i> <i>Evidenca 1.3.1 Draft Plani Strategjik i Zhvillimit të UNIKO</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	<p>UNIKO ka hartuar dhe vënë në zbatim politika dhe procedura që mbulojnë në mënyrë të plotë ciklin profesional të studimeve universitare në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p> <p>Programi i studimit ka përcaktuar qartë objektivat që lejojnë formimin e studentëve duke zhvilluar njohuri, aftësi dhe kompetenca profesionale e analitike.</p> <p>Kriteret e pranimit të studentëve përcaktohen nga MAS në përputhje me udhëzimet dhe kuotat e përcaktuara në aktet nënligjore për vitin akademik përkatës.</p> <p>Politikat dhe procedurat e hartuara reflektohen në Statutin e UNIKO; Rregulloren e Brendshme të FE ; Rregulloren e programit të studimit.</p> <p><i>Evidenca I.01- Statuti i UNIKO</i></p>

Osca Alim

Ar

	<p><i>Evidenca I.32- Rregulloren e Brendshme e FE</i> <i>Evidenca I.26 - Rregullore e programit të studimit</i></p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Rregullorja e programit të studimit përmban në mënyrë të detajuar procedurat dhe praktikat e trajtimit të studentëve që nga momenti i regjistrimit dhe deri në përfundim të studimeve apo transferimit të tyre, gjë që garanton politika dhe procedura transparente për trajtim të barabartë të të gjithë kandidatëve dhe studentëve të programit.</p> <p><i>Evidenca I.26 - Rregullore e programit të studimit</i></p>
<p>Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Kriteret dhe procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë ndjekjes së programit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit përcaktohen qartë në rregulloren e programit të studimit dhe rregulloren e FE.</p> <p>Kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në ciklin e studimeve 3-vjeçare Bachelor Administrim Biznesi në Marketing përcaktohen nga MAS për vitin akademik përkatës dhe publikohen nga institucioni në fillim të çdo viti akademik. Sipas rregullores së programit të studimit, pranimi në programet e studimit të ciklit të parë bëhet i mundur për ata që kanë përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm të përgjithshëm apo profesional, si dhe kandidatët që disponojnë diplomën e shkollës së mesme jashtë vendit (të ekuivalentuar nga MAS).</p> <p><i>Evidenca I.32- Rregulloren e Brendshme e FE</i> <i>Evidenca I.26 - Rregullore e programit të studimit</i> <i>Evidenca II.12- Kriteret e pranimit</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p><i>Evidenca I.01- Statuti i UNIKO</i> <i>Evidenca I.32- Rregulloren e Brendshme e FE</i> <i>Evidenca I.26 - Rregullore e programit të studimit</i> <i>Evidenca II.12- Kriteret e pranimit</i></p>
<p>Kriteri 5. Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>Shtetasit shqiptarë, shqipëtarët jashtë kufijve shtetërorë, si dhe shtetasit e huaj kanë të drejtën të ndjekin studimet vetëm nëse përmbushin kriteret e përcaktuara nga MAS, statuti i UNIKO dhe rregulloret përkatëse në lidhje me studimet e ciklit të parë.</p> <p><i>Evidenca I.01- Statuti i UNIKO</i> <i>Evidenca I.32- Rregulloren e Brendshme e FE</i> <i>Evidenca I.26 - Rregullore e programit të studimit</i> <i>Evidenca II.12- Kriteret e pranimit</i></p>
<p>Kriteri 6. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Studentët, mund të gjejnë informacionin e duhur në fakultet, departamente dhe në çdo strukturë përgjegjëse për mbarëvajtjen e procesit mësimor. Në përputhje me aktet rregullative në fuqi, institucioni kryen në disa drejtime informimin sa më të gjerë në lidhje me programin e studimit dhe kriteret e veçanta për tu pranuar. Përpara fillimit të çdo viti akademik, UNIKO udhëzon</p>

Van Alimata

Ar

	<p>publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit përmes websitit të tij, pritjes dhe informimit nga këshilluesit e karrierës, komunikimit dhe takimeve me studentët potencialë në gjimnazet e Korçës. Nga vizita në insitucion GVJ u njoh me planin e aktivitete të informimit të maturantëve nga Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumnit përpara fillimit të vitit akademik. Ato zhvillojnë aktiviteteve informuese për kandidatët ku bëhen prezantime rreth organizimit të studimeve, të drejtave dhe detyrimeve të studentëve, informacione mbi, njohjen me të gjitha ambientet fizike të fakultetit apo të universitetit.</p> <p><i>GVJ sugjeron hartimin e guidës së studentit si material që ka informacionin e nevojshëm në fillim të vitit akademik, veçanërisht informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, infrastrukturën laboratorike dhe shërbimet e tjera që përfitojnë studentët në UNIKO. Aktualisht programi i studimit ofrohet në gjuhën shqipe, por në rast të aplikimeve nga studentë të huaj, UNIKO duhet të rrisë kapacitetet dhe të ofrojë programin dhe në gjuhën angleze.</i></p> <p><i>Evidenca I.28 - Analiza e veprimtarisë së QKA</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Plotësisht përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Informacion i hollësishëm në lidhje me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimin nga një vit akademik në tjetrin paraqitet qartë në rregulloren e FE si dhe atë të programit të studimit. Ky informacion vihet në dispozicion nga zyra e këshillimit të karrierës dhe alumni dhe sekretaria e institucionit.</p> <p>Në fillim të çdo viti akademik, njësia bazë përgjegjëse së bashku me dekanatin dhe Zyrën e Karrierës dhe Zyra e informimit dhe orientimit të studentëve në FE organizojnë takime informuese ku ju shpjegojnë në detaje përbërjen e UNIKO, strukturat e tij, përbërja dhe struktura e Fakultetit dhe departamentit. Gjithashtu bëhet edhe prezantimi me infrastrukturën, bibliotekën, laboratorët dhe kushtet në të cilat do të realizohet ky program studimi..</p>

Gen Alumnit

[Signature]

	<p>Studentët informohen edhe nëpërmjet planit mësimor për strukturën e moduleve dhe shpërndarjen në semestra të tyre. Informacion i plotë dhe i përditësuar për strukturën institucionale dhe programet e studimit mundësohen nga faqja zyrtare e universitetit si dhe nga mediat sociale.</p> <p><i>Evidenca I.32- Rregulloren e Brendshme e FE</i> <i>Evidenca I.26 - Rregullore e programit të studimit</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>UNIKO informon studentët në lidhje me kriteret dhe procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme nëpërmjet sekretarisë mësimore, zyrës së këshillimit të karrierës, dhe departamentit përkatës të programit të studimit. Kriteret dhe procedurat e transferimit përcaktohen në Rregulloren e insitucionit dhe të programit të studimit dhe bëhen publike përmes faqes web të UNIKO-së si dhe vihen në dispozicion të studentëve përmes sekretarisë mësimore e FE dhe drejtuesittë njësisë bazë.</p> <p><i>Evidenca I.32- Rregulloren e Brendshme e FE</i> <i>Evidenca I.26 - Rregullore e programit të studimit</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>UNIKO informon studentët lidhur me vlerësimin e dijeve nëpërmjet Rregullores së Programit të studimit ku paraqiten:</p> <p>Sistemi i vlerësimit; forma e vlerësimit; forma e kontrollit të dijeve; kushtet për hyrjen në provim; organizimin e provimeve; shpalljen e rezultateve; ankimimin dhe rishikimin e notës.</p> <p>Në programet e secilës lëndë ka informacion të detajuar lidhur me kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve. Studentët e aksesojnë informacionin dhe në distance përmes sistemit ESSE 3 (gjatë kohës kur ky sistem ishte aktiv) dhe fizikisht pranë sekretarisë së departamentit të programit të studimit. Në fillim të çdo semestri, programi dhe kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve shpjegohen nga pedagogu i lëndës përkatëse.</p> <p><i>Evidenca I.32- Rregulloren e Brendshme e FE</i> <i>Evidenca I.26 - Rregullore e programit të studimit</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>UNIKO u vendos në dispozicion studenëve udhëzues të shkruar mbi kriteret e procedurat e punimit të diplomës, të miratuara nga Departamenti dhe paraqitura tek Udhëzuesi i diplomës. Gjithashtu siç u sqarua ne fushën III gjatë periudhes së përgatitjes të punimit te diplomes zhvillohen seancat metodologjike dhe pedagogu udhëheq studentët për punim e diplomës.</p>

Osca Ahmeti

[Signature]

	<i>Evidenca II.04- Udhëzues Diplome</i>			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Gjatë vizitës në institucion, GVJ u informua se në fillim të çdo viti të ri akademik, UNIKO zhvillon takime orientuese nëpërmjet të cilave studentët e rinj njihen me programet e studimit, pedagogët, ambjentet dhe disa nga rregullat bazë të universitetit. Pjesë e tyre është dhe Dita e Informimit të Maturantëve ku janë organizuar takime të hapura informuese në shkollat e mesme të përgjithshme dhe profesionale të Qarkut të Korçës mbi programin e studimit. Gjithashtu faqja zyrtare online dhe rrjetet sociale japin informacion për të interesuarit mbi programet e studimit. <i>Megjithatë GVJ rekomandon më shumë përpjekje nga institucioni në drejtim të marketimit të programit të studimit Bachelor Administrim Biznesi në Marketing, me qëllim rritjen e kërkesës dhe forcimin e programit të studimit në të ardhmen.</i> <i>Evidenca I.28 - Analiza e veprimtarisë së QKA</i> <i>Evidenca II.14 - Kalendar i veprimtarisë</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Plotësisht përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	Departamenti i Marketing-Turizmit informon studentët në lidhje me strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit, nëpërmjet rregullores së programit të studimit. Ky informacion vendoset në dispozicion të studentëve nga websiti i UNIKO, Zyra e informimit të studentëve, Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumni ku studentët mund të marrin informacion të hollësishëm, lidhur me organizimin e plotë të studimeve të programit të studimit si dhe për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit. <i>Evidenca I.28 - Analiza e veprimtarisë së QKA</i> <i>Evidenca II.14 - Kalendar i veprimtarisë</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe	RVJ konstaton se UNIKO informon studentët në lidhje me programin e studimit, procesin mesimor, rregulloren e brendshme, rregulloren e studimeve, procedurat e procesit

Osman Alimati

Jos

<p>dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>mësimor etj., nëpërmjet zyrës së sekretarisë dhe koordinatoreve si dhe në mënyrë elektronike në sistemin e UNIKO, dhe në websit-in e institucionit (gjatë kohës kur web-i dhe sistemi ESSE3, ishin aktiv). Në fillim të çdo semestri studentët pajisen me të gjithë syllabuset e lëndëve.</p> <p><i>Evidenca I.28 - Analiza e veprimtarisë së QKA</i> <i>Evidenca II.14 - Kalendari i veprimtarisë</i> <i>Evidenca III.05 Marrëveshja midis UNIKO dhe RASH për ESSE3</i> <i>Evidenca 1.6.1 Marrëveshje RASH për ESSE3</i> <i>Evidenca 1.6 Rregullore e ESSE 3</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.</p>	<p>Zyra e Karrierës dhe Alumni në bashkëpunim me Zyrën e Informimit dhe orientimit për studentët, informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe i mbështet ata në mënyrë institucionale për ti orientuar në tregun e punës.</p> <p>Aktivitetet e punësimit të studentëve përfshijnë Panairë pune nga Shërbimi kombëtar i punësimit; Biznese të ftuar në auditor; aktivitete Alumni, dhe bashkëpunime me organizma dhe biznese lokale. Institucioni përmes dy zyrave përgjegjëse inkurajon studentët të marrin pjesë dhe informon ata mbi zhvillimet në tregun e punës.</p> <p><i>Evidenca I.28 - Analiza e veprimtarisë së QKA</i> <i>Evidenca II.14 - Kalendari i veprimtarisë</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Gjatë vizitës së institucionit, GVJ u informua se në fillim të çdo viti të ri akademik, UNIKO zhvillon “Javën e Informimit”, nëpërmjet të cilës studentët e rinj njihen me programet e studimit, pedagogët, ambjentet dhe disa nga rregullat bazë të universitetit. Gjatë kësaj jave zhvillohen takime informuese të organizuara nga Drejtuesi i njësisë së programit në bashkëpunim me Qendrën e Karrierës dhe Alumni dhe Zyra e Informimit për studentët.</p> <p>Gjithashtu faqja zyrtare online dhe rrjetet sociale japin informacion për të interesuarit mbi programet e ardhshme të studimit.</p> <p><i>Evidenca I.28 - Analiza e veprimtarisë së QKA</i> <i>Evidenca II.14 - Kalendari i veprimtarisë</i></p>
<p>Kriteri 5 Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance.</p>	<p>Informacionet e nevojshme për studentët, në UNIKO monitorohen dhe menaxhohen nga një sistem i brendshëm i informacionit i mirëorganizuar. Studentët kanë mundësi të aksesojnë informacion të plotë mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij përmes zyrës të kujdesit ndaj studentëve, sekretarisë dhe kordinatorëve përkatës.</p>

Gen Alumnit

[Signature]


	UNIKO disponon nje sistem të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe është i arritshëm nga studentët jo vetëm në ambientet e institucionit por edhe në distancë. <i>Evidenca I.32- Rregulloren e Brendshme e FE</i> <i>Evidenca 1.6 Rregullore e ESSE 3</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimit në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.	<p>Në analizën mësimore të departamentit të Marketing Turizëm gjenden të pasqyruara statistikat vjetore lidhur me numrin e studentëve të regjistruar në programin Bachelor Administrim Biznesi në Marketing. UNIKO disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit të konstatuara në sekretarinë e njësisë në formë elektornike dhe fizike përmes regjistrave të lëshimit të diplomave. Njëpërmjet Zyrës Alumni po bëhen përpjekje për sigurimin e kontakteve me ish-studentë me qëllim jo vetëm ndarjen e eksperiencave dhe arritjeve profesionale të gjithsecilit por edhe krijimin e urave efektive lidhëse midis universitetit e tregut të punës.</p> <p>Sipas Raporteve vjetore të UNIKO-së – Cilësia në hyrje e në dalje të studentëve dhe vizitës së GVJ në sekretarinë mësimore u konstatua se numri i studentëve në këtë program studimi në tre vitet akademike ishte:</p> <p>Për vitin akademik 2020-2021 : 16 studentë Për vitin akademik 2019-2020 : 21 studentë + 4 të transferuar Për vitin akademik 2018-2019 : 28 studentë + 4 të transferuar Për vitin akademik 2017-2018 : 28 studentë + 12 të transferuar</p> <p>Për sa i përket numrit të të diplomuarve në këtë program studimi rezulton se:</p> <p>Për vitin akademik 2019-2020 janë diplomuar gjithsej 16 studentë; Për vitin akademik 2018-2019 janë diplomuar gjithsej 21 studentë; Për vitin akademik 2017-2018 janë diplomuar gjithsej 17</p>

Van Alumnit



[Signature]

	<p>studentë;</p> <p>GVJ konstatoi se numri i studentëve ka ardhur duke u ulur dhe njësia duhet të angazhohet në evidentimin e analizimin e studentëve ndër vite në bashkëpunim me Zyrën Alumni në funksion të strategjisë së përforcimit të programit të studimit.</p> <p><i>Evidenca V.02 - Të dhëna statistikore për studentët e programit të studimit</i> <i>Evidenca III.02 - Raportet vjetore të DMT</i> <i>Evidenca VI.02 - Raporti i vlerësimit të brendshëm</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Të dhënat për studentët e regjistruar, të diplomuar, kalueshmeria në vite gjenden pranë sekretarisë mësimore. GVJ konstatoi se Sekretaria mësimore disponon dosjet për çdo student, të cilat përmbanin dokumentacionin e duhur dhe të noterizuar, si diploma e maturës shtetërore, listë notash, kontrata dhe aneks kontrata, deklarata e studentit, dokumenti i identifikimit, dy fotografi. Statistikat e studenëteve disponohen në formë elektronike dhe fizike në sekretarinë e njësisë.</p> <p><i>Evidenca V.02 - Të dhëna statistikore për studentët e programit të studimit</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ ju vunë në dispozicion regjistri themeltar, regjistri i rezultateve të arritura nga studentet të programit Bachelor Administrim Biznesi në Marketing, të cilët rezultuan të plota dhe në përputhje me kërkesat ligjore për to. Të dhënat në regjistrat janë konfidenciale dhe lehtësisht të verifikueshme vetëm nga personat e autorizuar, në përputhje me aktet normative të ruajtjes së të dhënave personale të UNIKO-së.</p>
<p>Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Të dhënat statistikore për programin e studimit menaxhohen nga sekretaria mësimore dhe departamenti Marketing-Turizëm. Sekretaria mësimore çdo vit përgatit të dhëna statistikore lidhur me numrin e studentëve të regjistruar, të larguar, të çregjistruar etj., bazuar në procedurat e përcaktuara në rregulloren e UNIKO-së. Statistikat e përgatitura ruhen në formë elektronike dhe hard-copy dhe përdoren si për analiza të aspekteve specifike ashtu dhe në kuadër të raportit vjetor në nivel fakulteti dhe universiteti.</p> <p>I gjithë informacioni në lidhje me studentët ruhet në sistemin ESSE 3 dhe aksesohet vetëm përmes studentit sipas numrit të matikulimit të tij. Sistemi mban të dhëna për prezencën, vlerësimin dhe stadin ku ndodhet një student me programin që ndjek.</p> <p><i>Evidenca I.09 - Rregullore për mbrojtjen, ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave personale</i></p>




<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Referuar takimeve në insitiucion dhe dokumentacionit të paraqitur, rezulton se departamenti harton raportin vjetor të analizës mësimore mbi programin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe punësimin e tyre. Departamenti reflekton mbi gjendjen aktuale dhe bazuar në këto të dhëna propozon masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve. Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI dhe Orientimit të Studentit informojnë lidhur me shkallën e punësimit të studentëve sipas programeve të studimit. Këto njësi ofrojnë shërbim të plotë të menaxhimit të karrierës, mbështetje në kërkimet e punësimit gjatë të gjithë periudhës së studimit, njoftime punësimi periodike si dhe ndihmë konkrete rreth mënyrës së kërkimit të punës dhe përgatitjes së CV dhe dokumenteve të tjerë të rekrutimit.</p> <p><i>Evidenca III.02 - Raportet vjetore të DMT</i> <i>Evidenca VI.02 - Raporti i vlerësimit të brendshëm</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Niveli i përmbushjes</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi V.5 Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>Studentët kanë mbështetjen e UNIKO për tu angazhuar në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore në fuqi. Nga takimi në institucion u informuam se studentët organizohen në Këshillin Studentor, në Focus Grupe për vlerësimin e procesit mësimor dhe dhënë ide për përmirësime të vazhdueshme në përputhje me nevojat e tyre si dhe në procesin e anketimit për vlerësimin për lëndët dhe pedagogun.</p> <p>GVJ konfirmon se studentët kanë përfaqësuesit e tyre në: Senatin Akademik dhe në komisione të përhershme si NJBSC dhe në Këshillin e Etikës, sipas përcaktimeve në statutin e UNIKO-së dhe rregullore e FE nëpërmjet të cilave është garantuar përfaqësimi i studentëve në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik.</p> <p><i>Evidenca I.01 - Statuti i UNIKO</i> <i>Evidenca I.32 - Rregullore e brendshme e FE</i></p>


<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>UNIKO garanton përfshirjen e studentëve në vendimmarrje dhe në këshillim dhe vlerësimin mbi procesin akademik. Studentët organizohen në Këshilla Studentore ku shprehin mendimin e tyre për problematika të ndryshme lidhur me çështje të programeve mësimore dhe procesit mësimor. Gjithashtu NJSBC organizon anketime me studentët, përmes të cilave mendimet dhe propozimet e studentëve u paraqiten departamentit dhe merren masat përkatëse korrigjuese.</p> <p>Nga takimi me studentët mësuam se ata janë në djeni të këtyre stukturave dhe i mbështesin ato.</p> <p>Këshilli studentor i UNIKO është organ kolegjal, me përfaqësues të zgjedhur nga vetë studentët. Këshilli studentor ka komunikim institucional me strukturat e tjera në UNIKO për të përcuar në mënyrë e drejtpërdrejtë e për të marrë në rrugë të shpejtë mendimin dhe zërin e studentëve. Aktivitetet e Studentëve mbështeten në forma të ndryshme nga ana e institucionit. Studentët shprehin mendimet e tyre për procesin mësimor dhe për aspekte që lidhen konkretisht me studentin, nëpërmjet vlerësimeve semestrale, takimeve informale, nëpërmjet zyrës së shërbimit ndaj studentit etj.</p> <p><i>Evidenca I.17 - Rregullore e Këshillit Studentor</i> <i>Evidenca I.01 - Statuti i UNIKO</i></p>
<p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>Programi i studimit është organizuar duke marrë në konsideratë aftësinë e studentëve për të përvetësuar njohuritë. Në vlerësimin e ngarkesës akademike janë mbajtur në konsideratë si marrja e informacionit teorik ashtu dhe atij praktik përmes detyrave dhe projekteve të kursit. Vlerësimi i studentit realizohet në mënyrë të shpërndarë gjatë semestrit në raportin 70:30. Kjo formë vlerësimi inkurajon angazhimin e studentëve gjatë kursit.</p> <p>Departamenti është bashkëpunues me studentët për të lehtësuar praktikën e plotë të njohjes së lëndëve dhe ka procedurë joburokratike të njohjes së studimeve të mëparshme. Në dokumentat rregullative në nivel universiteti, fakulteti dhe specifikisht në rregulloren e programit të studimit është parashikuar procesi i transferimit të studimeve (njohje të pjesshme ose e plotë e studimeve) në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi për këtë aspekt.</p> <p><i>Evidenca I.32 - Rregullore e brendshme e FE</i> <i>Evidenca I.26 - Rregullore e programit të studimit</i> <i>Evidenca II.01 - Planet mësimore: 2021-2022; 2020-2021; 2019-2020</i></p>

Osman Ahmeti

[Signature]

<p>Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Studentët në mënyrë indirekte përfshihen në rishikimin e syllabuseve apo të programit Bachelor Administrim Biznesi në Marketing. Kjo për faktin se studentët angazhohen në vlerësimin e performancës së pedagogëve dhe në dobinë e disiplinës akademike përmes anketimeve nga NJSBC.</p> <p>GVJ konstaton që institucioni është i hapur ndaj sugjerimeve të studentëve për përmirësimin e programit të studimit në përputhje dhe me kërkesat e tregut të punës.</p> <p><i>Evidenca I.32 - Rregullore e brendshme e FE</i> <i>Evidenca I.26 - Rregullore e programit të studimit</i></p>			
<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njesisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Studentët përmes anketimeve dhe focus grupeve të realizuara nga institucioni mund të japin mendimin e tyre mbi kryerjen e procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve Gjithashtu, nga vizita në institucion u informuam se pas çdo provimi pedagogu vendos seanca sqaruese në të cilat studentët kuptojnë dhe komunikojnë me pedagogun përkatës lidhur me vlerësimin dhe mundësinë për rishikim të vlerësimit.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi V.6 Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p>	<p>Disa nga njësitë e informimit për shërbimet ndaj studentëve janë Departamenti, ku studenti merr informacione mbi organizimin e mësimin, aktivitete të ndryshme, diplomimin, procesin mësimor; Sekretaria mësimore ku studenti merr shërbime, informohet mbi ecurinë dhe progresin e tij në këtë program studimi; Zyra e karrierës dhe Alumni ku studentët marrin informacion mbi trajnimet, praktikat dhe ofertat e punësimit. UNIKO ka krijuar procedurë në shërbim të informimit të studentëve në përputhje rregullatore e institucionit.</p> <p><i>Evidenca I.01 - Statuti i UNIKO</i> <i>Evidenca I.32 - Rregullore e brendshme e FE</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për</p>	<p>UNIKO ka një sistem online për informimin, këshillimin, ndjekjen, asistimin e studentëve për çështje që kanë të bëjnë me</p>




<p>informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>procesin mësimor dhe programin e studimit. ESSE 3 ofron informacione të përditësuara për procesin mësimor dhe programin e studimit. Baza e të dhënave për studentin përfshin edhe emailin si një mjet për informim dhe këshillim nga zyrat përkatëse dhe kordinatorët. Gjithashtu ka ngritur zyrën e informimit dhe orientimit të studentëve për asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. Mirëpo siç është përmendur disa herë dhe më sipër në këtë raport, sistemi ESSE3, gjatë vizitës në institucion ishte jashtë shërbimit për shkak të përfundimit të marrëveshjes me RASH.</p> <p><i>Evidenca III.05 Marrëveshja midis UNIKO dhe RASH për ESSE3</i> <i>Evidenca 1.6.1 Marrëveshje RASH për ESSE3</i> <i>Evidenca 1.6 Rregullore e ESSE 3</i></p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>RVJ konstatoi se Qendra e Karrierës dhe Alumni (QKA) luan rol të rëndësishëm në këshillimin dhe orientimin e studentëve në mënyrë të vazhduar dhe periodike për praktikën profesionale dhe tregun e punës. Përmes panairëve të organizuara, projekteve bashkëpunuese me biznesin, UNIKO shkëmben informacion lidhur me njohuritë dhe aftësitë që ofron programi i studimit dhe profilet në tregun e punës.</p> <p><i>Evidenca I.28 - Analiza e veprimtarisë së QKA</i> <i>Evidenca V.03 - QKA-Kalendari i Veprimtarive</i></p>			
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Zyra për Këshillimin e Karrierës dhe Alumni ndjekin studentët pas diplomimit duke mbledhur, përpunuar dhe mbajtur të dhëna mbi punësimin e studentëve të programit të studimit. GVJ nga vizita në institucion u informua se Departamenti i Marketingut dhe Turizmit ka rrjetin e tij në tregut të punës të cilët sigurojnë informacion dhe ua vënë në dispozicion organeve dhe autoriteteve drejtuese përkatëse.</p> <p><i>Evidenca I.28 - Analiza e veprimtarisë së QKA</i> <i>Evidenca V.03 - QKA-Kalendari i Veprimtarive</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X


<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Gen Alim

Ar

VI.SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Bazuar në RVB dhe dokumentacion, si dhe vizitën në institucion, GVJ konstaton se politikat dhe strategjia në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë janë të rregulluara në Statutin e UNIKO, Kreu IX, neni 73 dhe 74; në Rregulloren e FE, Kreu VIII, neni 101 dhe 102; në Planin Strategjik të Zhvillimit të UNIKO 2016-2020, Akreditimi dhe kontrolli i cilësisë, f. 31-35; në Planin Strategjik të Zhvillimit të UNIKO 2022-2027, Vlerësimi i cilësisë, f. 19-21 dhe Plan i rezultateve të pritshme nga objektivat – veprimtaria mësimore dhe vlerësimi i cilësisë, f. 40-42 dhe është krijuar Manuali i Cilësisë së UNIKO. Standardet e sigurimit të cilësisë në përputhje me Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë dhe standardet europiane të cilësisë.</p> <p><i>Evidenca 1.1 - Statuti i UK</i> <i>Evidenca 1.32 - Rregullore e Brendshme e Fakultetit të Ekonomisë</i> <i>Evidenca 1.3 - Plani Strategjik UNIKO 2016-2020</i> <i>Evidenca 1.3.1 - Draft Plani Strategjik i Zhvillimit të UNIKO.</i> <i>Evidenca 1.16 - Manuali i Cilësisë UK 2020</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni, bazuar në Statutin e UNIKO dhe Manuali i Cilësisë së UNIKO, ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm. SKVIA është pjesë e DKVI dhe menaxhon rrjetin e sigurimit të cilësisë në UNIKO. Brenda këtij sektori funksionon NJSBC.</p> <p><i>Evidenca 1.1 - Statuti i UK</i> <i>Evidenca 1.16 - Manuali i Cilësisë UK 2020</i> <i>Evidenca 1.5 - Rregullore e Drejtorisë së Kurrikulave (NJSBC, QKA)</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, siç është Manuali i Cilësisë. Vlerësimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet nga ASCAL. Gjithashtu, në RVB deklarohet se UNIKO monitoron në mënyrë</p>




<p>jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>të vazhdueshme Sondazhet Kombëtare të Studentëve, që është një nga mekanizmat kryesorë të sigurimit të jashtëm të cilësisë në UNIKO.</p> <p><i>Evidenca 1.16 Manuali i Cilësisë UK 2020</i> <i>Evidenca III.01 Model i Pyetesorit Studentor.</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjve përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe dokumentacionin përkatës (statuti i UNIKO, rregullorja e FE, Planet strategjike, Manuali i Cilësisë) dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, përmes njëjve përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit si SKVIA, SKSC, NJSBC, Dekanati, Departamenti, Personeli Akademik dhe Ndhimës-akademik dhe studentët.</p> <p><i>Evidenca 1.1 - Statuti i UK</i> <i>Evidenca 1.32 - Rregullore e Brendshme e Fakultetit të Ekonomisë</i> <i>Evidenca 1.3 - Plani Strategjik UNIKO 2016-2020</i> <i>Evidenca 1.3.1 - Draft Plani Strategjik i Zhvillimit të UNIKO.</i> <i>Evidenca 1.16 - Manuali i Cilësisë UK 2020</i> <i>Evidenca III.01 - Model i Pyetesorit Studentor</i> <i>Evidenca III.02.a - Raportet Vjetore te DMT(2015-2016)</i> <i>Evidenca III.02.b - Raportet Vjetore te DMT(2016-2017)</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi VI.2</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njëjve të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.</p>	<p>GVJ konstaton se Departamenti, si njësi bazë përgjegjëse për procesin e rishikimit të programeve të studimit. Në fund të çdo viti akademik drejtuesi i njësisë bazë, koordinatori i programit të studimit dhe personeli akademik bëjnë monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit duke shqyrtuar konkluzionet e vlerësimit të tregut të punës, opinionet e studentëve, relacionet e pedagogëve, opinionet e punëdhënësve dhe mendimet e studentëve të diplomuar dhe drejtuesi i njësisë bazë i dërgon me një relacion për miratim tek drejtuesi i njësisë</p>

Ben Ahmet

[Signature]



	<p>kryesore.</p> <p><i>Evidenca II.11 - Ndryshime në Planin Mësimor të Programit të Studimit Bachelor "Administrim Biznesi në Marketing".</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>GVJ konstatoi se departamenti në fund të çdo viti akademik bën rishikimin e programit të studimit duke reflektuar të gjitha informacionet e mbledhura nga studimi i tregut, rezultatet e sondazhit të studentëve dhe opinionet e pedagogëve. Përgjegjësi i Departamentit bën një relacion me ndryshimet dhe e paraqet për shqyrtim në Dekanat. SKSC, në nivel institucioni, bën mbikëqyrjen dhe përmirësimin e programeve të studimit.</p> <p><i>Evidenca I.27 - Studime tregu</i> <i>Evidenca III.01 - Model i Pyetësorit Studentor</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>GVJ konstaton se UNIKO përdor në mënyrë periodike instrumente vlerësimi për të testuar ecurinë e programeve të studimit dhe aktiviteteve të tjera akademike. NJSBC organizon pyetësorë për studentët, stafin akademik, stafin administrativ dhe palët e interesit. Pas zhvillimit të pyetësorëve, NJSBC bër raporte mbi rezultatet e vlerësimit.</p> <p>Gjithashtu, sekretaria mësimore e FE mban të dhëna të tjera që kanë të bëjnë me arritjet e studentëve dhe të dhëna të ndryshme për to, të tilla si: arritjet e studentëve, karakteristika demografike të studentëve dhe relacionet e pedagogëve mbi mbarëvajtjen dhe problematikat e hasura.</p> <p><i>Evidenca II.06 - Të Dhëna nga Sekretaria Mësimore, Grupet Mësimore në Programin e Studimit "Administrim Biznesi në Marketing"</i> <i>Evidenca III.01 Model i Pyetësorit Studentor.</i> <i>Evidenca 1.5 - Rregullore e Drejtorisë së Kurrikulave (NJSBC, QKA)</i></p>
<p>Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se NJSBC në shkallë institucioni informon Senatin të UK lidhur me rezultatet e vlerësimit dhe sugjerimet për përmirësim. NJSBC në shkallë njësie bën të njëjtën gjë me Dekanin. Këto raporte publikohen online dhe ruhen pranë Departamentit dhe FE.</p> <p>Çdo vit UNIKO dërgon në MAS raportet vjetore të veprimtarisë së kryer.</p> <p><i>Evidenca 1.1 - Statuti i UK</i> <i>Evidenca 1.5 - Rregullore e Drejtorisë së Kurrikulave (NJSBC, QKA)</i></p>

Qen Ahmeti

Ar

<p>Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.</p>	<p>Referuar RVB-së, GVJ konstaton se raportet e vlerësimit të NJSBC bazohen në tre pjesë: pjesën përshkrimore, treguesit e matshëm dhe vlerësimin sipas standardeve. Raportet e vlerësimit përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.</p> <p><i>Evidenca III.02 Raportet Vjetore te DMT (2015-2016)</i> <i>Evidenca III.02 Raportet Vjetore te DMT (2016-2017)</i></p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="550 560 762 627">Përmbushet plotësisht</th> <th data-bbox="762 560 960 627">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="960 560 1155 627">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1155 560 1375 627">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="550 627 762 678"></td> <td data-bbox="762 627 960 678"></td> <td data-bbox="960 627 1155 678"></td> <td data-bbox="1155 627 1375 678" style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						



<p>Standardi VI.3 Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>Bazuar në RVB dhe vizitën në institucion, GVJ konkludon se vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi që është NJSBC në nivel fakulteti. Kjo njësi bën raport mbi përmbushjen e standardeve, vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p> <p><i>Evidenca VI.02 - Raporti i Vlerësimit te Brendshem te FE</i></p>
<p>Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Nisur nga informacioni në RVB dhe nga takimet gjate vizitës në institucion, GVJ konstaton se UNIKO përdor metoda e instrumente të ndryshme për të vlerësuar fushës akademike të programit të studimit, siç janë studime tregu, pyetësorë për studentët, të dhëna që merr nga sekretaria mësimore, si dhe njohje me përvojën e studiuesve dhe pedagogëve që marrin pjesë në leksionet e hapura.</p> <p><i>Evidenca II.06 - Të Dhëna nga Sekretaria Mësimore, Grupet Mësimore në Programin e Studimit "Administrim Biznesi në Marketing"</i> <i>Evidenca 1.5 Rregullore e Drejtorisë së Kurrikulave (NJSBC, QKA)</i> <i>Evidenca III.01 Model i Pyetesorit Studentor.</i> <i>Evidenca I.27 - Studime tregu</i> <i>Evidenca I.33 Leksione te Hapura</i></p>

<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testimet lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testimet ndërinstitucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe RVB rezultoni se kontrolli i vlerësimit të realizimit dhe mbarëvajtjes e cilësisë së programit vlerësohet në disa shkallë: në nivel njësie bazë, në nivel njësie kryesore dhe në nivel institucional nga KSCK që monitoron cilësinë e zbatimit të kurrikulës dhe raporton në Rektorat mbi rezultatet e monitorimit.</p> <p><i>Evidenca 1.1 - Statuti i UK</i> <i>Evidenca 1.32 - Rregullore e Brendshme e Fakultetit të Ekonomisë</i> <i>Evidenca 1.3 - Plani Strategjik UNIKO 2016-2020</i> <i>Evidenca 1.3.1 - Draft Plani Strategjik i Zhvillimit të UNIKO.</i> <i>Evidenca 1.16 - Manuali i Cilësisë UK 2020</i> <i>Evidenca 1.5 Rregullore e Drejtorisë së Kurrikulave (NJSBC, QKA)</i> <i>Evidenca III.01 - Model i Pyetesorit Studentor</i> <i>Evidenca III.02.a - Raportet Vjetore te DMT(2015-2016)</i> <i>Evidenca III.02.b - Raportet Vjetore te DMT(2016-2017)</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.</p>	<p>GVJ konstaton se, institucioni, në nivel njësie bazë, në nivel njësie kryesore dhe në nivel institucional nëpërmjet KSCK, përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista me studentët aktualë, me ato të diplomuar (alumni), me personelin akademik, ndihmës akademik e administrativ. Departamenti dhe FE, nëpërmjet metodave dhe instrumenteve të tërthorta nxjerrin konkluzione lidhur me cilësinë, për të ndikuar më pas në përmbushjen e standardeve të saj.</p> <p><i>Evidenca 1.1 - Statuti i UK</i> <i>Evidenca 1.32 - Rregullore e Brendshme e Fakultetit të Ekonomisë</i> <i>Evidenca 1.16 - Manuali i Cilësisë UK 2020</i> <i>Evidenca 1.5 Rregullore e Drejtorisë së Kurrikulave (NJSBC, QKA)</i> <i>Evidenca III.01 - Model i Pyetesorit Studentor</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Politikat dhe procedurat mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë janë të rregulluara në Statutin e UNIKO, Kreu IX, neni 73 dhe 74; në Rregulloren e FE, Kreu VIII, neni 101 dhe 102; në Planin Strategjik të Zhvillimit të UNIKO 2016-2020, Akreditimi dhe kontrolli i cilësisë, f. 31-35; në Planin Strategjik të Zhvillimit të UNIKO 2022-2027, Vlerësimi i cilësisë, f. 19-21 dhe Plan i rezultateve të pritshme nga objektivat – veprimtaria mësimore dhe vlerësimi i cilësisë, f. 40-42. Si dhe, Institucioni ka hartuar Manualin e Cilësisë për të organizuar përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p> <p><i>Evidenca 1.1 - Statuti i UK</i> <i>Evidenca 1.32 - Rregullore e Brendshme e Fakultetit të Ekonomisë</i> <i>Evidenca 1.3 - Plani Strategjik UNIKO 2016-2020</i> <i>Evidenca 1.3.1 - Draft Plani Strategjik i Zhvillimit të UNIKO.</i> <i>Evidenca 1.16 - Manuali i Cilësisë UK 2020</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>GVJ konstaton se UNIKO ka përcaktuar përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave në bazë të Rregullores së FE.</p> <p><i>Evidenca 1.1 - Statuti i UK</i> <i>Evidenca 1.2 Rregullorja e UK</i> <i>Evidenca 1.32 - Rregullore e Brendshme e Fakultetit të Ekonomisë</i></p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Pas shqyrtimit të Statutit të UNIKO dhe Rregullores së FE dhe pas vizitës në institucion, GVJ konstaton se UNIKO ka garantuar përfshirjen e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit.</p> <p><i>Evidenca 1.1 - Statuti i UK</i> <i>Evidenca 1.2 Rregullorja e UK</i> <i>Evidenca 1.32 - Rregullore e Brendshme e Fakultetit të Ekonomisë</i></p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të</p>	<p>Pas vizitës në institucion dhe takimeve me aktorët e brendshëm, që janë pedagogët dhe studentët, GVJ konstaton se institucioni garanton integritetin akademik dhe në praktikën e tyre nuk janë</p>

Ben Ahmet

Ar

respektoj integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	konstatuar raste të diskriminimit, të pabarazisë kundrejt stafit akademik dhe studentëve apo të dallimeve subjektive. <i>Vizita në Institucion: Minutat, Bsc Administrim Biznesi ne Marketing.</i>								
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Vlerësimi i cilësisë së proceseve që lidhen me programet e studimit parashikon edhe përfshirjen e palëve të treta të cilat me ekspertizën e tyre mund të japin mendime për përmirësimin e cilësisë së programit. GVJ, nga shqyrtimi i RVB, konstaton angazhimin e studentëve të diplomuar (alumni), punëdhënësit e bizneseve dhe ekspertëve të jashtëm në procesin vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë. GVJ sugjeron që të shtohen bashkëpunimet që kanë lidhje me programin e studimit në mënyrë të që rrisin cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj. <i>Evidenca I.41 - Aktivitete të DMT</i> <i>Evidenca I.40 - Marrëveshjet e Bashkëpunimit midis Fakultetit të Ekonomisë të UNIKO dhe Universiteteve dhe Institucioneve të Tjera.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td>Në përmbushje</td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> </tr> </table>	Në përmbushje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Në përmbushje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi VI.5	
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Bazuar në RVB dhe dokumentacion, si dhe vizitën në institucion, GVJ konstaton se politikat dhe strategjia në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë janë bërë transparente dhe publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit janë të njohur me standardet e manualit të cilësisë. <i>Evidenca 1.1 - Statuti i UK</i> <i>Evidenca 1.32 - Rregullore e Brendshme e Fakultetit të Ekonomisë</i> <i>Evidenca 1.3 - Plani Strategjik UNIKO 2016-2020</i> <i>Evidenca 1.3.1 - Draft Plani Strategjik i Zhvillimit të UNIKO.</i> <i>Evidenca 1.16 - Manuali i Cilësisë UK 2020</i>
Kriteri 2. Institucioni publikon rezultatet e	GVJ shqyrtoi dokumentacionin e vënë në dispozicion nga

Van Alimata

[Signature]

<p>vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>UNIKO dhe konstatoi se institucioni kryen publikimin e rezultateve të vlerësimeve të programit të studimit për studentët dhe informon të gjithë të interesuarit mbi informacionet e programit të studimit, duke respektuar Kodi e Etikës së UNIKO dhe lirinë dhe etikën akademike, siç është parashikuar në rregulloren për të dhënat personale.</p> <p><i>Evidenca 1.20 - Kodi i Etikës së UNIKO</i> <i>Evidenca 1.9 - Rregullore e Rruajtjes së të Dhënave</i></p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>GVJ konstatoi se rezultatet e vlerësimit të veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore hartohen në raporte që evidentojnë arritjet dhe problematikat në procesin mësimore dhe kërkimore dhe shoqërohen me një plan masash përpara fillimit të vitit akademik, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p> <p><i>Evidenca VII.03 - Programi i Veprimtarive për Mirëvijimin e Vitit Akademik</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Pas shqyrtimit të dokumentacionit të UNIKO, GVJ konstatoi se institucioni ka ndërtuar politikat dhe procedurat e duhura për vlerësimin dhe sigurimin e efektivitetit dhe impaktit të veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit. Këto realizohen përmes zbatimit të Statutit dhe Rregullores së UNIKO.</p> <p><i>Evidenca 1.1 Statuti i UK</i> <i>Evidenca 1.2 Rregullorja e UK</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Nga takimet e zhvilluara gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se institucioni organizon takimet informuese periodike për personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p> <p><i>Evidenca I.41 Aktivitete te DMT</i> <i>Evidenca IV.15 Trajnimi i Stafit per Microsoft TEAMS</i> <i>Evidenca I.28 Analiza e Veprimtarise se Qendres se Karrieres dhe Alumnit</i> <i>Evidenca IV.16 Program Simulimi HOTS</i> <i>Evidenca I.33 Leksione te Hapura</i> <i>Evidenca V.03 QKA-Kalendari i Veprimtarive</i> <i>Evidenca II.14 Kalendari i Veprimtarisë Ditët e Informimit të Maturantëve.</i> <i>Evidenca VII.03 Programi i Veprimtarive për Mirëvijimin e Vitit</i></p>

Ben Alumnit

[Signature]

	<i>Akademik</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Gen Aliminte

[Signature]


**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në
“Administrim Biznesi në Marketing”, Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë**

Pikat e forta dhe afirmime

1. Programi i studimit Bachelor “Administrim Biznesi në Marketing” organizohet dhe realizohet prej 30 vitesh në tregun shqiptar në përgjigje të politikave dhe strategjisë të zhvillimit kombëtar, për t’i siguruar tregut të punës, profesionistë në fushën e marketingut dhe biznesit.
2. Imazhi, reputacioni dhe pozicionimi i mirë i institucionit mbështet konsolidimin e programit të studimit Bachelor “Administrim Biznesi në Marketing” në përputhje të plotë me misionin dhe objektivat e përcaktuara në strategjinë e zhvillimit të programit.
3. Programi i studimit Bachelor “Administrim Biznesi në Marketing” është në përputhje me nevojat e tregut dhe me aktet ligjore në fuqi si dhe direktivat e BE për arsimin e lartë.
4. Programi i studimit shton në treg mundësitë për afirmimin e specialistëve të marketingut të cilët do të orientohen në treg sipas kërkesave të bizneseve, me njohuri të diversifikuara në Administrim Biznesi dhe Marketing, çka rrit mundësitë e punësimit jo vetëm të shpejtë por edhe alternativ të të diplomuarve.
5. Programi i studimit udhëhiqet dhe realizohet nga kapacitete akademike të specializuara dhe të kualifikuara në fushë, duke i dhënë prioritet mësimdhënies e mësimnxënies me studentin në qendër, në realizim të objektivave strategjike të institucionit.
6. Zhvillimi i procesit mësimor mbështetet me infrastrukture të plotë e të rikonstruktuar me mjete didaktike që ndihmon në arritjen e standardeve sa më të larta akademike e praktike në realizimin e programit.
7. Ekzistenca e një rrjeti partnerësh e bashkëpunëtorësh kombëtarë dhe ndërkombëtare forcon marrëdhënien me tregun e punës.
8. Programi si dhe vetë institucioni ka një politikë mbështetëse dhe inkurajuese për studentin. Nivel i lartë i ndërveprimit ndërmjet pedagogëve dhe studentëve në programin Bachelor “Administrim Biznesi në Marketing”.
9. Edukim ndërdisiplinor dhe i integruar me module ndërdisiplinore në programin e studimit.

Pika të dobta



1. Disa titullarë të lëndëve nuk mbajnë grada dhe tituj shkencor në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.
2. Angazhimi i ulët i personelit akademik me kohë të pjesshme, të specializuar e me përvojë aplikative në fushën e marketingut, në këtë program studimi.
3. Literaturë e kufizuar në gjuhën shqipe lidhur me tematikat specifike të këtij programi studimi, si dhe numër i kufizuar i titujve bashkëkohorë në bibliotekë dhe të përkthyer në gjuhën shqipe.



4. Numër i kufizuar modulesh të zhvilluara me praktika laboratorike dhe peshë e ulët e praktikës mësimore në programin e studimit.
5. Mungojnë analiza të thelluara mbi përfitimet konkrete në funksion të realizimit të programit mësimor me profilizim në marketing në avantazh nga programet e tjera Bachelor të ofruar në fushën e biznesit dhe strategjia afatgjatë e pozicionimit të programit në treg.

Rekomandime:

1. Institucioni, të marrë masa për mbulimin e moduleve të programit të studimit me titullarë të kategorisë profesor.
2. Përveç personelit akademik me kohë të plotë, të angazhuar në mësimdhënie dhe kërkim shkencor, rekomandojmë të rritet angazhimi i personelit akademik me kohë të pjesshme të specializuar e me përvojë aplikative në fushën e marketingut.
3. Institucioni, të vijojë me hartimin dhe shtimin e literaturës mësimore nga profesionistë të fushës, të përshtatshme për nivelin e profilizimit që ofron ky program studimi.
4. Të rishikohet raporti mes ngarkesës teorike dhe praktike të lëndëve duke vlerësuar rritjen e orëve praktike dhe zhvillimin e moduleve me praktika laboratorike.
5. Njësia përgjegjëse e programit të ndërmarrë një studim të thelluar tregu lidhur me prirjet dhe ndryshimet e shpejta në profilin e Marketingut në mënyrë që të përforcojë avantazhet e këtij programi në raport me programe të tjera Bachelor të ofruar në fushën e biznesit dhe zhvillojë një strategji afatgjatë të zhvillimit të tij në treg.
6. Praktika mësimore të zërë një peshë më të madhe në programin e studimit (jo vetëm 2 kredite) me qëllim aftësimin e studentëve në tregun e punës.
7. Institucioni të rrisë përpjektjet për pasqyruar rezultatet dhe arritjet e këtij programi në mjetet e informimit të publikut dhe informimin e studentëve potencial;




Conclusions of the evaluation of the first cycle study program, Bachelor in "Business Administration in Marketing" of the University "Fan S. Noli", Korça

Strengths and affirmations:

1. The Bachelor study program "Business Administration in Marketing" is organized and implemented for 30 years in the Albanian market in accordance to national development policies and strategies, to provide the labor market professionals/employees with the appropriate professional skills.
2. The image, reputation and good positioning of the institution supports the consolidation of the Bachelor study program "Business Administration in Marketing" in full compliance with the mission and objectives set out in the program development strategy.
3. The Bachelor study program "Business Administration in Marketing" is in accordance with the needs of the market and the legal acts in force as well as the EU directives for higher education.
4. The study program increases the opportunities in the market for the affirmation of marketing specialists who will be market oriented according to the requirements of businesses, with diversified knowledge in Business Administration and Marketing, which increases employment opportunities not only fast but also alternative to graduates.
5. The study program is led and realized by specialized and qualified academic capacities in the field, giving priority to teaching and learning with the student at the center, in realization of the strategic objectives of the institution.
6. The development of the teaching process is supported by a renewed infrastructure with didactic tools that help achieve the highest possible academic and practical standards in the implementation of the program.
7. The existence of a network of national and international partners and collaborators strengthens the relationship with the labor market.
8. The program as well as the institution itself has a supportive and encouraging policy for students; High level of interaction between professors and students in the Bachelor program "Business Administration in Marketing".
9. Interdisciplinary education with integrated interdisciplinary modules in the study program.



Weaknesses:

1. Some course lectures do not hold degrees and scientific titles in accordance with the legal provisions in force.
2. Low engagement of external specialized staff with applied experience in the field of marketing in the bachelor program in marketing.
3. Limited literature in Albanian language related to the specific topics of the program in Marketing and shortage of contemporary titles in the library translated to Albanian.
4. Limited number of modules developed with laboratory practices and low weight of traineeship in the study program.
5. There is a lack of in-depth analysis on concrete benefits of this program with profiling in marketing over other Bachelor programs offered in the field of business together with a lack of the long-term strategic development and positioning of the program in the market.



Recommendations:

1. The institution, should take measures to cover the modules of the study program with lectures holding the title “professor”.
2. In addition to the internal staff engaged in teaching and research, we recommend to continue the engagement of external specialized staff with applied experience in the field of marketing.
3. The institution shall continue with the development of teaching literature by professionals in the field, suitable for the level of profiling offered by this study program.
4. Review the relationship between theoretical and practical workload of courses by evaluating the increase of practical hours and the development of modules with laboratory practices.
5. The responsible unit of the program shall undertake an in-depth market study regarding the trends and rapid changes in the Marketing profile in order to reinforce the advantages of this program in relation to other Bachelor programs offered in the field of business and develop a long-term strategy for the market.
6. Student traineeship to occupy a greater weight in the study program (not only 2 credits) in order to train students in the labor market.
7. The institution to increase efforts to reflect the results and achievements of this program in the media and inform potential students.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Përbushen plotësisht	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

Van Aliminte

[Signature]